



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI DHE KRYENEGOCIATOR

RAPORT MBI NEGOCIATAT DHE INTEGRIMIN EVROPIAN
(Periudha raportuese: janar – mars 2024)

Prill 2024

PASQYRA E LËNDËS

HYRJE	3
PJESA I: KUADRI PËR INTEGRIMIN EVROPIAN	4
1.1 VIZIONI STRATEGJIK	7
1.2 SFIDAT	10
1.3 INTEGRIMI I PËRSHPEJTUAR	14
1.4 MARRËVESHJA E STABILIZIM-ASOCIIMIT	21
PJESA II: NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIMIN NË BASHKIMIN EVROPIAN	28
2.1 GRUPIMI I KAPITUJVE 1 “THEMELORET”	21
2.2 GRUPIMI I KAPITUJVE 2 “TREGU I BRENDSHËM”	36
2.3 GRUPIMI I KAPITUJVE 3 “KONKURRUESHMËRIA DHE RITJA GJITHËPËRFSHIRËSE”	39
2.4 GRUPIMI I KAPITUJVE 4 “AGJENDA E GJELBËR DHE LIDHSHMËRIA E QËNDRUESHME”	46
2.5 GRUPIMI I KAPITUJVE 5 “BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI”	48
2.6 GRUPIMI I KAPITUJVE 6 “MARRËDHËNIET ME JASHTË”	49
PJESA III: PJESËMARRJA E GRUPEVE TË INTERESIT NË PROCESIN E NEGOCIATAVE DHE INTEGRIMIT EVROPIAN	76
PJESA IV: INTEGRIMI EVROPIAN NË NIVEL VENDOR.....	83

HYRJE

Raporti për “Negociatat dhe Integrimin Evropian”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, hartohet në zbatim të nenit 19, të ligjit nr.19/2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian””.

Ky raport periodik për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë bazohet në detyrimin ligjor, të përcaktuar si më sipër, dhe paraqet: progresin në zbatim të detyrimeve për ‘Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit’; procesin e negociatave në përputhje me Paketën e Zgjerimit të Komisionit Evropian¹; vizionin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030; si dhe programin e qeverisë shqiptare 2021 – 2024.

Raporti për periudhën janar – mars 2024 paraqet një pasqyrë zhvillimore të rezultateve dhe arritjeve në procesin e negociatave dhe integritit evropian në nivelin (i) qendror dhe nivelin (ii) vendor, me qëllim arritjen e objektivit madhor për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në BE.

Ky Raport është hartuar nga Departamenti i Politikës dhe Integritit Evropian në Kryeministri, në funksionin e tij si Sekretariat Përgjithshëm i Integritit Evropian, në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit dhe kryenegociator, negociatorët dhe sekretariatet teknike për çdo kapitull dhe kriter dhe 36 sekretariatet e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës të Integritit Evropian (GNPIE-së), për çdo kapitull (grupkapitull) dhe kriter të acquis të Bashkimit Evropian.

¹https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_22_6082

PJESA I: KUADRI PËR INTEGRIMIN EVROPIAN

1.1 Vizioni strategjik

Integrimi Evropian është synimi politik dhe strategjik më i rëndësishëm i Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian (SKZHIE) 2022-2030, përcakton vizionin dhe objektivat strategjike Kombëtare, ku qëllimi parësor strategjik është integrimi evropian.

Procesi i negociatave dhe, më pas, anëtarësimi në Bashkimin Evropian, do të mbështesë më tej demokratizimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, do të nxisë konsolidimin e institucioneve publike dhe vazhdimin e proceseve reformuese, duke përsheptuar zhvillimin ekonomik dhe përjasjen me nivelet më të mira evropiane të mirëqenies dhe gjithëpërfshirjes sociale.

1.2 Sfidat

Metodologjia e re e anëtarësimit kërkon vazhdimësinë e reformave dhe politikave të koordinuara dhe të njëkohshme në të gjithë sektorët, për plotësimin e kriterëve të anëtarësimit në BE gjatë negociatave dhe njëkohësisht dhe detyrimeve të MSA-së. Sfidat kryesore lidhen me domosdoshmërinë për: (i) vazhdimin e mëtejshëm dhe thelliminnë reformat themelore; (ii) përmbushjen e detyrimeve të MSA-së dhe harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së; (iii) mbas finalizimit të procesit *screening*, plotësimin e kriterëve për hapjen e negociatave në grupimin 'Themeloret' dhe më pas në grupimet e tjera; (iv) koordinimin dhe integrimin vertikal dhe horizontal të politikave dhe reformave të lidhura me procesin e anëtarësimit.

1.3 Integrimi i Përsheptuar

Rëndësia e Planit të Rritjes të BE për Ballkanin Perëndimor (BP)

- Plan i Rritjes së BE për Ballkanin Perëndimor paraqet një mundësi të jashtëzakonshme për Shqipërinë. Ky plan synon të forcojë zhvillimin ekonomik, të ndërtojë infrastrukturën, dhe të ndihmojë në zbatimin e reformave të nevojshme për integrimin tonë në tregun e vetëm të BE.
- Plan i Rritjes është një instrument i mbështetjes së BE për rrugën tonë drejt integritit evropian dhe nxitje për të bërë ndryshime thelbësore që do të sjellin përparësi të mëdha për vendin tonë.

Shtyllat dhe Prioritetet e Planit

- Shtylla e parë lidhet me rritjen e integritit ekonomik të vendeve të BP në tregun e përbashkët EU. Kjo shtyllë ka 7 prioritetet:

1. Prioriteti i parë është forcimi i shtetit ligjor dhe qeverisja e mirë. Nevojitet të përqëndrohem në sundimin e ligjit dhe përmirësimin e qeverisjes për të krijuar një bazë të qëndrueshme për zhvillim.
 2. Prioriteti i dytë është zhvillimi i një ekonomie konkurruese dhe përfshirëse. Këtu përfshihen reforma që inkurajojnë inovacionin, produktivitetin dhe krijimin e vendeve të punës.
 3. Prioriteti i tretë fokusohet në investime në kapitalin fizik dhe njerëzor. Nevojitet të investojmë në infrastrukturë dhe arsim për të përmirësuar aftësitë dhe lidhuritë tona ndërkombëtare
 4. Prioriteti i katërt është përqëndrimi në një të ardhme të gjelbër dhe të qëndrueshme. Këtu përfshihen masat për ruajtjen e mjedisit dhe adoptimin e burimeve të energjisë së pastër.
 5. Prioriteti i pestë ka të bëjë me transformimin dixhital, duke përgatitur rrugën për integrimin tonë në tregun dixhital të BE.
 6. Prioriteti i gjashtë dhe shtatë ka të bëjë me rritjen e bashkëpunimit rajonal, duke zgjidhur mosmarrëveshjet dhe duke forcuar sigurinë dhe stabilitetin.
- Shtylla e dytë ka të bëjë me integrimin në tregun e përbashkët rajonal të BP.
 - o Për këtë është prioritar zbatimi i planit të veprimit për tregun e përbashkët rajonal
 - o CEFTA është mekanizmi kryesor për zbatimin e këtij plani rajonal.
 - Shtylla e tretë lidhet me përshpejtimin e reformave themelore. Vendet e BP përgatisin një Agjendë Kombëtare Reformash, bazuar në rekomandimet e:
 - o Paketës vjetore të Zgjerimit
 - o Konkluzionet e Dialogut Ekonomik dhe Financiar
 - Shtylla e katërt është Instrument i Ri Financiar i Dedikuar që ofron mbështetje thelbësore për zbatimin e Planit të Ri të Rritjes.

Në këtë drejtim, Shqipëria ka përgatitur draftin e Planin e Rritjes, i cili do të nxisë më tej veprimet ekonomike të orientuara nga tregu për hyrjen në tregun e vetëm të BE-së. Objektivi kryesor i agjendës lidhet me dyfishimin e rritjes ekonomike nëpërmjet ndryshimeve strukturore dhe lirisimit të potencialit ekonomik të vendit

Komponentët kryesorë të Planit janë:

- Shteti i së drejtës
 - ✓ Lufta kundër korrupsionit dhe Reforma në drejtësi
- Përmirësimi i mjedisit të të bërit biznes
 - ✓ Mbështetje për eksportet dhe ndërkombëtarizimin e NVM-ve
 - ✓ transformimi i Politikës Industriale duke përmirësuar ekosistemet e start-ups
 - ✓ lidhje energjitike mes EU-BP
- Dixhitalizimi si shtytje e rritjes së produktivitetit
 - ✓ Dixhitalizimi i shërbimeve dhe programeve të biznesit
- Zhvillim i kapitalit njerëzor
 - ✓ Adresimin e mospërputhjes së aftësive në vend
 - ✓ Konsolidimin e kornizës së kualifikimeve të arsimit profesional

- Energjia dhe tranzicioni i gjelbër
 - ✓ Dekarbonizimi përmes zbatimit të Mekanizmit të Rregullimit të Kufirit të Karbonit
 - ✓ Diversifikimi dhe efienca e energjisë
 - ✓ Siguria e furnizimit me energji

Ky është një moment shumë i rëndësishëm për Shqipërinë për një përparim të ndjeshëm drejt integrimin evropian dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

1.4 Dialogu Politik në Kuadër të Integritit Evropian

1.4.1 Integrimi i Përsheptuar me Bashkimin Evropian në përputhje me “Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor”

Plani i Rritjes është platforma kryesore për përsheptimin e Integritit të Tregut të Vetëm dhe reformave themelore për integrimin në BE, me një ndikim të madh në thellimin e integritit ekonomik të rajonit me BE. Integrimi me Tregun e Vetëm të BE-së ka qenë shtytësi kryesor i rritjes ekonomike për të gjitha vendet që iu bashkuan BE-së. Për vendet në rrugën e anëtarësimit në BE, si Ballkani Perëndimor, përafrimi sa më shpejt me tregun e vetëm të BE-së do të sillte përfitime që mund të ndjeheshin drejtpërdrejt nga qytetarët.

Në mbështetje të nismave për integrim të përsheptuar, në pararendje të Samitit Rajonal për Planin e Rritjes dhe Konvergencës, u organizua më 28 shkurt 2024, në Tiranë, takimi i ministrave përgjegjës për integrimin evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Komisionit Evropian, për të diskutuar mbi integrimin e përsheptuar me BE si pjesë e Planit të Rritjes, si dhe rezultatet e pritura të Samitit Rajonal.

Në këtë perspektivë diskutimi i ministrave u fokusua mbi strategjinë e përbashkët të rritjes, politikat e koordinuara dhe aktivitete të përbashkëta për të siguruar suksesin në zbatimin e Planit të Rritjes dhe në procesin e përgjithshëm të anëtarësimit. Takimi hodhi bazat për thellimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes së ndërsjellë në rrugën e vendeve të rajonit drejt integritit në BE.

Integrimi ekonomik ofron një rrugë të shpejtë për adoptimin e teknologjive të reja, për rrjedhën e ideve dhe inovacioneve të reja dhe për kalimin drejt produktivitetit më të lartë që mbështet rritjen në ekonomitë me të ardhura të mesme. Ballkani Perëndimor aktualisht ka pak produkte konkurruese, por shumë potencial për t'u zhvilluar pasi ndodhet në mes të nyjeve të tregtisë globale. Integrimi ekonomik është e vetmja mënyrë në të cilën ekonomitë e Ballkanit Perëndimor mund të arrijnë potencialin e tyre të plotë, të lehtësojnë aksesin në një bazë më të madhe konsumatore, një grup më të madh punëtorësh të kualifikuar, burime shtesë financimi dhe teknologji të reja. Një treg më i madh do të thotë më shumë mundësi për firmat lokale, por gjithashtu do të thotë më shumë stimuj për të inovuar dhe rritur konkurrencën. Me Planin e ri të Rritjes, Ballkani Perëndimor ka një mundësi të jashtëzakonshme për të shfrytëzuar një treg prej 450 milionë banorësh në BE.

Ballkani Perëndimor është në një pozitë të favorshme, për të përfituar nga afërsia me tregun e BE-së, por barrierat për Tregun Unik pengojnë potencialin e plotë ekonomik të vendeve të BE-së dhe kandidatëve të Ballkanit. Në këtë drejtim, Banka Botërore ka vlerësuar se çdo vit

kamionët shpenzojnë 26 milionë orë—pothuajse 3000 vjet—në pikat kufitare në Ballkanin Perëndimor, dhe se nëse zvogëlohet koha e pritjes me 3 orë, do të mund të arrihet deri në 3% rritje të PBB-së – kjo është ndoshta rritja më e lehtë e PBB-së që mund të arrihet. Në këtë kontekst, këto përfitime nuk janë vetëm për Ballkanin Perëndimor, por edhe për fqinjët e BE-së. Nëse eliminohen pengesat e panevojshme jo vetëm brenda Ballkanit Perëndimor, por edhe midis Ballkanit Perëndimor dhe fqinjëve të BE-së, si për shembull Greqia mund të përfitojë deri në 2.1 miliardë lekë, Kroacia dhe Bullgaria mund të marrin përfitime prej rreth 1 miliardë secila. Në këtë kuptim, gjithë rajoni mund të përfitojë më mirë nga të gjitha investimet në infrastrukturë.

Më shumë se 12 miliardë euro janë investuar në infrastrukturën e transportit brenda Ballkanit Perëndimor gjatë viteve të fundit. Për të nxitur rrugën e integritit ekonomik do të duhet një katalizator apo një forcë lëvizëse që do të konkretizojë më tej masat dhe hapat që duhet të ndërmerren dhe që do të orientojë sektorin privat në drejtimin e duhur, drejt rrugës së BE-së.

Ministrat e Integritit, gjatë takimit u shprehën qartë se qasja në tregun e vetëm të BE-së përpara anëtarësimit të plotë do të siguronte përfitime të menjëhershme ekonomike, duke lehtësuar tregtinë, duke tërhequr investime dhe duke rritur rritjen ekonomike. Kjo do t'i lejonte bizneset të konkurrojnë brenda tregut më të madh evropian, t'u përmbahen standardeve të BE-së dhe të integrohen në zinxhirët e furnizimit evropian në mënyrë më të qetë.

Mes ministrave u shpreh nevoja që bashkëpunimi do të duhet të intensifikohet në vijim, për të punuar për nisma konkrete, me qëllim aksesin në tregun e përbashkët të BE-së të bëhet më i prekshëm për qytetarët dhe bizneset.

Në këtë kuadër, duke u mbështetur në kontributet e takimit jozyrtar të Ministrave të Integritit Evropian të Ballkanit Perëndimor dhe Komisionit Evropian, organizuar në Tiranë më 12 shkurt 2024 dhe seminarit rajonal për lehtësinë e tregtisë dhe transportit të organizuar në Tiranë më 22-23 shkurt 2024, ministrat e Integritit për Ballkanin Perëndimor, ranë dakord së bashku për të ndjekur tre (3) iniciativa konkrete, me qëllim futjen graduale në Tregun Unik, specifikisht lidhur me:

- Iniciativën lidhur me Tregun Unik të Pagesave në Euro (SEPA);
- Iniciativën lidhur me Programin e Lehtësimit të Tregëtisë dhe Transportit (2.0) ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të BE;
- Iniciativën lidhur me zgjerimin e Iniciativave Dixhitale të BE-së në Ballkanin Perëndimor.

Përveç kësaj, në takim u theksua nevoja e forcimit të bashkëpunimit të strukturuar nëpërmjet vendeve pjesëmarrëse, me qëllim rritjen e bashkëpunimit rajonal, mbështetjen e ndërsjellë dhe shkëmbimet e praktikave më të mira në të gjitha aspektet e procesit të aderimit në Bashkimin Evropian.

Më 28 shkurt 2024, në Tiranë, u zhvillua takimi “Ballkani Perëndimor drejt Tregut Unik të Pagesave në Euro (SEPA)”, organizuar nga Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë. Ky Ministerial, mblodhi Ministrat e Financave dhe Guvernatorët e Bankave Qendrore të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ku morën pjesë dhe përfaqësues të Komisionit Evropian, Bankës Botërore dhe BERZH-it.

Në ministerial u ktheksua rëndësia lidhur me aksesin në SEPA (Single European Payment Area) si një nga mundësitë që vendet e Ballkanit Perëndimor mund ta përfitojnë përpara finalizimit të procesit të anëtarësimit, me përmbushjen e kushteve.

Shqipëria ka intensifikuar përpjekjet për arritjen e këtij objekti historik duke synuar të përfundojë procesin e aplikimit për pjesëmarrje në SEPA brenda muajit qershor të vitit 2024. Në këtë aspekt, përtej angazhimit serioz që ka pasur vendi në kuadër të procesit të integritimit, ka qenë gjithnjë e vëmendshme të ndjekë parimet dhe standardet e Bashkimit Evropian në rregullimin dhe reformimin e tregut të pagesave. Si rezultat, bazuar edhe në konstatimet e Bankës Botërore, e cila është pjesë integrale dhe e rëndësishme e këtij projekti, Shqipëria vlerësohet avangard në proces dhe është gati për aplikimin e anëtarësimit në SEPA.

Aderimi në SEPA për vendet që nuk janë ende pjesë e BE-së, në kuadër të Planit të Ri të Rritjes së Komisionit Europian, është një mundësi unike për Ballkanin Perëndimor, e cila ul ndjeshëm kostot e pagesave brenda rajonit dhe me BE-në. Në të njëjtën kohë, ky hap mund të konsiderohet edhe si një mjet monitorimi për BE, për të vlerësuar gadishmërinë për t'u bërë pjesë e familjes europiane. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë shumë të ndërlidhura me BE-në, ndaj krijimi i një sistemi efikas për kryerjen e pagesave ndërkufitare ka një rëndësi të posaçme.

Në këtë aspekt, BE-ja është partneri më i madh tregtar për vendin. Mbi 70% e eksporteve nga Ballkani Perëndimor kanë si destinacion vendet anëtare të BE-së. Gjithashtu, BE-ja është burimi kryesor i investimeve të huaja direkte në rajon, me rreth 70% të totalit të IHD-ve në Ballkanin Perëndimor.

Gjatë dy dekadave të fundit, IHD-të kanë qenë një 'motor' i rritjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor, duke promovuar integritimin në zinxhirët europianë të vlerave, duke krijuar vende të reja pune dhe duke kontribuar me teknologji të reja. Gjithashtu, statistikisht tregojnë se pothuajse një e pesta e popullsisë së Ballkanit Perëndimor jeton jashtë vendit dhe shumica në vendet e BE-së. Në këtë kontekst, edhe remitancat luajnë një rol të rëndësishëm për ekonomitë e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Remitancat arrijnë mesatarisht në rreth 10% të PBB-së së vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sipas Bankës Botërore, kostoja e dërgimit të remitancave në Shqipëri është afërsisht 8.7%, duke tejkaluar ndjeshëm kufirin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm prej 3%. Nëse ky objektivi do të përmbushej, emigrantët shqiptarë dhe familjet e tyre do të kursenin në një masë të konsiderueshme.

Gjithashtu, sektori bankar në vendet e rajonit zotërohet kryesisht nga investitorë të huaj, të cilët janë nga vendet e BE. Shumë nga bankat në vendet e Ballkanit Perëndimor janë pjesë e grupeve bankare europiane, gjë që rrit mundësitë e implementimit të standardeve dhe infrastrukturës bankare europiane në bankat lokale. Marrë në konsideratë ekspozimin e sistemit bankar ndaj transaksioneve ndërkufitare me BE-në, përfshirja në Zonën e Vetme Europiane të Pagesave do të sjellë shumë përfitime për vendet BP. Sipas të dhënave të Bankës Botërore, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor shpenzojnë gjashtë herë më shumë se ekonomitë e vendeve të BE-së për të realizuar pagesa ndërkombëtare. Për më tepër, bizneset dhe klientët e vendeve të Ballkanit Perëndimor përballesh me kohë të gjata përpunimi për dërgimin dhe marrjen e pagesave, të cilat mund të kthehen edhe në pengesa për investimet ndërkufitare. Me SEPA, këto kosto dhe koha e përpunimit do të reduktohen ndjeshëm, duke lehtësuar kështu tregtinë me BE-në.

Ulja e kostos së transaksioneve nuk është përfitimi i vetëm. Duke përfshirë vendet e Ballkanit Perëndimor në SEPA, BE-ja po ofron akses në një treg shumë më të madh, i cili ofron mundësi të panumërta për rritje ekonomike. Në këtë kuadër, integrimi në SEPA do të rrisë konkurrencën e bizneseve dhe mundësitë e tyre për t'u përfshirë më shumë në tregtinë ndërkombëtare. Tregtia dhe integrimi global janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë. Në këtë kontekst, pjesëmarrja në SEPA gjithashtu shkon në të njëjtin drejtim me strategjinë për të nxitur tregtinë online. Tregu i e-commerce ka njohur rritje të konsiderueshme në vitet e fundit pasi depërtimi i internetit, njohuritë digjitale dhe opsionet e pagesave digjitale janë zgjeruar. Për më tepër, anëtarësimi në SEPA jep akses në sisteme moderne pagesash, më efikase dhe më të sigurta. Përafrimi i sistemeve të pagesave me ato të vendeve europiane, do të rrisë atraktivitetin vendas edhe si destinacion investimi. Investitorët do të kenë më shumë besim në stabilitetin dhe efikasitetin e sistemit financiar.

Ky integrim krijon terren të favorshëm edhe për vizitorët europianë që vizitojnë vendet e BP-së, të cilët do të gjejnë këtu mundësi të ngjashme pagesash sa i përket kostove, kohës dhe sigurisë si në vendet e tyre. Turizmi po bëhet një nga promotorët kryesorë të rritjes së PBB-së në dy vitet e fundit. E njëjta gjë vlen edhe për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Sigurimi i pagesave të thjeshta, të shpejta dhe të besueshme ndërkufitare do ta mbështesë më tej këtë prirje pozitive. Prezantimi i opsioneve më efikase të pagesave do të ndihmojë në rritjen e përdorimit të pagesave digjitale, në krahasim me veprimet cash. Reduktimi i veprimeve me para në dorë nuk sjell vetëm kosto më të ulëta, por shërben gjithashtu si instrument për të luftuar ekonominë informale. Opsionet efikase të pagesave stimulojnë përdorimin e institucioneve financiare për realizimin e këtyre pagesave, duke kontribuar kështu edhe në rritjen e përfshirjes financiare. Duke rritur aksesin në financë, pagesat digjitale mund të ndihmojnë në zvogëlimin e përjashtimeve sociale, duke krijuar mundësi edhe për atë pjesë të popullsisë që jeton në zona të largëta.

Në të njëjtën kohë, digjitalizimi i pagesave është një element i rëndësishëm plotësues i Agjendës së Përbashkët Digjitale të rajonit. Sistemet e pagesave mund të jenë një mundësi e mirë për t'i bërë ekonomitë më digjitale. Digjitalizimi i ekonomisë është me rëndësi strategjike, ndaj ajo është prioritet i politikave kombëtare.

Në këtë kuadër, Këshilli Evropian miratoi më 26 Shkurt 2024, rregulloren që mundëson pagesat e menjëhershme në Euro për konsumatorët dhe bizneset në BE dhe vendet e Zonës Ekonomike Europiane. Sipas kësaj rregulloreje, qytetarët do të kenë mundësi të transferojnë para brenda 10 sekondave në çdo moment të ditës – duke përfshirë këtu edhe jashtë orarit të punës – si brenda të njëjtit vend, ashtu edhe në çdo shtet tjetër anëtar të BE-së. Shqipëria ndodhet në një stad të avancuar sa i përket harmonizimit të legjislacionit bazë të BE-së për transaksionet e SEPA-s. Shqipëria gjithashtu ka përafruar gjerësisht kuadrin e saj ligjor me Direktivat e BE-së në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për më tepër, që nga tetori i vitit të kaluar, Shqipëria nuk është në listën gri të Task Forcës së Veprimit Financiar.

Në këtë drejtim, Shqipëria përtej angazhimit serioz që ka pasur në kuadër të procesit të integritetit, ka qenë gjithnjë e vëmendshme të ndjekë parimet dhe standardet e Bashkimit Evropian në rregullimin dhe reformimin e tregut të pagesave. Si rezultat, bazuar edhe në konstatimet Bankës Botërore, e cila është pjesë integrale dhe e rëndësishme e këtij projekti, Shqipëria vlerësohet avangard në proces dhe është gati për aplikimin e anëtarësimin në SEPA.

Pavarësisht faktit që ky proces, për shkak të fazave të ndryshme të plotësimit të kriterëve, nuk mund të jetë i përbashkët, bashkëpunimi dhe komunikimi do të ndihmojë për finalizimin me sukses të procesit. Për këtë qëllim, u paraqit angazhimi i plotë i Bankës së Shqipërisë për të ndarë përvojën dhe njohuritë e përftuara nga ky rrugëtim, ku duket se Shqipëria do të jetë pararojë.

SEPA i jep mundësi vendeve anëtare të realizojnë pagesa në euro, – transferta, kreditim dhe debitim direkt ashtu si pagesat kombëtare, – duke eliminuar diferencat mes pagesave kombëtare dhe atyre ndërkufitare dhe duke harmonizuar standardet dhe kushtet e funksionimit në të gjitha vendet pjesëmarrëse. Integrimi i vendeve të Ballkanit Perëndimor në SEPA do të sillte përfitime të mëdha ekonomike për rajonin, – si reduktimi i kostove të tregtisë, uljen e kostove të transfertave bankare, reduktimin e cash-it në ekonomi, duke i bërë pagesat elektronike më të thjeshta dhe më të lira, si edhe duke stimuluar njëkohësisht përfshirjen financiare dhe aksesin në financë. Banka Botërore po mbështet përmes asistencës teknike vendet e Ballkanit Perëndimor për të përmbushur kushtet e nevojshme për aplikimin dhe anëtarësimin eventual në Sistemin European të Pagesave.

Më 29 shkurt 2024, nën kujdesin e Kryeministrit z. Edi Rama, u zhvillua në Tiranë, "Samiti Rajonal për Planin e Rritjes dhe Konvergjencës", me qëllimin për të hedhur bazat për një përshejtim të konsiderueshëm të konvergjencës socio-ekonomike të rajonit me Bashkimin Evropian, përmes Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, që synon të thellojë integrimin rajonal përmes tregut të përbashkët rajonal dhe ta afrojë gradualisht Ballkanin Perëndimor me fushat kyçe të tregut të vetëm të BE-së. Ky samit i dytë ofroi mundësi të reja për një shkëmbim pikëpamjesh mbi të ardhmen evropiane të rajonit dhe mbi sfidat e përbashkëta rajonale.

Deklarata e përbashkët e liderëve të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP6) paraqet çështjet kryesore të adresuara, si më poshtë vijon:

Duke njohur dinamikën e re të politikës së zgjerimit të krijuar nga agresioni rus kundër Ukrainës dhe rëndësinë e shtuar të unitetit evropian dhe bashkëpunimin e rritur mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.

Duke theksuar që Plani i rritjes për Ballkanin Perëndimor paraqet mundësi të shkëlqyer për avancimin e integritit të rajonit në tregun e përbashkët, si dhe në mekanizmat dhe instrumentet e BE-së, ndërkohë që përshejtohen reformat në fusha strategjike dhe thelbësore, përfshirë edhe ato që lidhen me sundimin e së drejtës dhe të drejtat themelore.

Të përkushtuar për të përshejtuar punën e nevojshme për zbatimin e shpejtë dhe kuptimplotë të Planit të rritjes, individualisht dhe me partnerët rajonalë.

Duke njohur rëndësinë e konkluzioneve të kryesuesit të Samitit të Procesit të Berlinit, të mbajtur më 16 tetor 2023 në Tiranë, dhe duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht potencialet transformuese ekonomike dhe sociale të tregut të përbashkët rajonal për çlirimin e potencialit ekonomik dhe social të rajonit, si dhe përgatitjen e tij për hyrjen graduale në tregun e përbashkët evropian.

Duke njohur përpjekjet për krijimin e një bashkimi rajonal të kapaciteteve dhe profesioneve nëpërmjet njohjes së kualifikimeve akademike dhe profesionale në bazë të standardeve dhe praktikave të BE-së, ne përsërisim rolin koordinues të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal dhe angazhohemi që të përshejtojmë zbatimin e marrëveshjeve të lëvizshmërisë të realizuara në kuadër të Procesit të Berlinit;

Ne, liderët nga Ballkani Perëndimor, zotohemi për fillimin e një dialogu të strukturuar, së bashku me Komisionin Evropian dhe vendet anëtare të BE-së, me qëllim zbatimin e Planit të

rritjes në mënyra që sjellin përfitime individualisht, por dhe mund të inkurajojnë prosperitetin rajonal dhe përafrimin social-ekonomik me BE-në.

Në këtë frymë, liderët theksuan progresin e arritur në zhvillimin e agjendave të reformave, që do të ndihmojnë në orientimin e politikave dhe investimeve në katër vitet e ardhshme.

Në përputhje me fushat prioritare të Planit të Rritjes, si dhe me ato të tregut të përbashkët rajonal për integrimin gradual të ekonomive tona në tregun e vetëm evropian, ne diskutuam nisma konkrete në fusha të veçanta dhe identifikuam veprimet kryesore që duhen ndërmarrë.

Duke shfrytëzuar nismat rajonale të aprovuara në Samitin e liderëve të Procesit të Berlinit në Tiranë në tetor të vitit 2023, në Samitin rajonal në Shkup në janar të vitit 2024, Shqipëria u angazhua në prioritetet si:

- përshpejtimin e gatishmërisë për hyrje në Zonën e Vetme Evropiane të Pagesave (SEPA):
- avancimin e mëtejshëm të Korridoreve të Gjelbra, dhe lehtësimin e aktivitetit tregtar dhe ekonomik në rajon duke nxitur tërheqjen dhe konkurrencën në rajon:
- si dhe hapjen e mundësive për të aplikuar për “Rrjetin e Qendrave Evropiane të Inovacionit Dixhital për Vendet e Asociuara dhe WiFi4WB6 në të gjithë rajonin.

Për këtë qëllim, ne përshëndesim punën e ndërmarrë nga Komisioni Evropian, Banka Botërore, Komuniteti i Transportit, CEFTA dhe Forumi i Dhomës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor 6 në përcaktimin e hapave të ardhshëm për lehtësimin e tregtisë dhe transportit, si dhe përmirësimin e ndërveprimit ekonomik në rajon dhe mes gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së në pikat kryesore kufitare. Nismat e diskutura sot në kuadër të Planit të Rritjes synojnë të inkurajojnë rimëkëmbjen afatgjatë ekonomike të rajonit, mbështetjen e tranzicionit të gjelbër dhe digjital, dhe nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe konvergjencës me BE-në. Ne gjithashtu përshëndesim përpjekjet e bankave qendrore të rajonit për përgatitjen në bashkëpunim me Bankën Botërore të udhërrëfyesve, që do orientojnë përpjekjet e tyre për t’u përgatitur për anëtarësimin në SEPA.

Në lidhje me Zonën e vetme Evropiane të Pagesave (SEPA), liderët njohën rolin kryesor të sektorit financiar, dhe veçanërisht të sistemeve të pagesave, për funksionimin më të mirë të tregjeve. Pagesat që kursejnë shpenzime dhe kohë e bëjnë tregtinë më të lirë dhe u lejojnë kompanive konkurruese të rriten dhe t’u ofrojnë konsumatorëve qasje më të lehtë në mallra dhe shërbime. Një sistem pagese i sigurt dhe efikas mbështet zhvillimin e ndërmjetësimit financiar, thellimin e tregjeve financiare dhe përmirësimin e stabilitetit financiar, duke krijuar kështu një klimë ku investitorët mund të zgjerojnë bizneset e tyre. Palët ranë dakord të hartojnë në konsultim me aktorët përkatës plane veprimi konkrete, për secilin nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, për të avancuar përmbushjen e kriterëve të SEPA-s, me synimin për të kërkuar aderimin në SEPA brenda vitit 2024, si dhe për të mobilizuar mbështetje në zbatimin e standardeve dhe procedurave doganore, në mënyrë që rajoni të mund të afrohet në bashkëpunimin doganor dhe tregtar me BE-në.

Me qëllim të lehtësimit të tregtisë dhe transportit ndërmjet rajonit dhe vendeve fqinje anëtare të BE-së, liderët përshëndetën punën e Komunitetit të Transportit dhe të CEFTA-s lidhur me Udhërrëfyesin për Korridoret e Gjelbra, të aprovuara në Samitin e Ballkanit Perëndimor – BE në dhjetor të vitit 2023, si dhe kontrollet e bashkërenduara në kalimet kufitare ndërmjet BE-së dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të Udhërrëfyesit, liderët shprehën mbështetjen e tyre të plotë për krijimin e një Programi Rajonal për Lehtësimin e Tregtisë dhe Transportit, me synim për të mundësuar përafrimin e rajonit me tregun e përbashkët të BE-së, duke ulur barrierat dhe kostot tregtare, si dhe duke

përmirësuar efikasitetin e transportit ndërmjet 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe BE-së.

Programi do të zbatohet nga Banka Botërore në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Transportit, CEFTA-n dhe Komisionin Evropian.

Me qëllim përmirësimin e lidhjes digjitale brenda rajonit dhe mes rajonit dhe BE-së, liderët shprehën mbështetjen për kompanitë dhe sektorin publik në tranzicionin e dyfishtë (të gjelbër dhe digjital) duke lehtësuar nismën në kuadër të thirrjes së Programit të Evropës Digjitale “Rrjeti i Qendrave Evropiane të Inovacionit Dixhital për Vendet e Asociuara”.

Duke njohur suksesin e Iniciativës WiFi4EU, si pjesë e strategjisë së Komisionit Evropian për Tregun e Përbashkët Digjital dhe në përputhje me rezultatet e Samitit të Liderëve të Procesit të Berlinit në tetor të vitit 2023, liderët bënë gjithashtu thirrje për veprim drejt zbatimit të një nisme të tillë, e cila tashmë është shtrirë edhe në Ballkanin Perëndimor.

Duke njohur potencialin e bashkëpunimit ekonomik rajonal për zhvillimin social-ekonomik të rajonit tonë, ne angazhohemi për zbatimin e tregut të përbashkët rajonal, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së, ndërsa përparojmë drejt hapjes graduale të tregjeve tona drejt tregut të vetëm të BE-së. Duke vlerësuar Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal(KBR) dhe CEFTA-n për bashkërendimin e filluar, liderët bënë thirrje për një plan ambicioz pauses të planit të parë të veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal, i cili do të vazhdojë të hapë mundësi të rëndësishme për integrimin e tregut rajonal dhe të përgatisë rajonin për integrim në tregun e përbashkët të BE-së.

Duke risjellë në vëmendje rëndësinë e zbatimit të angazhimeve të mëparshme rajonale të ndërmarra me qëllim që qytetarët dhe bizneset të ndjejnë plotësisht përfitimet, liderët angazhohen për monitorimin dhe zbatimin e menjëhershëm të marrëveshjeve të lidhura në kuadër të Procesit të Berlinit. Në këtë drejtim, ne ritheksuam angazhimin tonë për të hequr çdo barrierë ndaj bashkëpunimit ekonomik, që mund të pengojë përpjekjet tona të përbashkëta dhe të njëanshme për të ecur drejt këtyre synimeve.

Duke konstatuar dinamikën e krijuar për marrëdhënie më të fortë mes BE-së dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, liderët i bënë thirrje BE-së që të shqyrtojë mënyra për përmirësimin dhe ndryshimin e kornizës ligjore dhe rregullatore, me qëllim që të arrihet përfshirja e rëndësishme, ndonëse graduale, e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në mekanizmat dhe forumet e BE-së, si politikisht ashtu edhe teknikisht, në përputhje me metodologjinë e re të anëtarësimit në BE dhe Planin e Rritjes për rajonin.

Po ashtu, në kuadër të Samitit Rajonal mbi Planin e Rritjes dhe Konvergjencës, u nënshkrua marrëveshja mes Kolegjit të Europës, Ministrisë së Arsimit dhe Universitetit të Tiranës për shtëpinë e re të Kolegjit të Europës që hapi dyert në Tiranë.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshje do të garantojë funksionimin e plotë të Kolegjit, duke nisur që prej këtij viti akademik deri në përfundimin e kampusit të ri.

Marrëveshja u nënshkrua nga Ministrja e Arsimit dhe Sportit, znj. Ogerta Manastirliu, Rektori i Universitetit të Tiranës, z. Artan Hoxha dhe Rektorja e Kolegjit të Evropës, znj. Federica Mogherini, në prani të kryeministrit z. Edi Rama dhe Komisionerit të BE për Zgjerimin dhe Fqinjësinë, z. Oliver Varhelyi.

Gjatë fjalës së saj para nënshkrimit të marrëveshjes Rektorja e Kolegjit të Evropës, Federica Mogherini u shpreh se ka patur një interes shumë të lartë nga ana e të rinjve për të zhvilluar studimet në këtë Kolegj. Në kuadër të çeljes së procesit të pranimit në Tetor janë marrë 241 aplikime për 31 vende nga 41 kombësi.

Ndërsa, Komisioneri i Bashkimit Evropian për Zgjerimin dhe Fqinjësinë, Oliver Varhelyi , u shpreh se *'në thelb, pra Tirana do të bëhet edhe më popullore se Bryzhi që do të ndryshojë shumë edhe jetën ekonomike në Ballkan. Fakti që shumica e aplikimeve vijnë nga vetë BE-ja, tregon vlerën e jashtëzakonshme të shtuar që do të ketë ky institucion, jo vetëm për Ballkanin, por edhe për ne në Bashkimin Evropian. Kjo nënkupton se BE-ja ka mbërritur në Tiranë'*.

1.4.2 Zhvillimet kryesore politike dhe angazhimet në mbështetje të procesit të integritimit në BE

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 kanë vazhduar diskutimet mbi rëndësinë gjeopolitike të politikës së zgjerimit të BE-së, format e mundshme të integritimit gradual të vendeve kandidate dhe aspirante, ndërkohë që janë ndërmarrë edhe hapa konkretë nga institucionet evropiane për të arritur kompromisin në lidhje me miratimin e kuadrit rregullator dhe të gjitha dokumentave të nevojshme për zbatimin e Planit të ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor.

Në mars 2024 Komisioni Evropian publikoi një komunikatë mbi rishikimin e politikave dhe reformave të para-zgjerimit, e cila ofron një kontribut në procesin e vazhdueshëm të diskutimit rreth reformave të brendshme që BE-ja do të duhet të realizojë për t'u përgatitur për një Union të zgjeruar. Dokumenti merr në konsideratë implikimet që do të ketë një BE më e madhe në katër fusha kryesore - vlerat, politikat, buxheti dhe qeverisja - duke shtruar kështu rrugën për rishikimin e politikave të para-zgjerimit.

Shqipëria ishte dhe vendi pritës i “Samitit Ukrainë – Evropë Juglindore”, i cili u mbajt më 28 shkurt 2024. Përveç rikonfirmimit të mbështetjes së palëkundur ndaj pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës, Shqipëria dhe vendet e tjera pjesëmarrëse riafirmuan vendosmërinë për intensifikimin e përpjekjeve të përbashkëta për të siguruar përparim të mëtejshëm dhe mbështetje të ndërsjellë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian të Ballkanit Perëndimor, Ukrainës, Republikës së Moldavisë dhe Gjeorgjisë.

Gjatë periudhës raportuese, objektivi politik lidhur me procesin e integritimit të Shqipërisë në BE ka qenë ruajtja e fokusit ndaj këtij proces në axhendën evropiane, pavarësisht fushatës elektorale për zgjedhjet parlamentare evropiane të qershorit 2024 dhe për institucionet e reja të Unionit. Pritshmëritë më të rëndësishme të qeverisë shqiptare kanë qenë:

- Organizimi i Konferencës së Dytë të Qeverisë – fillimi i negociatave për Grupkapitullin e parë- “themeloret”;
- Miratimi i Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor brenda ciklit aktual institucional evropian dhe fillimi i zbatimit të Planit.

Për arritjen e këtyre pritshmërive, është zhvilluar një diplomaci aktive e shoqëruar me realizim takimesh dhe vizitash bilaterale dhe multilaterale. Më 22 janar 2024, është zhvilluar

në Bruksel takimi i 17-të i Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit 'Shqipëri-BE', gjatë të cilit janë përcjellë rezultatet dhe arritjet e Shqipërisë nga zbatimi i reformave të lidhura me agjendën evropiane, qëndrimet politike dhe pritshmëritë e vendit tonë lidhur me procesin e negociatave të anëtarësimit, si dhe janë zhvilluar bisedime me zyrtarë të lartë të Parlamentit Evropian.

Në muajin shkurt 2024 u zhvillua në Bruksel mbledhja e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian, ku organizatat shqiptare nga shoqëria civile u prezantuan për t'iu bashkuar punës së këtij Komiteti, gjë që vlerësohet si një hap i rëndësishëm dhe si një formë e integritit gradual në procesin e vendimmarrjes evropiane.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024 janë zhvilluar bisedime me partnerë nga vendet anëtare të BE-së, si Hungaria, Spanja, Bullgaria, Malta, Kroacia, Gjermania dhe Italia, takime me përfaqësues të lartë të Shërbimit Diplomatik të BE-së, me përfaqësues të vendeve candidate si Gjeorgjia, Moldavia, Ukraina dhe Turqia. Ndërkohë, një fokus i veçantë i është kushtuar rajonit të Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet vizitave ministrore në Prishtinë, Shkup dhe Podgoricë. Gjatë këtyre kontakteve janë prezantuar edhe rezultatet dhe arritjet e Shqipërisë në zbatimin e reformave në lidhje me axhendën evropiane, qëndrimet politike dhe pritshmëritë e qeverisë në lidhje me procesin e negociatave të anëtarësimit.

Prezantimi dhe promovimi i procesit të integritit evropian të Shqipërisë, si dhe arritjet dhe synimet e vendit tonë, kanë qenë në qendër të vëmendjes edhe gjatë pjesëmarrjesve në konferencat ndërkombëtare, apo në aktivitetet diplomatike si: "Dialogu Raisina" në Indi, Forumi Ballkanik i Budapestit, Forumi i Institutit Real Elcano, Spanjë; Forumi i 3-të Diplomatik i Antalias, Dialogu midis "Miqve të Ballkanit Perëndimor", në Romë dhe Konferenca e Sigurisë në Mynih.

Për të përmbushur detyrimet në kuadër të BE dhe nismave rajonale, që nga 1 janari 2024, Shqipëria ka marrë presidencën e Nismës së Evropës Qendrore (CEI) dhe do të marrë Presidencën e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP). si dhe të Nismës Rajonale për Migracionin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI) për periudhën 2024-2025. Duke marrë edhe Presidencën e SEECP-së dhe MARRI-it, Shqipëria konfirmon edhe një herë rolin e saj aktiv në lidhje me bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë.

Nisma e Evropës Qendrore (CEI)

Shqipëria e konsideron Nismën e Evropës Qendrore (CEI) si një nxitëse e dialogut politik dhe si një platformë për bashkëpunimin rajonal, me qëllim sigurimin e paqes, stabilitetit, dhe progresin ekonomik të shteteve anëtare. Vlerat demokratike, sundimi i ligjit, të drejtat themelore, si dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë shtyllat thelbësore për vizionin e CEI-it, për sa i përket nxitjes së bashkëpunimit rajonal dhe procesit të integritit në BE. Në lidhje me sfidat e fundit gjeopolitike, Shqipëria vazhdon të dënojë agresionin rus kundër Ukrainës dhe do të vazhdojë të jetë një mbështetëse e fortë për çdo propozim për ndihmë humanitare për Ukrainën në kuadër të CEI-it.

Prioritetet e presidencës shqiptare të CEI përfshijnë: integrimin evropian, bashkëpunimin kulturor dhe turistik, dialogun mbi sfidat e shëndetësisë, si dhe forcimin e bashkëpunimit parlamentar dhe në këtë kuadër vlen për t'u theksuar prezantimi i Konventës Parlamentare

Raport për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

të CEI-it. Gjatë këtij mandati, Shqipëria do të nxisë bashkëpunimin për të lehtësuar kontaktet mes njerëzve, bashkëpunimin midis pushteteve vendore, strukturave akademike, profesionale, kulturore, organizatave joqeveritare, etj.

Presidenca shqiptare e CEI-it do të vazhdojë të zhvillojë dialogun politik mbi sfidat aktuale në kuadër të platformave tashmë të përcaktuara: 2 takime të Ministrave të Punëve të Jashtme në Tiranë, takime të Komitetit Parlamentar, mbledhjet e Koordinatorëve Kombëtarë të CEI-it, etj.

BSEC

Gjatë presidencës së saj, Shqipëria do të promovojë bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare për gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta në veçanti për çështjet ekonomike dhe sociale. Shqipëria beson plotësisht se BSEC do të vazhdojë të nxisë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimin ndërmjet shteteve të tij anëtare për rezultate më të mira në fushën e transportit, ekonomisë, turizmit, trashëgimisë kulturore, etj.

Shqipëria gjithashtu do të promovojë ndërveprimin ndërmjet BSEC-ut dhe BE-së, duke synuar të rrisë bashkëpunimin dhe sinergjinë midis këtyre dy organizatave për një qasje dinamike dhe të orientuar drejt projekteve.

Takimi i Ministrave të Punëve të Jashtme të BSEC do të organizohet online për të shmangur ftesën drejtuar MPJ-së së Rusisë.

SEEC

Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEEC) është një nga forumet kryesore të Evropës Juglindore, i cili përfshin vende me rëndësi strategjike për Shqipërinë.

Shqipëria do të marrë kryesimin e SEEC-së për periudhën qershor 2024- qershor 2025. Me marrjen e kësaj presidencie, Shqipëria konfirmon edhe një herë rolin e saj aktiv në këtë nismë rajonale.

Prioritetet e Presidencës shqiptare të SEEC-së fokusohen në forcimin e bashkëpunimit rajonal, përshejtimin e procesit të integritimit në BE si dhe zhvillimet e qëndrueshme.

Presidenca shqiptare e SEEC-së, krahas aktiviteteve të tjera, do të organizojë edhe një takim të Ministrave të Punëve të Jashtme dhe një Samit, në qershor 2025.

MARRI

Presidenca e Nismës për Migracion, Azil dhe Refugjatë (MARRI), gjatë qershor 2024-qershor 2025, do të riafirmojë rolin e Shqipërisë në menaxhimin e çështjes së migracionit në Ballkanin Perëndimor, si dhe në rritjen e sigurisë kufitare në rajon.

Prioritetet e Shqipërisë synojnë rritjen e bashkëpunimit të MARRI-it me mekanizmat përkatëse rajonale, agjencitë qeveritare dhe ndërqeveritare, si dhe organizatat

ndërkombëtare që synojnë një koordinim më të mirë dhe kryerjen e aktiviteteve të sinkronizuara në fushën e migracionit, azilit dhe refugjatëve.

1.4.3 Takime të nivelit të lartë në kuadër të negociatave dhe procesit të integritit evropian

Kryeministri z. Edi Rama, ka zhvilluar një sërë takimesh të rëndësishme gjatë periudhës janar-mars 2024, si më poshtë vijon:

14 shkurt 2024 – Kryeministri Edi Rama zhvilloi një vizitë zyrtare dy - ditore në Bruksel, për të marrë pjesë në mbledhjen e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian. Gjatë vizitës Kryeministri Rama, përveç takimit me Presidentin e këtij Komiteti, Oliver Ropke, zhvilloi bisedime edhe me Presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel dhe me Presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Fokusi i diskutimeve ishte integrimi evropian i Shqipërisë dhe i rajonit të Ballkanit Perëndimor, si dhe Plani i Rritjes Ekonomike. Gjatë takimeve me zyrtarët e lartë evropianë u rikonfirmua mbështetja e BE ndaj Shqipërisë dhe e ardhmja evropiane e saj dhe e të gjithë rajonit në BE. Planin e Rritjes Ekonomike, Kryeministri Rama e konsideroi si një mekanizëm të shumëpritur që rrit financimet për vendet e rajonit, si edhe hap rrugën e integritit në Tregun e Brendshëm të BE.

18 shkurt 2024 – Kryeministri Edi Rama, gjatë pjesëmarrjes së tij në Konferencën e Sigurisë në Mynih, u ndal edhe tek procesi i integritit evropian. Kryeministri theksoi se Shqipëria synon nisjen e bisedimeve të anëtarësimit pasi negociatat janë transferimi më produktiv i njohurive që një vend mund të marrë për t'u shndërruar në institucione funksionuese. Ndër takimet e rëndësishme që zhvilloi në margjinat e Konferencës, Kryeministri Rama bisedoi edhe me Komisionerin Evropian për Buxhetin dhe Administrimin, Johannes Hahn, me të cilin trajtoi Planin e Ri të Rritjes Ekonomike për vendet e Ballkanit Perëndimor.

28 shkurt 2024 – Kryeministri Edi Rama dhe Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelensky, mikpritën së bashku në Tiranë, liderët pjesëmarrës në Samitin “Ukrainë-Europa Juglindore” me pjesëmarrjen e liderëve nga Europa Juglindore dhe Ballkani Perëndimor, në një takim solidariteti e angazhimi të mëtejshëm të demokracive të vendeve kundër agresionit rus. Pas takimit u nënshkrua edhe një deklaratë e përbashkët, ku pjesëmarrësit konfirmuan, ndër të tjera, vendosmërinë për të intensifikuar përpjekjet e përbashkëta për të siguruar përparim të mëtejshëm dhe mbështetje të ndërsjellë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Ukrainës, Republikës së Moldavisë dhe Gjeorgjisë.

29 shkurt 2024 - Kryeministri Edi Rama, mori pjesë në Samitin Rajonal mbi Planin e Rritjes dhe Konvergencës, të mbajtur në Tiranë, ku i pranishëm, përveç liderëve të vendeve të rajonit, ishte edhe Komisioneri për Zgjerimin dhe Fqinjësinë, Oliver Varhelyi. Në përfundim të punimeve të Samitit, Kryeministri Edi Rama dhe Komisioneri Varhelyi, mbajtën një konferencë të përbashkët për mediat me fokus punimet e samitit, bashkëpunimin rajonal dhe procesin e integritit evropian. KM Rama theksoi se Plani i ri i Rritjes është një platformë kyçe për të përshpejtuar hyrjen në BE dhe një instrument që do ta bëjë këtë proces të prekshëm për njerëzit. Në përfundim të Samitit liderët e të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor nënshkruan një deklaratë të përbashkët, ku ndër të tjera, u zotuan për fillimin e një dialogu të strukturuar, së bashku me Komisionin Evropian dhe vendet anëtare të BE-së, me qëllim

zbatimin e Planit të Rritjes në mënyra që sjellin përfitime individualisht, por dhe për të inkurajuar prosperitetin rajonal dhe përafrimin social-ekonomik me BE-në.

Në këtë kuadër, janë zhvilluar një sërë takimesh të rëndësishme nga ministri i Evropës dhe Punëve të Jashtme gjatë periudhës janar – mars 2024, si më poshtë vijon:

16 janar 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Igli Hasani, zhvilloi një vizitë në Kosovë, në kuadër të një turi rajonal vizitash që përfshin edhe Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Gjatë konferencës së përbashkët për mediat me Ministren e Punëve të Jashtme të Kosovës, Donika Gërvalla, Ministri Hasani veçoi ndër të tjera se, Shqipëria, ashtu siç bën prej vitesh, është e gatshme të ndihmojë e mbështesë Kosovën në procesin e integritimit, duke ndarë eksperiencën dhe ekspertizën e akumuluar ndër dekada në këtë drejtim. Ministri Hasani vuri gjithashtu në dukje se integrimi i plotë i rajonit në BE është një domosdoshmëri dhe mënyra e vetme për të garantuar njëherë e mirë paqen dhe stabilitetin e Ballkanit Perëndimor e rrjedhimisht të vetë Evropës.

17 janar 2024 – Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Igli Hasani, zhvilloi një vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut gjatë së cilës realizoi një takim me homologun e tij, Ministrin e Punëve të Jashtme të Maqedonisë së Veriut, z. Bujar Osmani. Ndër mesazhet kryesore që Ministri Hasani përcolli gjatë kësaj vizite ishte që, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë treguar një përkushtim të jashtëzakonshëm në rrugën e tyre drejt BE dhe janë gati për hapin e radhës, mbajtjen e Konferencave të dyta Ndërqeveritare.

18 janar 2024 - Në vizitën e tij të parë zyrtare në Malin e Zi, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, theksoi se Shqipëria tashmë është gati për Konferencën e dytë Ndërqeveritare me BE, teksa nënvizoi se avancimi i çdonjërit prej vendeve në procesin e integritimit është një kontribut i vyer për mbarë rajonin.

22 janar 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, mori pjesë në takimin e 17-të të Komisionit Parlamentar të Stabilizim-Asociimit “BE-Shqipëri”. Ministri Hasani vlerësoi mbështetjen institucionale që Parlamenti Evropian ka dhënë ndaj Shqipërisë ndër vite, për përparimin në rrugën e integritimit evropian, duke vënë në dukje se raporti i fundit i Parlamentit Evropian për Shqipërinë, i miratuar nga shumica dërrmuese e seancës plenare, është një dëshmi e fortë e kësaj mbështetjeje. Po ashtu, Ministri Hasani e vlerësoi faktin që BE-ja e ka shtuar fokusin e saj tek gjeopolitika dhe elementi i sigurisë, sidomos pas vendimeve që e kanë përforcuar perspektivën evropiane të vendeve të Partneritetit Lindor, por nga ana tjetër shprehu keqardhjen që Këshilli i Dhjetorit të vitit 2023 nuk arriti t’i përgjigjej pozitivisht pritshmërive të Shqipërisë për të hedhur hapin më të rëndësishëm të procesit të anëtarësimit, nisjen e negociatave për grupkapitullin e “themeloreve”. Gjatë takimit u diskutua edhe rreth Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, të propozuar nga Komisioni Evropian, si mjeti më efikas me të cilin rajoni do të fillojë të përfitojë gradualisht akses më të zgjeruar në tregun e vetëm të BE-së, si dhe do të zvogëlojë hendekun zhvillimor ekonomik mes tij dhe BE-së.

5 shkurt 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, mori pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm të grupit “Miqtë e Ballkanit Perëndimor” dhe MPJ-ve të Ballkanit Peërendimor. Në fokus të takimit ishte thellimi i bashkëpunimit për të përshpejtuar procesin e integritimit evropian të Ballkanit Perëndimor, si dhe roli e kontributi i sektorit privat në

avancimin e kësaj kauze. Ministri Hasani theksoi nevojën për një qasje të re ndaj rajonit me fokus të veçantë në ekonomi. Sipas z. Hasani, konvergenca ekonomike është mjeti që i mundëson rajonit të nxisë integrimin ekonomik përpara se të kalojë në një integrim politik eventual, si hapi i fundit i procesit.

18 shkurt 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, mori pjesë në Konferencën e 60-të Sigurisë së Mynihut, gjatë së cilës zhvilloi një sërë takimesh dypalëshe me homologë nga shtetet pjesëmarrëse. Në fokus të takimeve ishte edhe çështja e integritit evropian të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

22 shkurt 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, gjatë pjesëmarrjes së tij në Konferencën Ndërkombëtare “Raisina Dialogue 2024”, në Nju Delhi të Indisë, zhvilloi një takim bilateral me Ministrin e Punëve të Jashtme të Suedisë, Tobias Billström. Ministri Hasani vlerësoi mbështetjen e Suedisë në rrugëtimin evropian të Shqipërisë, teksa theksoi rëndësinë e forcimit dhe intensifikimit të procesit të afrimit të të gjitha vendeve të rajonit me BE.

2 mars 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, mori pjesë në edicionin e tretë të Forumit të Diplomacisë së Antalias, tema kryesore e të cilit ishte: “Përparimi i diplomacisë në kohë trazirash”. I ftuar në një nga panelet e forumit, Ministri Hasani e vuri theksin në përpjekjet e BE-së për t’u bërë një aktor global. Ai nënvizoi se: “BE ka potencialin për t’u bërë një lojtar i vërtetë global dhe nuk mund t’i shmanget më zgjedhjeve të vështira. Aftësia e Unionit për të formësuar tranzicionet fillon në fqinjësinë e tij të afërt dhe zgjerimi është çelësi për të arritur këtë qëllim”.

12 mars 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, zhvilloi një vizitë zyrtare në Hungari, ku u prit nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë të Hungarisë, Peter Szijjarto. Ministri Hasani vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Hungarisë në rrugëtimin e Shqipërisë drejt BE, teksa nënvizoi se marrëdhëniet mes dy vendeve po forcohen dita-ditës. Gjatë vizitës Ministri Hasani, zhvilloi takime dypalëshe me Ministrin për Çështjet e Bashkimit Evropian, Janos Boka dhe Zëvendëskryetarin e Asamblesë Kombëtare, István Jakab. Diskutimet u fokusuan veçanërisht në progresin e bërë në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë, ku Ministri Hasani shprehu gatishmërinë e Shqipërisë për të zhvilluar Konferencën e Dytë Ndërqeveritare dhe për të avancuar drejt anëtarësimit në BE. Palët u dakordësuan se mbështetja hungareze për pranimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, e parashikuar të jetë një nga prioritetet e Presidencës hungareze të Këshillit të BE-së gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024, është një domosdoshmëri për të ardhmen e rajonit.

15 mars 2024 - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, zhvilloi një vizitë zyrtare në Spanjë, gjatë së cilës u takua me homologun e tij spanjoll, José Manuel Albares. Ndër të tjera, Ministri Hasani shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e Shqipërisë për mbështetjen e vazhdueshme të Spanjës në rrugën drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian, duke shtuar se Shqipëria mirëpret vëmendjen e posaçme të politikës së jashtme spanjolle ndaj rajonit të Ballkanit Perëndimor. Ai theksoi se forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe rajonit të Ballkanit Perëndimor është bërë më i rëndësishëm se kurrë në dritën e zhvillimeve të reja nëpër botë. Ministri spanjoll, Albares vlerësoi progresin e Shqipërisë

gjatë vitit të kaluar në rrugën e saj drejt BE-së dhe ritheksoi mbështetjen e plotë të Spanjës për përpjekjet e vendit tonë për t'u bërë një kandidat lider në procesin e zgjerimit të BE-së.

Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator gjatë periudhës janar-mars 2024, ka zhvilluar takimet si më poshtë vijon:

Në 12 janar 2024, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator znj. Majlinda Dhuka priti në takim Ambasadorin e Belgjikës të akredituar në Shqipëri dhe resident në Bullgari, Sh.T.Z. Frédéric Meurice. Në fjalën e saj, Ministrja Dhuka u ndal në kushtet e favorshme të Shqipërisë dhe përmbushjen e kriterëve teknike për hapjen e negociatave, planin e rritjes ekonomike, kolegjin e Evropës, kontributin që Shqipëria mund të jap në Open Strategic Autonomy (OSA), duke ju referuar mundësisë për të kontribuar në lëndët e para të konsideruara “kritike”. Ambasadori Meurice ritheksoi mbështetjen e Belgjikës për Konferencën e Dytë Qeveritare. Referuar statusit të “observuesit” ambasadori u shpreh se do ta kenë në vëmendje.

Në 17 janar 2024, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator znj. Majlinda Dhuka, priti në takim në Tiranë Ambasadorin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, Sh.T.Z. Silvio Gonzato. Në këtë takim të parë, Ministrja dhe Kryenegociatorja Dhuka hapi fjalën e saj duke u shprehur se 2-3 vitet e ardhshme janë të një rëndësie të veçantë për Shqipërinë, duke referuar vitin 2030 si viti i arritjes së anëtarësimit. Ministrja u ndal gjithashtu në nevojën e vendit për të progresuar në tregjet, duke kërkuar mbështetje për këtë çështje, vazhdimin e punës, në formë horizontale për të gjithë grupkapitujt për negociim.

Gjithashtu ambasadori Gonzato nuk nguroi të shprehte përgëzimet e tij për punën e qeverisë në procesin e negociatave si dhe aspektin e teknologjisë dhe modernizimit të vendit.

Në 5 shkurt 2024, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator znj. Majlinda Dhuka, zhvilloi një takim me Grupin Parlamentar të Bundestagut për Evropën Juglindore, të përbërë nga z. Josip Juratovic, z. Thomas Hacker dhe z. Stephan Brandner. Në fjalën e saj, Ministrja znj. Dhuka u ndal në punën e ngushtë në kuadër të procesit të negociatave me institucionet e pavarura në vend, përfshirë parlamentin e vendit, punën me bizneset dhe shoqërinë civile, duke ju referuar platformave të partneritetit, bashkëpunimin me nivelin lokal, duke ju referuar hapjes së zyrave të BE-së në bashkitë e vendit, hapjen e zyrës së Kolegjit të Evropës dhe suksesin me numrin e aplikantëve.

Në 5 mars 2024, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator znj. Majlinda Dhuka, priti në takim Grupin e Miqësisë Lituani – Ballkani Perëndimor, të përbërë nga z. Valdas Rakutis (Kryetar i grupit për Ballkanin Perëndimor), z. Audronius Ažubalis (anëtar i parlamentit), z. Zenonas Streikus, (anëtar i parlamentit), si dhe z. Mindaugas Vyskupaitis, zëvendës shefi i misionit në ambasadën e Lituaniës, në Athinë.

Në fjalën e saj, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator znj. Majlinda Dhuka falenderoi Lituaniën për mbështetjen ndaj Shqipërisë në procesin e negociatave. Ajo u ndal në memorandumit e bashkëpunimit midis dy vendeve, progresin e Shqipërisë në procesin e integritetit, potencialet e Shqipërisë për të kontribuar në energji dhe tranzicionin e gjelbër, si dhe gjithashtu vlerat e tjera si kapitalin human dhe popullsinë e re etj.

Pala lituaneze u shpreh me konsideratë për Shqipërinë, ndërsa u ndal në historikun e Lituaniës përgjatë procesit të anëtarësimit (duke vënë theks të veçantë në nevojën e madhe që ka sektori i arsimit, sfidat e largimit të “trurit” nga vendi, pas anëtarësimit (brain drain), sistemin e sigurisë në Lituani dhe mbështetja e Lituaniës për NATO dhe BE-në. Pala lituaneze

u shpreh e hapur për të ofruar mbështetjen e nevojshme për vendin tonë në rrugën e integritit.

1.5 Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) është një marrëveshje kuadër midis Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian (BE), që rregullon midis tyre, deri në momentin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ajo përcakton të drejtat dhe detyrimet reciproke, duke krijuar njëkohësisht mekanizmat e monitorimit të zbatimit të saj dhe bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, duke synuar përshejtimin e integritit (integritit të përshejtuar) dhe anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Përsa më sipër, gjatë periudhës tetor – dhjetor 2023, në kuadër të MSA-së, vijoi dialogu politik në nivel të lartë ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian.

Në takimet e zhvilluara, përfaqësuesit e Këshillit dhe Komisionit Evropian kanë vlerësuar:

- Zbatimin në tërësi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- Përparimin lidhur me zhvillimin e një ekonomie tregu me rritje të qëndrueshme;
- Përgatitjen dhe paraqitjen e mirë të Shqipërisë gjatë takimeve bilaterale në kuadër të procesit screening;
- Linjëzimin e plotë të Shqipërisë me qëndrimet dhe deklaratat e politikës së jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian, duke përfshirë qëndrimet e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit;
- Rolin konstruktiv të Shqipërisë në rajon dhe më gjerë.

1.5.1 Takimet e nënkomiteteve të Stabilizim – Asociimit

Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, në përputhje me nenin 121 të MSA-së, gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, në përputhje me kalendarin e MSA 2023, janë zhvilluar takimet e dy nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit:

Takimi i 15-të i Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit Drejtësia, Liria dhe Siguria

Në datat 20 – 21 mars 2024, u zhvillua takimi i 15-të i Nënkomitetit Drejtësi, Liri dhe Siguri midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë. Takimi u fokusua në çështjet që kanë të bëjnë mekapitujt negociues, përkatësisht, Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe Kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”, Kriteri Politik “Shteti i së drejtës” dhe “Funksionimi i institucioneve demokratike”.

Në këtë takim, Shqipëria informoi mbi:

- Zbatimin e reformës në drejtësi, me theks të veçantë në procesin e vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët;
- Masat transitore për përfundimin e mandatit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe finalizimin e çështjeve të apeluara përpara afatit kushtetues;

- Konsolidimin e institucioneve të reja të drejtësisë në përputhje me standardet e larta të pavarësisë dhe integritetit;
- Përthithjen e standardeve të larta të vettingut në punën e institucioneve drejtuese të gjyqësorit (KLGJ, KLP, ILD);
- Përfundimin e Pavarësisë së gjyqësorit: përzgjedhja e anëtarëve të rinj të institucioneve vetëqeverisëse të drejtësisë, emërimet dhe vlerësimet në gjyqësor;
- Eficencën në sistemin e drejtësisë: zbatimimi i hartës së re të gjyqësorit, reduktimi i çështjeve të mbartura, ngritja e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve;
- Progresin në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë masat e marra për të zvogëluar ndikimin e tyre konkretisht në sektorët me risk të lartë;
- Shtypjen e korrupsionit, duke përfshirë historikun e ndëshkimeve: Masat për uljen e numrit të çështjeve të mbartura të SPAK dhe gjykatave të SPAK;
- Masat për respektimin e të drejtave të njeriut: liria e shprehjes dhe liria e medias, reforma e të drejtave të pronës, mbrojtja e pakicave etj;
- Përpunimin në miratimin e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me acquis të BE-së, kapacitetet institucionale dhe rritja e ndërgjegjësimit;
- Bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar për çështjet penale dhe civile;
- Bashkëpunimin operacional me agjencitë e BE-së, në veçanti Frontex dhe Europol, si dhe shtetet anëtare të BE-së, për zbatimin e mirë të Planit të Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit;
- Në lidhje me liberalizimin e vizave, u theksua përmbushja e kërkesave nga ana e Shqipërisë dhe progresi në adresimin e rekomandimeve të vitit të kaluar.
- Përpunimin në zbatimin e planit të veprimit të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF) kundër pastrimit të parave.

Komisioni Evropian rekomandoi:

- Të përfundohet në kohë procesi i rivlerësimit të përkohshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve (vetting);
- Të referohen sistematikisht çështjet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të larguar, për ndjekje penale;
- Konsolidimin e vazhdueshëm të pavarësisë dhe integritetit të gjyqësorit, si dhe përpjekje urgjente për të reduktuar numrin e çështjeve të mbetura në të gjitha nivelet e gjyqësorit;
- Të bëhen përpjekje të vazhdueshme për të përvetësuar standardet e larta të vettingut në punën e institucioneve vetëqeverisëse për gjyqësorin;
- Të krijohet një sistem efikas i menaxhimit të integruar të çështjeve;
- Të zbatohet në mënyrë të plotë harta e re e gjyqësorit;
- Të bëhen përpjekje për të siguruar një proces përzgjedhjeje plotësisht transparent dhe konkurrues në rinovimin e vazhdueshëm të anëtarësimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
- Zbatimin e konsoliduar dhe rritjen e efikasitetit në parandalimin e korrupsionit, veçanërisht në sektorët me rrezik të lartë;
- Të bëhen përpjekje të mëtejshme për të adresuar rekomandimet e pazgjidhura të GRECO;

- Të bëhet më shumë përparim në fushën e lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe pluralizmit, dhe përafrimin me acquis të BE-së për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Të adresohen sfida të vazhdueshme që lidhen me të drejtat pronësore, duke përfshirë korrupsionin;
- Miratimin e shpejtë të legjislacionit të mbetur zbatues për mbrojtjen e pakicave kombëtare në përputhje me parimin e vetë - identifikimit dhe zbatimin e angazhimeve për përfshirjen e romëve, të marra në nivel ministror;
- Të thellohet bashkëpunimi me Agjencinë e BE-së për Drogën dhe të punohet për ngritjen e një observatori kombëtar të drogës dhe një sistem të paralajmërimit të hershëm. Ky bashkëpunim do të lehtësonte monitorimin dhe luftën kundër trafikut të drogës në nivel kombëtar dhe rajonal;
- Të vijojë konsultimi me shërbimet e Komisionit Evropian për projektaktet e reja ligjore, për të siguruar përputhshmëri me standardet dhe procedurat e BE-së në veçanti me Ligjin për Kultivimin e *Cannabis* për përdorim mjekësor dhe industrial;
- Të ngrihet zyra e posaçme për rikuperimin e aseteve, për të forcuar kapacitetet në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ky hap do të ndihmonte në zbatimin e efektiv të ligjit dhe në rikthimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme;
- Të vijojë shkëmbimii të dhënave në lidhje me emigracionin dhe kërkesat për azil, për të pasur një panoramë të qartë dhe aktuale të situatës së migracionit në rajon, me qëllim lehtësimin e koordinimit të politikave dhe masave për menaxhimin e migracionit;
- Të vijojë shqyrtimi i kërkesave për azil, duke u bazuar në standarde të larta për procedurat dhe të drejtat e personave që kërkojnë azil;
- Komisioni inkurajoi Shqipërinë të përputhë më tej politikën e saj të vizave me listën e vendeve të treta që kanë nevojë për vizë në BE dhe rikujtoi se heqja e vizave sezonale nuk është në përputhje me acquis-të BE-së.

Nënkomiteti nr. 15 i Stabilizim-Asociimit “Inovacioni, shoqëria e informacionit dhe politikat sociale”, zhvilluar më 1 shkurt 2024, në Tiranë

Shqipëria informoi mbi përparimin në:

- Miratimin dhe fillimin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Garancisë Rinore,
- Rritjen e punësimit të punëkërkesve të papunë,
- Punësimin e rreth 3 000 punëkërkesve të papunë që merrnin ndihmë ekonomike përmes shërbimeve dhe programeve të ofruara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit,
- Miratimin dhe zbatimin gjatë vitit 2023 të një programi të ri të nxitjes së punësimit përmes trajnimeve të avancuara në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit,
- Ofrimin e kursit të Kompetencës Digjitale tek rreth 2 000 punëkërkes të papunë gjatë vitit 2023,
- Mbulimin nga skema e ndihmës ekonomike të rreth 95% të aplikantëve,

- Funksionimin e Fondit Social, i cili disbursoi rreth 835 miliard lekë për njësitë e qeverisjes vendore gjatë periudhës 2019 – 2023 për 54 shërbime të reja të kujdesit social, duke dyfishuar numrin e përfituesve,
- Planet për rritjen me 7% të Fondit Social gjatë vitit 2024,
- Alokimin e rreth 240 milion lekëve për mbështetjen e sipërmarrjeve sociale që kanë të punësuar rreth 3 000 individë,
- Miratimin e Ligjit për qeverisjen elektronike,
- Hartimin dhe paraqitjen për miratim në Kuvendin e Shqipërisë të projektligjit për sigurinë kibernetike,
- Përgatitjen e projektligjit për komunikimet elektronike dhe konsultimin e tij me shërbimet e Komisionit Evropian,
- Ratifikimin nga Kuvendi i Shqipërisë të dokumentit të Dialogut Rregullator nënshkruar ndërmjet Bashkimit Evropian dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, në Bruksel, më datë 30 qershor 2023,
- Zhvillimet në rrjetin e komunikimeve elektronike dhe rritjen e numrit të abonentëve në rrjetin me brez të gjerë,
- Mbulimin e territorit të Shqipërisë me rrjetin celular 3G/4G/4G+ gjatë vitit 2023,
- Miratimin e rregullave për Kornizën Kombëtare të Ndërveprueshmërisë,
- Ofrimin e 1 237 shërbimeve elektronike në portalin e-Albania në vitin 2023 krahasuar me 1 227 shërbime elektronike që ofroheshin në 2022,
- Miratimin e ndryshimeve ligjore në Ligjin për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë për të mundësuar vazhdimin e pjesëmarrjes në programin Evropian Krijuese,
- Rritjen e financimit për shkencën në sektorin publik dhe privat gjatë periudhës 2019 – 2024 në kuadër të bashkëpunimit dhe përputhshmërisë me prioritet të Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor, dhe përpjekjet që po bëhen për të përthithur fonde nga programet kombëtare,
- Lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit me qendra kërkimore në Itali të cilat do të plotësojnë më tej grantet kombëtare,
- Prezantimin gjatë vitit 2024 të një programi financimi për kërkuesit e rinj,
- Masat për përmirësimin e kuadrit ligjor për shkencën dhe kërkimin shkencor;
- Zbatimin e ligjit për start-up dhe alokimin e fondeve të mjaftueshme për zbatimin e tij,
- Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023 – 2030, me qëllim nxitjen e kërkimit shkencor në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe social dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare deri në vitin 2030,
- Procesin e hartimit të Ligjit për Shkencën në Shqipëri, me qëllim përcaktimin e kuadrit institucional të shkencës dhe kërkimit shkencor në Shqipëri,
- Monitorimin dhe rezultatet e zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021 – 2026 për të adresuar sfidat në sektorin e arsimit,
- Përkushtimin e Shqipërisë për të mbështetur pakicat kombëtare, grupet e marginalizuara dhe studentët me nevoja të veçanta,
- Fokusin në zhvillimin profesional të mësuesve të pakicave kombëtare,
- Alokimin e rreth 1.5 miliardë lekë gjatë vitit 2023 në mbështetje dhe bursa për studentët. Rreth 43,000 studentë përfituan nga përjashtimi ose ulja e tarifave, mbi 12,500 studentë përfituan bursa ose mbështetje të tjera financiare dhe 7,500 studentë përfituan mbështetje financiare për të mbuluar shpenzimet e akomodimit.

Në kuadër të Nënkomitetit, shërbimet e Komisionit Evropian lanë disa rekomandime për ndjekje në vijim nga institucionet përgjegjëse shqiptare, për:

- Forcimin e kapaciteteve të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive,
- Zbatimin e masave të gjithanshme për eliminimin efektiv të punës së të miturve,
- Miratimin e një strategjie të re për sigurinë dhe shëndetin në punë,
- Zhvillimin e takimeve të rregullta të Këshillit Kombëtar të Punës,
- Vazhdimin e pilotimit të Garancisë Rinore,
- Kryejë analiza të tregut të punës në nivel rajonal për të mbështetur forcimin e aftësive dhe rritur punësimin,
- Miratojë strategjinë e re të mbrojtjes sociale bazuar në vlerësimin e strategjisë aktuale dhe sigurojë kapacitetet njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të Shërbimit Shtetëror Social për zbatimin e saj,
- Përfundojë vlerësimin e ndikimit dhe përshtatshmërisë së ndihmës ekonomike, krijojë një mekanizëm për indeksimin vjetor të ndihmës ekonomike dhe zbatojë udhërrëfyesin për rishikimin e përfitimeve nga ndihma sociale,
- Forcojë kapacitetet e organeve të qeverisjes vendore, veçanërisht atyre me burime financiare të ulëta, për të aplikuar tek Fondi Social, dhe për të planifikuar, prokuruar, menaxhuar dhe ofruar shërbime të reja sociale,
- Rrisë financimin për Fondin Social për të siguruar investime më të mëdha në shërbimet sociale,
- Organizojë trajnime të detyrueshme në përfaqshen e të drejtave të njeriut në paaftësitë për anëtarët e komisioneve të vlerësimit të paaftësisë,
- Vazhdojë reformën e deinstitutionalizimit dhe të mbyllë gradualisht institucionet rezidenciale,
- Miratojë dhe zbatojë në mënyrë efektive Dokumentin e Politikave të Përfshirjes Sociale me përfshirjen e shoqërisë civile,
- Intensifikimin e bashkëpunimit me Eurostat në fushën e statistikave të arsimit, shkencës dhe kërkimit shkencor,
- Rritjen më tej të investimeve në shkencë dhe kërkim shkencor, duke synuar arritjen e nivelit prej 1% tëPBB-së,
- Miratimi i Strategjisë së Zhvillimit të Zgjuar (S3) për të orientuar zhvillimin e ekonomisë shqiptare në vitet e ardhshme,
- Shtimin e masave për të nxitur inovacionin në të gjitha fushat,
- Vazhdojë dhe monitorojë zbatimin e Strategjisë Agjenda Digjitale 2022 – 2026,
- Zbatojë Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Broadband,
- Shfrytëzojë të gjitha mundësitë që ofron Programi Evropa Digjitale,
- Zbatojë Strategjinë e sigurisë kibernetike dhe rishikojë Ligjin për sigurinë kibernetike për të përafuar plotësisht Direktivën NIS2,
- Zbatojë Udhërrëfyesin 5G,
- Miratojë Ligjin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara për të përafuar plotësisht Rregulloren eIDAS dhe të marrë pjesë në Grupin e ekspertëve eIDAS,
- Finalizojë numrin e vetëm të emergjencave 112,
- Miratojë legjislacionin e ri në fushën e mediave audiovizive,
- Lirojë brezin 700MHz nga shërbimet audiovizive,

- Zbatojë Strategjinë e arsimit dhe forcojë kapacitetet njerëzore dhe financiare për zbatimin e saj,
- Shtojë masat për të rritur regjistrimin dhe cilësinë e arsimit parashkollor në veçanti për fëmijët nga grupet në nevojë,
- Marrë masa të mëtejshme për të rritur aksesin në arsim dhe parandalojë braktisjen e shkollës nga fëmijët nga grupet në nevojë, në veçanti romët, egjiptianët, fëmijët me paaftësi, etj,
- Forcojë masat për zhvillimin e vazhdueshëm të mësuesve dhe trajnerëve duke u fokusuar veçanërisht në aftësitë pedagogjike,
- Vazhdojë të përfitojë nga dimensionin ndërkombëtar i programit Erasmus+ duke përfshirë Iniciativën për Universitetet Evropiane,
- Sigurojë resurse të mjaftueshme për optimizimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional,
- Përshejtojë miratimin e akteve nënligjore dhe të sigurojë zbatimin e Ligjit për Trashëgiminë Historike dhe Muzetë,
- Monitorojë zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë dhe Planit të Veprimit.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian është dokumenti kombëtar planifikues për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ai pasqyron planifikimin për një periudhë 3 - vjeçare të politikave, kuadrit ligjor dhe administrativ, masave zbatuese dhe infrastrukturore, si dhe investimeve të nevojshme që Shqipëria të zbatojë politikat, legjislacionin dhe standardet e BE-së. Në një kuptim më të gjerë, PKIE është një udhërrëfyes i reformave të nevojshme për procesin e anëtarësimit në BE.

Objektivat e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian janë:

- planifikimi i transpozimit dhe zbatimit të *acquis* së BE-së në Shqipëri në zbatim të MSA-së dhe procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian,
- përcaktimi i përparësive në reformat kombëtare të lidhura me politikat e BE-së,
- konsolidimi i bazës ligjore, administrative dhe institucionale për përgatitjen për negociatat e anëtarësimit,
- sigurimi i përputhshmërisë së strategjive dhe politikave kombëtare me masat që synojnë zbatimin e *acquis* së BE-së,
- identifikimi i nevojave dhe përshtatja e kuadrit institucional për zbatimin e *acquis* së BE-së,
- orientimi i planifikimit të fondeve kombëtare dhe ndihmës së huaj për të mbështetur prioritetet e reformave të lidhura me BE-në.

Gjatë hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026, nga institucionet kryesuese të kapitujve të *acquis* dhe grupet ndërinstitucionale të punës të ngritura për secilin kapitull të *acquis*, u mbajtën parasysh:

- rekomandimet e takimeve të institucioneve të përbashkëta ngritur në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit,
- rekomandimet e raporteve vjetore të Komisionit për Shqipërinë,

Raport për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

- prioritizimet në bazë të analizave të mangësive legislative e administrativo-institucionale të bërë nga grupet ndërinstitucionale të punës për integrimin evropian, kryer në kuadër të procesit *screening*,
- raporti *screening* i përgatitur nga shërbimet e Komisionit Evropian për grupkapitullin e parë “Themelorët”.

Me synimin për të përmirësuar cilësinë e planifikimit në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026, gjatë fazës përgatitore u morën masat e mëposhtme:

- përmirësimi i metodologjisë së hartimit dhe monitorimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian,
- zhvillimi i takimeve në ministritë e linjës dhe grupet ndërinstitucionale të punës (GNPIE) për përgatitjen e PKIE-së,
- u kontrollua përputhshmëria ndërmjet PKIE 2024 – 2026 dhe programit vjetor legjislativ të Këshillit të Ministrave.

Në vijim startoi procesi i konsultimit publik, ku sipas parashikimeve të Ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026” u publikua në datën 14 nëntor 2023, në faqen e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Kohëzgjatja e konsultimit publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike ishte 20 ditë. Konsultimi publik u mbyll më datë 15.12.2023.

Nëpërmjet Regjistrit Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, projektvendimi i Këshillit të Ministrave, u vëzhgua nga 797 zyrtarë dhe grupet e interesit, gjatë periudhës së publikimit. Në përgjigje, u dorëzuan 2 komente nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV), si dhe një koment nga një person fizik.

Në vijim u hartua raporti i konsultimit publik të PKIE 2024 – 2026 i cili u publikua në faqen e regjistrit elektronik të konsultimit publik.² Vlen të përmendet se komentet e marra gjatë fazës së konsultimit publik kanë pasur karakter të përgjithshëm.

Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026 u miratua me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 11.1.2024 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026”.

Zbatimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026 do të monitorohet rregullisht siç përcaktohet në vendim nr. 16, datë 11.1.2024 të Këshillit të Ministrave.

Monitorimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026

²<https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/681>

Nga monitorimi i realizimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024 – 2026, vërehet se, gjatë tremujorit të parë Janar-Mars 2024, janë miratuar 10 akte ligjore nga 102 akte të planifikuara në total.

Si më poshtë vijon aktet e miratuara:

1. Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 77, datë 13.02.2024 “Për miratimin e planit të veprimit 2024 – 2030 “Mjaftueshmëria me gjak të sigurtë cilësor”,
2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 13.3.2024 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”,
3. Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 57, datë 13.3.2024 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave zbatuese të vlefshmërisë ajrore dhe të certifikimit mjedisor ose deklaratën e përputhshmërisë së avionit dhe produkteve të lidhura me to, pjesëve dhe pajisjeve, si dhe për kërkesat e aftësisë së organizatave të projektimit dhe prodhimit”,
4. Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 61, datë 18.3.2024 “Për miratimin e rregullores për specifikimet shtesë të vlefshmërisë ajrore për një tip të caktuar të operimeve”,
5. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 6.3.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar,
6. Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 4, datë 9.2.2024 “Për vendosjen e niveleve maksimale, për disa kontaminues në ushqime”,
7. Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 2, datë 30.1.2024 “Për miratimin e programeve të kontrollit dhe inspektimit të disa formave të peshkimit”
8. Projektligji “Për sigurinë kibernetike”, miratuar në Këshillin e Ministrave më datë 11.01.2024,
9. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 82/2021 “Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar”, miratuar në Këshillin e Ministrave më datë 20.03.2024,
10. Projektligj “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”, miratuar në Këshillin e Ministrave më datë 27.03.2024.

PJESA II: NEGOCIATAT PËR ANËTARËSIMIN NË BASHKIMIN EVROPIAN

Zhvillimi i Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 19 korrik 2022, shënoi fillimin zyrtar të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Hapja e negociatave mbi bazë merite ishte një arritje historike për Shqipërinë, por në të njëjtën kohë ajo shënoi edhe fillimin e një procesi transformues të gjithanshëm për Shqipërinë.

Menjëherë pas Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 15 shtator 2022, filloi procesi i shqyrtimit analitik të *acquis* (*screening*), si hapi i parë i negociatave të anëtarësimit, u finalizua në nëntor të vitit 2023. Procesi i shqyrtimit kryhet së bashku me Komisionin Evropian dhe i lejon vendit kandidat të familjarizohet me *acquis* dhe, më pas, të tregojë nivelin e përafrimit me legjislacionin e BE-së, si dhe të përvijojë planet për përafrimin e mëtejshëm.

Procesi *screening* zhvillohet në 2 faza:

- i) **takimet shpjeguese** – ku shërbimet e Komisionit Evropian paraqesin zhvillimet e legjislacionit dhe politikave të Bashkimit Evropian dhe
- ii) **takimet bilaterale** – ku pala shqiptare analizon dhe paraqet situatën aktuale ku ndodhet vendi përkundërt kërkesave të *acquis* së BE-së, përmes prezantimeve për çështje të ndryshme sipas kapitujve & nënkapitujve.

Në përputhje me metodologjinë e re të zgjerimit (2020), negociatat zhvillohen bazuar në 6 (gjashtë) grupime kapitujsh: grupimi i parë “Themeloret”, grupimi i dytë “Tregu i brendshëm”, grupimi tretë “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse”, grupimi i katërt “Agjenda e gjelbër dhe ndërlidhja e qëndrueshme”, grupimi i pestë “Burimet, bujqësia dhe kohezioni”, grupimi i gjashtë “Marrëdhëniet e jashtme”.

Hapja e negociatave bëhet sipas grupimeve (të gjithë kapitujt/kriteret e një grupimi plotësohen për hapjen në të njëjtën kohë), ndërkohë që mbyllja bëhet individualisht për çdo kapitull/kriter. Grupimi mbyllet kur çdo kapitull i tij është mbyllur paraprakisht.

Në përputhje me metodologjinë e Bashkimit Evropian, grupimi i parë “Themeloret” është grupimi që hapet i pari dhe mbyllet i fundit, pasi Shqipëria ka përmbushur të gjitha kriteret e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Në zbatim të metodologjisë për anëtarësim, Shqipëria shënoi një tjetër hap shumë të rëndësishëm në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian. Procesi i shqyrtimit të përputhshmërisë, i njohur si “*screening*” përfundoi me sukses në muajin nëntor 2023 në Bruksel me plot vlerësime nga nivele të larta drejtuese të Komisionit dhe Parlamentit Evropian.

- **Shqyrtimi analitik/*screening* për Grupimin e parë “Themeloret”, (15 shtator 2022 – 16 janar 2023)** ku përfshihen kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”, kapitulli 5 “Prokurimi publik”, kapitulli 18 “Statistikat”,

kapitulli 32 “Kontrolli financiar”, kriteri ekonomik, funksionimi i institucioneve demokratike, si dhe reforma në administratën publike.

- **Shqyrtimi analitik/screening për Grupimin e dytë “Tregu i brendshëm”, (7 tetor 2022 – 9 mars 2023)** ku përfshihen kapitulli 4 “Lëvizja e lirë e kapitalit”, kapitulli 9 “Shërbimet financiare”, kapitulli 1 “Lëvizja e lirë e mallrave”, kapitulli 3 “E drejta e vendosjes dhe liria e ofrimit të shërbimeve”, kapitulli 7 “E drejta e pronësisë intelektuale”, kapitulli 6 “Legjislacioni për ndërmarrjet”, kapitulli 8 “Konkurrenca”, kapitulli 2 “Lëvizja e lirë e punëtorëve” dhe kapitulli 28 “Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit”.
- **Shqyrtimi analitik/screening për Grupimin e tretë “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse, (17 tetor 2022 – 8 qershor 2023)** ku përfshihen kapitulli 10 “Shoqëria e informacionit dhe media”, kapitulli 19 “Politikat sociale dhe punësimi”, kapitulli 26 “Arsimi dhe kultura”, kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe politikat industriale”, kapitulli 29 “Doganat”, kapitulli 16 “Tatimet”, kapitulli 17 “Politika monetare” dhe kapitulli 25 “Arsimi dhe shkenca”.
- **Shqyrtimi analitik/screening për Grupimin e katërt “Agjenda e Gjellbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme”, (15 mars 2023 – 29 shtator 2023)** ku përfshihen kapitulli 14 “Transporti”, kapitulli 15 “Energjia”, kapitulli 21 “Rrjetet trans-evropiane” dhe kapitulli 27 “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike”.
- **Shqyrtimi analitik/screening për Grupimin e pestë “Burimet, bujqësia dhe kohezioni”, (17 korrik 2023 – 24 nëntor 2023)** ku përfshihen kapitulli 11 “Bujqësia dhe zhvillimi rural”, kapitulli 12 “Politikat e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”, kapitulli 13 “Peshkimi”, kapitulli “Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore” dhe kapitulli 33 “Dispozitat Financiare dhe Buxhetore”.
- **Shqyrtimi analitik/screening për Grupimin e gjashtë “Marrëdhëniet me jashtë”, (26 shtator 2023 – 17 nëntor 2023)** ku përfshihen kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë” dhe kapitulli 31 “Politika e jashtme e sigurisë dhe e mbrojtjes”.

Gjatë procesit screening për të gjashtë Grupimet e parashtruara më sipër:

- janë zhvilluar 36 takime dypalëshe për shqyrtimin analitik për 33 kapituj dhe 3 kriteret e Bashkimit Evropian;
- janë përfshirë mbi 1000 punonjës nga institucionet qeveritare dhe të pavarura;
- janë përfshirë mbi 130 institucione të përfshira në këtë proces, të cilat janë institucione qendrore, agjenci zbatuese, institucione të pavarura, institucione jobuxhetore, etj.
- janë përgatitur 777 prezantime të paraqitura në takimet bilaterale, në përputhje me agjendat, të relatuara dhe argumentuara nga përfaqësues institucionesh;

Në vijim të përmbushjes në kohë dhe me vlerësim të procesit screening, Shqipëria, menjëherë pas finalizimit të takimeve screening në 24.11.2023, mori zyrtarisht në 30.11.2023, letrën e Presidencës Spanjolle të Këshillit, për përgatitjen dhe miratimin e piketave hapëse për çeljen e negociatave për Grupkapitullin I “Themeloret”.

Në përputhje me letrën e Presidencës Spanjolle, Shqipëria e cila kishte nisur përgatitjet proaktivisht muaj përpara, për përgatitjen e dy piketave hapëse (të përcaktuara që paraprakisht në metodologjinë e zgjerimit), finalizoi në kohë dhe miratoi në datë 13.12.2023, me vendim të Këshillit të Ministrave, piketat hapëse të negociatave për Grupimin e parë të kapitujve ‘Themeloret’:

- **Udhërrëfyesin “Shteti i së Drejtës”:** Udhërrëfyesi është një dokument politik për Shtetin e së Drejtës, i cili përfshin kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe kapitullin 24 “Drejtësia, Liria dhe Siguria”. Ky Udhërrëfyes parashikon masa ligjore, administrative dhe institucionale, si dhe angazhime që Shqipëria merr në kuadër të negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Qëllimi i hartimit të tij është që nëpërmjet adresimit të hendeqeve të identifikuara në kuadër të procesit të shqyrtimit analitik të *acquis*, si dhe prioritizimit të masave në këtë drejtim, të sigurojë përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e negociatave dhe integritet evropian. Masat prioritare në këtë udhërrëfyes adresojnë çështjet që lidhen me gjyqësorin, antikorrupsionin, të drejtat themelore, garantimin e të drejtave të qytetarëve të Bashkimit Evropian, luftën kundër krimit të organizuar, bashkëpunimin në luftën kundër drogës, luftën kundër terrorizmit, bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale e civile, migracionin e rregullt dhe të parregullt, azilin, politikën e vizave, kufijtë schengen dhe falsifikimin e Euro-s.
- **Udhërrëfyesin “Reforma në Administratën Publike”:** Udhërrëfyesi është një dokument politik që mbështet reformën në administratën publike, me një plan masash prioritare, për periudhën kohore 2023 – 2030. Qëllimi i hartimit të tij është që nëpërmjet adresimit të hendeqeve të identifikuara në kuadër të procesit të shqyrtimit analitik të *acquis* – kriterëve për anëtarësimin të RAP. Masat prioritare në këtë udhërrëfyes organizohen në 5 shtylla, bazuar në parimet e Bashkimit Evropian mbi administratën publike:
 - Zhvillimi dhe koordinimi i politikave;
 - Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore;
 - Organizimi i administratës publike, llogaridhënia dhe transparenca;
 - Ofrimi i shërbimeve ndaj publikut;
 - Menaxhimi i financave publike.

Në secilën prej shtyllave të mësipërme planifikohen masa në drejtim të: (i) kuadrit strategjik/legjislativ/institucional; (ii) zbatimit të reformave dhe kapaciteteve institucionale; (iii) funksionimit dhe performancës së administratës publike.

Piketat hapëse të negociatave u dërguan zyrtarisht pranë Komisionit Evropian në datë 13.12.2023. Shqipëria ka përmbushur kërkesat teknike (procesin *screening* dhe përgatitjen dhe miratimin e piketave hapëse) për hapjen e negociatave për Grupkapitullin I “Themeloret”.

Në këtë periudhë raportuese rezulton se strukturat negociuese/Grupi i Negociatorëve, nën drejtimin e Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator kanë qënë produktive dhe ka luajtur një rol aktiv në koordinimin e punës për arritjen e rezultateve të synuara lidhur me përgatitjet për procesin *screening* dhe hapjen e negociatave, si dhe përmbushjen e detyrimeve në kuadër të zbatimit dhe raportimit të MSA-së. Më specifikisht, janë zhvilluar dy (2) takime³, të Grupit Negociator, me rreth 4 tematika të rëndësishme, ku fokusi i diskutimit kanë qënë (i) prioritetet e integritet evropian dhe anëtarësimin për vitin 2024, (ii) plani i Rritjes/Growth Plan & Agjenda e Reformave, (iii) Platforma e Integritet Evropian dhe Anëtarësimin (PIEA) si dhe (iv) Platforma e Partneritetit dhe Integritet Evropian.

³ 1 shkurt 2024, 28 mars 2024

Lidhur me veprimtarinë e strukturave negociuese/Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian, gjatë periudhës Janar-Mars 2024 rezultoi se kanë zhvilluar rreth 72 takime, në 36 GNPIE-të, ku janë të angazhuar rreth 1500 anëtarë.

Për periudhën raportuese Janar-Mars rezultoi se janë zhvilluar 33 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, me 47 tematika prioritare diskutimi, me një pjesëmarrje në total të 492 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (177), përfaqësuesve nga shoqëria civile (80), përfaqësuesve nga akademia/universitetet (166), përfaqësuesve nga pushteti vendor (28), përfaqësuesve të organizatave punëmarrëse (2), përfaqësuesve të biznesit (28) dhe media (11).

Në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me Metodologjinë e re për zgjerim të Komisionit Evropian COM(2020) 57, datë 05.02.2020, ku një nga kriteret e anëtarësimit dhe kusht thelbësor për të gjitha vendet candidate për t'u bërë shtet anëtar lidhet me forcimin e kapaciteteve administrative dhe institucionale, Departamenti në rolin e Sekretariatit të Përgjithshëm për Integrimin Evropian në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike ka iniciuar procesin dhe në periudhën raportuese ka konsoliduar dhe aprovuar paketën e plotë lidhur me vlerësimin e nevojave për trajnim të strukturave dhe mekanizmit të integritit evropian për vitet 2024-2025, me qëllim marrjen e masave për trajnime adekuata të zbatimit në mënyrë efektive të Acquis të BE-së si dhe aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit.

Proceset e ndërmarra në kuadër të konsolidimit të Planit Kombëtar të Kapaciteteve të Integritit Evropian 2024-2025, vazhduan nga departamenti në rolin e Sekretariatit të Përgjithshëm për Integrimin Evropian në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare për Administratën Publike, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Kryerja e Vlerësimit paraprak të bazës ligjore mbi funksionet dhe detyrat e Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian si një nga komponentët kryesorë të mekanizmit të Integritit Evropian dhe të strukturave përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian me qëllim: a) realizimin e procesit të shqyrtimit të përafritit dhe të vlerësimit të legjislacionit të brendshëm me acquis të Bashkimit Evropian (screening); b) përcaktimin dhe hartimin e qëndrimeve negociuese të Republikës së Shqipërisë për secilin kapitull të acquis të Bashkimit Evropian; c) negocimin dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
- Konsolidimi i Kuadrit Metodologjik për vlerësimin e nevojave të kapaciteteve të strukturave të integritit evropian/mekanizmit të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE), që lidhet drejtpërsëdrejti me përmbushjen e detyrimeve të MSA-së në kuadër të forcimit të kapaciteteve dhe aftësive në zbatim të procesit të integritit vecanërisht lidhur me strukturat dhe mekanizmat koordinues të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
- Konsolidimi i Anketës Kombëtare të Kapaciteteve: Procesi i vlerësimit të nevojave të kapaciteteve të strukturave të integritit evropian/mekanizmit të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian (GNPIE) u realizua nëpërmjet anketës/pyetësorit, që kishte për qëllim identifikimin e nevojave për trajnim për çështje me natyrë të përgjithshme ashtu edhe për çështje me natyrë të profilizuar të lidhura

- ngushtësisht me 36 GNPIE si dhe nevojat në mbështetje të detyrave funksionale të anëtarëve të GNPIE-ve;
- Hartimi i fishave/ pyetësorëve të digjitalizuar për analizimin e nevojave për rritje kapacitetesh për çdo kapitull/ kriter të acquis;
 - Udhëzime në tryeza të dedikuara pune me Rrjetin e Integritimit Evropian dhe përfaqësues të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integritimin Evropian (GNPIE) për të diskutuar kuadrin metodologjik dhe fishat për çdo GNPIE, sipas çdo kapitulli që lidhen me nevojat e kapaciteteve të mekanizmit të integritimit evropian (GNPIE);
 - Dërgimin zyrtarisht të kuadrit metodologjik & fishave çdo anëtar i GNPIE-së sipas çdo kapitulli, lidhur me rritjen e kapaciteteve të mekanizmit të integritimit evropian (GNPIE);
 - Plotësimi i fishave nga çdo anëtar i GNPIE sipas çdo kapitulli lidhur me nevojat e kapaciteteve të mekanizmit të integritimit evropian (GNPIE) nga institucionet: (dhjetor 2023);
 - Përpunimi dhe konsolidimi i të dhënave, si dhe hartimi i Paketës së 36 Raporteve të Vlerësimit të Nevojave për Trajnim 2024-2025, të mekanizmit të Integritimit Evropian (36 Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integritimin Evropian): (janar 2024);
 - Identifikimi i kuadrit të Prioritizimit të nevojave të kapaciteteve të mekanizmit të integritimit evropian (GNPIE) për periudhën 2024-2025: (shkurt 2024);
 - Përpunimi dhe konsolidimi i të dhënave, si dhe hartimi i Paketës së 6 Profileve Kombëtare të Kapaciteteve për Trajnim 2024-2025, të 6 Grupimeve të Kapitujve të Aquis për Integritimin Evropian & Anëtarësimin, ku paraqiten në mënyrë shteruese analitike nevojat, hendeuku si dhe identifikohet lista prioritare e nevojave për trajnim sipas cdo Grupimi të Aquis të BE-së në përputhje me Metodologjinë e re për zgjerim të Komisionit Evropian COM(2020) 57, datë 05.02.2020: (shkurt 2024);
 - Gjatë tre-mujorit të parë (Janar – Mars) 2024 u konsolidua Plani i Kapaciteteve të Integritimit Evropian/Profili Kombëtar i Kapaciteteve për Trajnim 2024-2025, ku paraqitet situata tërësore lidhur me 36 Grupet Ndërinstitucionale të Punës për Integritimin Evropian si dhe të 6 Grupimeve të Kapitujve të Aquis për Integritimin Evropian & Anëtarësimin;
 - Paketa e plotë e Planit të Kapaciteteve të Integritimit Evropian/Profili Kombëtar i Kapaciteteve të Integritimit Evropian për Trajnim 2024-2025 u prezantua dhe u aprovua në një tryezë të dedikuar me Rrjetin e Integritimit (Mars 2024).

Gjithashtu, gjatë tre-mujorit të parë (Janar-Mars) 2024, Sekretariati i Integritimit Evropian konsolidoi paketën metodologjike të Kornizës së Përbashkët të Vlerësimit lidhur me kapacitetet dhe strukturat për integritimin evropian dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian (CAF). Qëllimi i kësaj kornize metodologjike është kryerja e një vlerësimi gjithëpërfshirës të kapaciteteve dhe strukturave të integritimit evropian në zbatim të përgjegjësive dhe detyrave të tyre të përcaktuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Paketa metodologjike e Kornizës së Përbashkët të Vlerësimit lidhur me kapacitetet dhe strukturat për integritimin evropian dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian (CAF) u procedua zyrtarisht tek të gjithë Negociatorët përgjegjës për çdo kapitull të acquis, me qëllim marrjen e masave për zbatimin e kuadrit metodologjik, me synim që faza e vetëvlerësimit të kapaciteteve për integritimin evropian të finalizohet brenda afateve.

2.1 Grupimi i kapitujve 1 “Themeloret”

Ky grupim përbën bazën e shtetit të së drejtës. Ai synon ngritjen e një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe eficient dhe një sistem mbrojtjeje efektiv të të drejtave themelore (kriteri “Funksionimi i Institucioneve Demokratike”), çështje të sigurisë, luftën ndaj korrupsionit, krimi i organizuar apo emigracioni i paligjshëm (kapitulli 23, kapitulli 24) etj.

Në këtë grupim kapitujsh janë përfshirë dhe çështje me karakter ekonomik, si prokurimet publike (kapitulli 5) apo kontrolli financiar (kapitulli 32). Parimet e mirë administrimit dhe kontrollit financiar duhet të zbatohen nga e gjithë administrata publike, qendrore e vendore dhe përfshin kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin si të fondeve publike, ashtu dhe të fondeve që jep Bashkimi Evropian. Ky Grupim është i rëndësishëm dhe kërkon ngritjen e sistemeve transparente të menaxhimit, përfshirë instrumente për kontrollin dhe llogaridhënien (kriteri RAP). “Statistikat” është gjithashtu një kapitull i rëndësishëm, pasi gjatë të gjithë kapitujve dhe grupimeve të kapitujve, gjatë negociatave do të duhet të sigurojnë të dhëna reale, të besueshme dhe të jepen statistika reale për fushat specifike (kapitulli 18).

Gjatë periudhës Janar-Mars 2024 janë zhvilluar rreth 24 takime, në 8 GNPIE-të e Grupimit “Themeloret”, ku janë të angazhuar rreth 662 anëtarë.

Më specifikisht, në 24 takimet e zhvilluara të mekanizmit për Grupimin I ‘Themeloret’, disa nga çështjet e trajtuar, diskutuar dhe konsultuar lidhen me (i) vlerësimin e nevojave për trajnim (GNPIE) 2024 – 2025; (ii) vlerësimin e Tryezave të Diskutimit, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE); (iv) bashkërendim në kuadër të projektit pilot të Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (KESE) adresuar përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve nga vendet candidate; (v) analizë dhe identifikim të masave të parashikuara në Planet e së Ardhmes ‘Future plans’; (vi) raportin e Monitorimit për Reformën në Administratën Publike (PAR) për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë për vitin 2024, të SIGMA; (vii) diskutime dhe analiza lidhur me projektligjin për koncesionet dhe PPP-të; (viii) Platforma e Integritetit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA); (ix) Progres raportin dhe kontributet për vitin 2024; (x) monitorimi i rekomandimeve të BE-së’ (xi) përditësimi i listave të përdoruesve të Platformës PIEA të Grupeve Ndërinstitucionale; (xii) konsolidimi i Pozicionit Negociues; (xiii) vizionin dhe masat prioritare për energjizimin dhe motivimin e administratës publike shqiptare. Modernizimi, inovacioni, mirëqeverisje; (xiv) diskutime lidhur me draft dokumentin strategjik të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike dhe planin e veprimit; (xv) procesin e vlerësimit të SIGMA si dhe marrjen e masave, njohje me pyetësonin dhe metodologjinë; (xvi) masat për etikën dhe integritetin, (xv) monitorimin e udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës; (xvi) kontribut dhe diskutime lidhur me matricën e Migracionit të ligjshëm dhe të paligjshëm, (xv) raportimi i Rule of Law Report dhe metodologjine e ndjekur; (xvi) monitorimin e PKIE dhe PKBAE; (xvii) diskutime lidhur me përshtatjen e Udhërrëfyesit të FDI sipas sugjerimeve të Komisionit Evropian si dhe njohjen paraprake me mekanizmin e monitorimit të udhërrëfyesit dhe masave, nën-masave zbatuese si dhe indikatorëve’ (xviii) diskutime lidhur me gjetjet dhe rezultatet e Indeksve të raportit vjetor PSIE 2023 për Grupimin II ‘Tregu i Brendshëm’; (xix) diskutime lidhur me planifikimin në kuadër të Planit Menaxherial (Semestral) i Integritetit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE 2024) për Grupimin, etj.

Referuar matjes së efektivitetit të mekanizmit, bazuar në trajtimin dhe ndjekjen e çështjeve, prioriteteve që lidhen me procesin e negociatave dhe zbatimin e rekomandimeve të BE-së për integrimin evropian, rezulton se nga 24 takime të zhvilluara gjatë kësaj periudhe raportuese (janar-mars) çështjet prioritare të trajtuara janë ndjekur (38 konkluzione), duke e bërë funksional mekanizmin *feedback* (MF).

Disa nga konkluzionet që mekanizmi i qeverisjes për integrimin evropian për Grupimin I “Themelorët” ka ndjekur gjatë kësaj periudhe raportuese lidhen me (i) përfaqësimin në Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social (KESE) si pjesë e projektit pilot që po ndërmerr Komisioni Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor,;(ii) konsolidimin e nevojave për trajnim të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian,;(iii) finalizimin e pyetësorit për Tryezat e Diskutimit për Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian; (iv) dorëzimi i raportit të monitorimit për reformën e administratës publike për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë për vitin 2024 e bashkërenduar me SIGMA/OECD; (v) hartimi i planeve të punës për ndjekjen e ‘Planeve të së Ardhm’s’/Future Plans; (vi) konsolidimi i Pozicioneve Negociuese; (vii) koordinim mbi mbulimin e raportimit për dokument strategjik nën PAR (5 strategjitë); (viii) zbatimi i masave të parashikuara për 2024 në Udhërrëfyesin RAP për etikën dhe integritetin; (viii) monitorimi i Udhërrëfyesit të Reformës në Administratën Publike; (viii) konsolidimi i raportit ‘Rule of Law Report’; (ix) ndjekje e Planit Menaxherial (Semestral) i Integritit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE 2024) për Grupimin; (x)përdorimi dhe funksionalizimi i Platformës së Integritit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA), etj.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të strukturave të integritit, rezulton se 469 anëtarë të strukturave respektive janë trajnuar përmes skemës së trajnimit përmes Sekretariatit të Integritit Evropian në kuadër të procesit të integritit evropian dhe anëtarësimit, 31 anëtarë janë trajnuar përmes skemave të shkëmbimit të njohurive me komisionin evropian në kuadër të procesit të integritit, dhe 45 anëtarë janë trajnuar përmes skemave të shkëmbimit të njohurive me institucione të vendeve anëtare.

Tematikat e trajnimeve adresonin çështje të ndryshme, si (i) trajnime në kuadër të procesit të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Prokurimit Publik – OBT; (ii) Prokurimi publik i Gjellbër: Një qasje moderne strategjike e prokurimit”, (iii) hartimin e Pozicionit Negociues, (iv) mekanizmin e monitorimit të Udhërrëfyesve; (v) identifikimin e nevojave për trajnim në të ardhmen për çështje me natyrë të përgjithshme të lidhura me procesin e Integritit, ashtu si edhe për çështje me natyrë specifike të lidhura ngushtësisht me politikat që mbulon çdo GNPIE, (vi) trajnime lidhur me funksionalitetet e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin (PIEA), etj.

Procesi *screening* për grupimin e parë të kapitujve filloi zyrtarisht në 15 shtator 2022 dhe u finalizua më 16 janar 2023. Të gjitha strukturat negociuese të përfshira në grupimin e parë kanë bërë një punë intensive për finalizimin e procesit *screening* brenda 4 muajve.

Pas përfundimit të takimeve *screening* për grupimin e parë të kapitujve “Themeloret”, Komisioni Evropian në 20 korrik 2023 publikoi draft raportin e shqyrtimit analitik (*Screening*

Report)⁴, i cili pasqyron gjetjet e Komisionit Evropian për situatën aktuale të vendit përkundrejt kërkesave të EU acquis për “Themeloret”.

Në kuadër të dërgimit të Raportit *Screening* nga Komisioni Evropian, janë ndërrmarë masat e nevojshme nga qeveria shqiptare në përputhje me metodologjinë e zgjerimit të BE-së, specifikisht si më poshtë vijon:

Përgatitjen e piketave hapëse (*Opening Benchmarks*) për Grupimin e parë të kapitujve “Themeloret” të cilat janë: hartimi i draft Udhërrëfyesit të “Shtetit të së Drejtës” si dhe draft Udhërrëfyesi për “Reformën në Administratën Publike” sikurse paracaktuar në metodologjinë e zgjerimit. Këto dy dokumente u miratuan me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 736 datë 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës" si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 13.12.2023 “Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023–2030”.

Të dy Udhërrëfyesit përmbajnë prioritetet kyçe të reformave dhe drejtojnë negociatat e anëtarësimit në këto fusha, ndërsa Shqipëria po përgatitet të përmbushë kërkesat për anëtarësimin në BE, si dhe përcaktojnë në mënyrë strategjike dhe të fokusuar veprimet dhe reformat kyçe në fushat përkatëse me afate të qarta dhe sekuencën e hapave kyç të parashikuar. Udhërrëfyesit gjithashtu adresojnë boshllëqet që lidhen me kuadrin strategjik dhe legjislativ, me kapacitetin zbatues dhe institucional, si dhe me funksionimin e institucioneve publike dhe performancën e tyre në përputhje me standardet dhe legjislacionin përkatës të BE-së.

Totali i masave të parashikuara së bashku për të dy Udhërrëfyesit është 717 masa, me kohë shtrirje vitet 2024 - 2030.

Në përputhje me Kuadrin Negociator (paragrafi 36), Shqipëria gjithashtu duhet të përgatisë dhe miratojë një Udhërrëfyes për Funksionimin e Institucioneve Demokratike. Ky Udhërrëfyes nuk përfshihet në piketat hapëse të parashikuara në paragrafin 34 të Kuadrit Negociator.

“Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike ” është një dokument politik dhe strategjik i cili paraqet masat kryesore që parashikohen të merren në kuadër të procesit të adresimit të gjetjeve të paraqitura nga Komisioni Evropian në raportin e shqyrtimit analitik (*screeningreport*) për Shqipërinë për sa i përket Kriterit Politik, kryesisht Funksionimit të Institucioneve demokratike. Qëllimi i hartimit të tij është të paraqesë masat politike kryesore që vendi ynë merr në procesin e negociatave për anëtarësim në BE për sa i përket Funksionimit të Institucioneve Demokratike.

Në kontekst të këtij udhërrëfyesi janë zhvilluar 4 takime bashkërenduese me Komisionin Evropian për konsolidimin e këtij dokumenti si dhe më datë 27.12.2023 është hedhur në platformën e konsultimit publik për konsultim me opinionin e gjerë publik, ekspertë të fushës dhe shoqërinë civile duke plotësuar të gjitha kërkesat për konsultimin publik. Komentet dhe kontributet e institucioneve janë përcjellë me shkresa zyrtare. Njëkohësisht janë pasqyruar

⁴Raporti i publikuar në faqen e Komisionit: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-07/AL%20Cluster%20Draft%20screening%20report_external%20version.pdf

edhe disa nga komentet e OSHC-ve, duke e bërë një dokument të konsultuar gjerësisht dhe transparent.

Në datën 11 janar 2024 u mbajt takimi i radhës me Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian. Në takim u diskutua rreth përgatitjes së deritanishme të Shqipërisë për procesin e antarësimit në Bashkimin Evropian, si dhe sfidat e së ardhmes. Përgjatë takimit u prezantua Draft Udhërrëfyesi për Funksonimin e Institucioneve Demokratike ku u diskutua me përfaqesuesit e shoqërisë civile për të gjitha masat e parashikuara në udhërrëfyes. Në këtë takim morën pjesë përfaqesues nga shoqëria civile, bota akademike dhe ekspertë të fushës të cilët pasi ishin njohur me dokumentin shprehën interes, shfaqën sugjerimet e tyre dhe diskutuan në mënyrë aktive.

Në datën 22 janar 2024 u mbajt takimi i radhës së Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian me temë “Konsultimi i draft Udhërrëfyesit për Funksonimin e Institucioneve Demokratike”, me përfaqësues të shoqërisë civile, ekspertë të botës akademike, botës së biznesit dhe studentë të fakulteteve të drejtësisë. Në takim u diskutua rreth rolit të shoqërisë civile gjatë procesit të monitorimit të masave dhe prioritetëve të parashikuara në këtë draft Udhërrëfyes. Gjatë takimit theks i veçantë u vendos në përfshirjen e OSHC-ve gjatë procesit zgjedhor, kryesisht në përmirësimin e cilësisë mediatike dhe mbikëqyrjen e financimeve të partive politike dhe institucioneve mediatike formale apo informale të shtuara në masë vitet e fundit. Anëtarët e Tryezës dhe pjesëmarrësit shtruan pyetje ashtu si për punën e vazhdueshme të OJF-ve në përmirësimin e funksionimit e institucioneve demokratike si dhe në ndërmarrjen e masave konkrete për përfshirjen e tyre në proces.

Në datën 29 mars 2024 u mbajt takimi i radhës së Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian ku u diskutua për Planin e Ri të rritjes për Ballkanin Perëndimor. Gjatë takimit u prezantua plani me të 4 shtyllat e tij dhe pritshmëritë e vendit mbi këtë program. Gjithashtu në takim u prezantuan disa nga progreset e arritura lidhur me kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore” dhe kriterin “Funksionimi i Institucioneve Demokratike” si dhe u informuan anëtarët lidhur me procesin.

Më datë 11 janar 2024 u zhvillua takimi i Konferencës së Kyetarëve të grupeve parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë. Në këtë takim u vendos miratimi i Planit të Veprimit për adresimin e rekomandimeve për Kuvendin në raportin e Komisionit Evropian për shqyrtimin analitik për grupimin e parë, ‘Themeloret’, gjithashtu u diskutua dhe lidhur me masat e parashikuara në Udhërrëfyesin për Funksonimin e Institucioneve Demokratike duke synuar konsolidimin sa më të shpejtë të këtij dokumenti.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese për Grupimin e parë “Themeloret”, paraqiten si më poshtë vijon:

Sa i përket arritjeve në fushën e drejtësisë, procesin e *vettingut*, për periudhën janar – mars 2024, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka nxjerrë 23 vendime nga të cilat 15 vendime për konfirmim në detyrë të 5 gjyqtarëve, 8 prokurorëve, 2 këshilltarëve ligjorë dhe 8 vendime për shkarkimin nga detyra të 3 gjyqtarëve, 4 prokurorëve, 1 këshilltarit ligjor;

Sa i përket Kolegjit të Posaçëm të Apelit si organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet e paraqitura nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të

Pavarur të Kualifikimit, për periudhën raportuese ka regjistruar 11 çështje të juridiksionit të rivlerësimit, nga të cilat 2 janë ankimuar nga Komisioneri Publik, 8 nga subjektet e rivlerësimit dhe 1 çështje është ankimuar edhe nga Komisioneri Publik, edhe nga subjekti i rivlerësimit. Deri më 31.03.2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar në total 372 çështje, nga të cilat, 241 çështje kanë përfunduar. Aktualisht, janë duke u shqyrtuar 131 çështje, nga të cilat 11 çështje janë nën gjykim (6 në seancë publike dhe 5 në dhomë këshillimi), ndërsa 120 çështje janë me status përgatitje për gjykim.

Për periudhën 1 janar – 31 mars 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë shpallur 11 vendime. Nga këto 11 çështje të cilat kanë përfunduar, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka vendosur:

- Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit – në 6 vendime
- Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit - në 2 vendime
- Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit - në 2 vendime
- Përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për çështjen, për shkak se objekti dhe qëllimi është bërë i pamundur – në 1 vendim

Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve është parashikuar në nenin 53 të ligjit Nr. 84/2016; për periudhën 1 janar – 31 mars 2024, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar dhe trajtuar 44 denoncime.

Në shkurt 2024 Shqipëria nënshkroi Konventën Lubjanë-Hagë. Nënshkrimi i kësaj konvente është një hap vendimtar për Shqipërinë në luftën kundër pandëshkueshmërisë së krimeve ndërkombëtare, kompensimit të viktimave të tyre dhe në forcimin e drejtësisë penale. Në firmosjen e Konventës morën pjesë 43 shtete të ndryshme.

Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Administratës Publike dhe Antikorrupsionit në bashkëpunim me Iniciativën Globale kundër Krimit të Organizuar Transnacional (GI-TOC), organizuan **konferencën ndërkombëtare “Forcimi i Llogaridhënies”**. Fuqizimi i përpjekjeve kundër korrupsionit në Ballkanin Perëndimor” përgjatë datave 4-5 Mars 2024. Konferenca bëri bashkë në Tiranë Ministrat e Drejtësisë së Ballkanit Perëndimor dhe Kroacisë, prokurorë, organizata ndërkombëtare, drejtues të agjencive antikorrupsion në rajon, shoqërinë civile dhe përfaqësues të mediave, me qëllimin e përbashkët forcimi i bashkëpunimit për të luftuar korrupsionin, rritjen e standardeve të integritetit, si kushte për mirëqeverisjen dhe avancimin e proceseve integruese të rajonit.

Në fushën e punëve të brendshme, ka vijuar angazhimi dhe bashkëpunimi operacional me agjencitë e BE-së, në veçanti Frontex dhe Europol, si dhe me shtetet anëtare të BE-së. Gjithashtu, progres ka në zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë dhe të përkushtuar në luftën kundër kësaj sfide të rëndësishme për sigurinë e Bashkimit Evropian.

Në fushën e migracionit, Shqipëria ka progesuar në zbatimin e Planit të Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor, i cili u miratua në dhjetor të vitit 2022. Ky plan synon të adresojë sfidat dhe të përmirësojë menaxhimin e migracionit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke ndihmuar në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit në këtë kontekst të ndjeshëm.

Në fushën e politikës së vizave Shqipëria vazhdon të përmbushë me përpikmëri kërkesat për liberalizimin, duke vazhduar përpjekjet për të plotësuar kriteret e përcaktuara.

Gjatë muajit Janar 2024 u iniciua fushata e komunikimit antitrafik “E vërteta N’Ndrit”, e cila synon të rrisë ndërgjegjësimin e publikut në lidhje me rreziqet e trafikimit të qenieve njerëzore. Fushata është e financuar nga qeveria britanike dhe ka si qëllim kryesor reduktimin e trafikimit të qenieve njerëzore, brenda dhe nga Shqipëria, duke u fokusuar në parandalimin e këtij fenomeni.

Në lidhje me **Prokurimin Publik**, në Shqipëri u shënuan disa zhvillime thelbësore. Në fillim të muajit Mars, u miratua dhe u publikua në fletoren zyrtare Ligji Nr. 16/2024, i cili parasheh shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 162/2020 për prokurimin publik. Ky ligj synon të përmirësojë dhe të rregullojë më tej sistemin e prokurimit publik në vend. Në kontekstin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe Planit të Veprimit për zbatimin e saj 2024-2027, një rol kyç pati Grupi Ndërinstitucional i Punës nën drejtorin e Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky grup hartoi draftin e strategjisë dhe planit të veprimit, duke synuar të sigurojë një sistem prokurimi efikas dhe të qëndrueshëm, duke u bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Në të njëjtën kohë, u finalizuan projektvendimet për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik dhe për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e mëparshëm për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale në prokurimet publike. Këto projektvendime u dërguan në Kryeministri për bashkërendim.

Gjithashtu, në janar dhe mars 2024, u zhvilluan dy takime të Tryezës së Partneritetit për Kapitullin 5, ku u prezantua Draft Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe plani i saj i veprimit për konsultim publik, si dhe u diskutua rishikimi i Ligjit për Konkensionet dhe Partneritetin Publik Privat për harmonizim me direktivën e Bashkimit Europian. Ky proces u mbështet nga Agjencia e Prokurimit Publik në bashkëpunim me organizatën European Movement Albania. Këto zhvillime shënojnë një angazhim të vazhdueshëm të Shqipërisë në përmirësimin e sistemit të prokurimit publik dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të transparencës dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike.

Lidhur me fushën e Statistikave, në kontekstin e zhvillimeve dhe angazhimeve institucionale të vitit 2023 dhe fillimit të vitit 2024, Instituti i Statistikave (INSTAT) ka ndërmarrë një sërë iniciativash dhe aktiviteteve kyçe që reflektojnë përkushtimin dhe kontributin e saj në fushën e statistikave dhe integrimin e vendit në strukturat evropiane. Këto veprimtari përfshijnë një gamë të gjerë angazhimesh, nga përpunimi i të dhënave të mbledhura në terren deri të kontributi në dialogun statistikor ndërkombëtar.

Në procesin e përpunimit të të dhënave të mbledhura gjatë “Censit të Popullsisë dhe Banesave” të vitit 2023, INSTAT është duke u përgatitur për publikimet e para të rezultateve që pritet të bëhen gjatë muajit Qershor 2024. Ky hap është thelbësor në ofrimin e një pasqyre të qartë dhe të detajuar mbi demografinë dhe karakteristikat e banesave në vend, të cilat janë jetike për planifikimin dhe zbatimin e politikave publike efektive.

Në datën 11 janar 2024, u miratua Plani Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2024 – 2026, ku Instituti i Statistikave luan një rol kyç në raportimin e zbatimit të këtij plani për Kapitullin 18 “Statistikat”. Përveç kësaj, është duke finalizuar kontributin për raportin vjetor të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2024. Ky raport paraqet një rëndësi vitale në vlerësimin e përparimit të vendit në fushat kyçe të reformave dhe përgatitjes për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Në fushën e bujqësisë, INSTAT ka vazhduar punën intensive për realizimin e “Censit të Bujqësisë dhe Fermave Bujqësore”, ku ka angazhuar ekspertizë të specializuar nga Delegacioni Evropian për të ndihmuar në metodologjinë dhe ndërtimin e platformës së IT për mbledhjen e të dhënave. Pritet që projektligji i lidhur me këtë census të miratohet brenda 4 mujorit të parë të vitit 2024, duke u shndërruar në një hap vendimtar për përparimin statistikor në sektorin bujqësor.

Veç kësaj, INSTAT ka qenë i përfshirë aktivisht në dialogun e gjerë me aktorët kyç përmes takimeve dhe konferencave. Më 21 Shkurt 2024, Instituti organizoi një takim me Komisionin për Ekonominë dhe Financat për të diskutuar organizimin dhe progresin e Censit të Bujqësisë, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes për një zbatim të suksesshëm të këtij projekti të rëndësishëm.

INSTAT mori pjesë në takimin e 15-të të Nënkomitetit Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale në datën 1 shkurt 2024, ku u diskutuan temat si Anketa e Forcës së Punës dhe Statistikat e Shoqërisë së Informacionit. Kjo vërteton angazhimin e vazhdueshëm të INSTAT në kontributin ndaj zhvillimit dhe inovacionit në fushën e statistikave dhe politikave sociale në Shqipëri dhe në kontekstin më të gjerë evropian.

Në janar 2024, **në kuadër të mbështetjes së Reformës në Administratën Publike** u ngrit institucioni i Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në mënyrë që politikat antikorrupsion të qeverisë të harmonizohen më mirë mes institucioneve të ekzekutivit, me procesin sfidues të negociatave me BE për të gjitha institucionet e vendit, si edhe me vetë shoqërinë civile e sipërmarrjen. Në këtë fazë të zhvillimit të vendit dhe në kushtet kur Shqipëria po punon për kapitujt e negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian kërkohej një qasje e re ndaj administratës publike, për të rritur krahas pagave konkurrese dhe cilësinë e burimeve njerëzore, duke adresuar të gjitha hallkat e procesit të funksionimit të saj, nga rekrutimi deri tek promovimi i nëpunësve.

2.2 Grupimi i kapitujve 2 “Tregu i brendshëm”

Në përputhje me metodologjinë e re të Bashkimit Evropian për zgjerimin, grupimi 2 i kapitujve “Tregu i brendshëm” është ndër grupimet më voluminoze, me 9 kapituj, që mbulojnë përkatësisht këto fusha: lëvizja e lirë e mallrave (kapitulli 1), lëvizja e lirë e punëtorëve (kapitulli 2), e drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve (kapitulli 3), liria e lëvizjes së kapitalit (kapitulli 4), legjislacioni tregëtar (kapitulli 6), e drejta e pronësisë intelektuale (kapitulli 7), e drejta e konkurrencës (kapitulli 8), shërbimet financiare (kapitulli 9) dhe mbrojtja e shëndetit dhe konsumatorit (kapitulli 28).

Procesi *screening* për grupimin e dytë filloi zyrtarisht në tetor të vitit 2022 dhe u finalizua në mars të vitit 2023. Të gjitha strukturat negociuese të përfshira në grupimin e dytë kanë bërë një punë të mirë dhe intensive për finalizimin e procesit *screening (takime bilaterale)*, brenda 3 muajve (janar-mars 2023).

Gjatë periudhës Janar-Mars 2024 janë zhvilluar rreth 6 takime, në 9 GNPIE-të e Grupimit “Tregu i Brendshëm”, ku janë të angazhuar rreth 114 anëtarë.

Më specifikisht, në 6 takimet e zhvilluara të mekanizmit për Grupimin II ‘Tregu i Brendshëm’, disa nga çështjet e trajtuara, diskutuar dhe konsultuar lidhen me (i) përditësimin dhe diskutimin përsa i përket reformës ligjore në fushën e pronësisë industriale; (ii) zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025; (iii) prezantimin e punës së realizuar nga anëtarët e grupit të punës mbi hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”; (iv) përgatitjen e Udhërrëfyesit për transpozimin e direktivës 2002/87/KE; (v) analiza dhe komente strukturore për pjesën faktuale të Raportit Screening të Komisionit Evropian lidhur me grupimin II; (vi) progresi lidhur me asistencën IPA dhe ndihmën e huaj; (vii) përgatitje lidhur me takimin e Nënkomitetit “Tregu i Brendshëm”; (viii) prezantimi i analizës të kuadrit ligjor shqiptar në lidhje me projektligjin e shitblerjen e tokës bujqësore nga shtetasit e huaj, (ix) vlerësimin e nevojave për trajnim (GNPIE) 2024 – 2025, (ix) vlerësimin e Tryezave të Diskutimit, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PIIE); (x) bashkërendim në kuadër të projektit pilot të Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (KESE) adresuar përfaqësuesve të shoqërisë civile dhepërfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve nga vendet kandidate; (xi) analizë dhe identifikim të masave të parashikuara në Planet e së Ardhmes ‘Future plans’; (xii) Progres raportin dhe kontributet për vitin 2024; (x) monitorimi i rekomandimeve të BE-së; (xiii) përditësimi i listave të përdoruesve të Platformës PIEA të Grupeve Ndërinstitucionale, (xiv) konsolidimi i Pozicionit Negociues; (xvi) monitorimin e PKIE dhe PKBAE; (xv) diskutime lidhur me gjetjet dhe rezultatet e Indekseve të raportit vjetor PSIE 2023 për Grupimin II ‘Tregu i Brendshëm’; (xvi) diskutime lidhur me planifikimin në kuadër të Planit Menaxherial (Semestral) i Integritit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE 2024) për Grupimin, etj.

Disa nga konkluzionet që mekanizmi i qeverisjes për integrimin evropian për Grupimin II “Tregu i Brendshëm” ka ndjekur gjatë kësaj periudhe raportuese lidhen me (i) ndjekjen e monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2022-2025; (ii) konsolidimi i paketës raportuese lidhur me organizimin efikas të Nënkomitetit të “Tregu i Brendshëm (në Maj 2024); (iii) konsolidimin e Pozicionit Negociues për grupimin, (iv) adresimi i rekomandimeve të raport-progresit’ (iv) marrjen në konsideratë të gjetjeve të analizës ligjore për projektligjin e tokës bujqësore’ (v) përfaqësimin në Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social (KESE) si pjesë e projektit pilot që po ndërmerr Komisioni Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor ; (vi) konsolidimin e nevojave për trajnim të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian; (vii) finalizimin e pyetësorit për Tryezat e Diskutimit për Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian; (viii) ndjekje e Planit Menaxherial (Semestral) i Integritit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE 2024) për Grupimin’ (ix) përdorimi dhe funksionalizimi i Platformës së Integritit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA), etj.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të strukturave të integritit, 34 anëtarë janë trajnuar përmes skemave të shkëmbimit të njohurive me Komisionin Evropian në kuadër të procesit të integritit, dhe 7 anëtarë janë trajnuar përmes skemave të shkëmbimit të njohurive me institucione të vendeve anëtare.

Tematikat e trajnimeve adresonin çështje të ndryshme, si (i) mbikqyrja dhe monitorimi i sektorit financiar”; (ii) regjimin mbikqyrës në fushën e sigurimeve; (iii) zbatimin e të drejtës së pronësisë intelektuale në Shqipëri, kriminalizimi i Pronësisë Intelektuale në këndvështrimin e TRIPS dhe legjislacionit shqiptar, gjithashtu u diskutuan dhe raste konkrete të trajtuara nga gjykatat në Shqipëri, si dhe nga gjykatat ndërkombëtare; (iv) identifikimin e nevojave për trajnim në të ardhmen për çështje me natyrë të përgjithshme të lidhura me procesin e Integritit, ashtu si edhe për çështje me natyrë specifike të lidhura ngushtësisht me politikat që mbulon çdo GNPIE; (v) trajnime lidhur me funksionalitetet e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin (PIEA); (vi) vlerësimi i Performancës të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), etj.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese të grupimit të dytë, lidhur me procesin e negociatave dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian paraqiten, si më poshtë vijon:

Ne lidhje me **lirinë e lëvizjes së mallrave**, “Rregullorja (BE) 2019/1020 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 qershor 2019 për mbikëqyrjen e tregut dhe përputhshmërinë e produkteve dhe ndryshimin e Direktivës 2004/42/EC dhe Rregulloreve (KE) Nr. 765/2008 dhe (BE) Nr 305/ 201” është planifikuar në Planin Kombëtar për Integrim Evropian 2024 – 2026 dhe të harmonizohet në fund të vitit 2025. Në Mars 2024 filloi puna për procesin e harmonizimit të kësaj rregulloreje me përgatitjen e “Vlerësimit të Ndikimit Rregullator”, i cili do të përcaktojë nëse do të përgatitet një ligj i ri apo amendamente në kuadrin rregullator ekzistues për marketingun dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore. RIA pritet të finalizohet në Qershor 2024, për të vazhduar më pas me procesin e harmonizimit dhe përgatitjen e Tabelave të Përputhshmërisë.

Lidhur me lëvizjen e lirë të punëtorëve, ka vijuar puna për njohjen e sigurimeve shoqërore me vendet e BE. Më datë 23.02.2024 është dekretuar Ligji nr. 11/2024, për bashkëpunim me Kroacinë në njohjen e sigurimeve shoqërore.

Më datë 15.02.2024, u organizua takimi me përfaqësuesit e zyrave ndërlidhëse të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë dhe Institutit Turk të Sigurimeve Shoqërore për shkëmbimin elektronik të formularëve të komunikimit në zbatim të marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë.

Vijon puna për nënshkrimin e marrëveshjeve me vendet e rajonit ku me Republikën e Serbisë u zhvillua rasti i dytë i negociatave në Tiranë në datat 12-14 mars 2024, ku marrëveshja kuadër u para-nënshkrua në gjuhën angleze.

Në kuadër të përgatitjeve administrative dhe teknike **për futjen e kartës evropiane të sigurimit shëndetësor**, si njohje ligjore sipas legjislacionit të brendshëm dhe vlerësimi i ndikimit/fizibilitetit të futjes së saj pas anëtarësimin, në datat 25 - 26 janar 2024 u zhvillua në Tiranë një takim në nivel zyrash ndërlidhëse ndërmjet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë dhe Sigurimeve Pensionale Gjermane të Land Rheinland Pfalz.

Në lidhje me **shërbimet financiare**, në Janar të vitit 2024 Banka e Shqipërisë filloi punën drejt plotësisht të “paketës së rezervave makroprudencialë të kapitalit me rezervë kapital për rrezikun sistematik (STRUK)”. si Në këtë kuadër u hartua metodologjia e masave makroprudenciale me bazë huamarrësin, kufirin e vlerës së kredisë ndaj vlerës së pronës, kredia ndaj të ardhurave dhe shërbimi i kredisë ndaj të ardhurave të ndarë sipas llojit të huamarrësit dhe llojit të kolateralit. Bankat do të nisin raportimin e modeleve të rregullore për herë të parë në Prill të vitit 2024. Miratimi dhe zbatimi i kësaj rregulloreje përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të kuadrit makroprudencial të vendit me legjislacionin dhe praktikën e ndjekura nga vendet e Bashkimit Evropian.

Në lidhje me **lëvizjen e lirë të kapitaleve**, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë në kuadër të aplikimit të kuadrit SEPA ka miratuar në datën 3 Prill 2024 një rregullore “Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kredisë dhe debitimet direkte në euro”, që transponon nenin 5 të Rregullores SEPA. Objekti i zbatimit të kësaj rregulloreje lidhet me transaksionet SEPA ndërkuftare në euro. Vlen të theksohet se **Shqipëria në datën 29 Mars ka dorëzuar Para-Aplikimin për Përfshirjen e Shqipërisë në “Hapësirën Gjeografike” të Zonës së vetme të Pagesave në Euro (SEPA) pranë DG FISMA.**

Gjate periudhës raportuese, Banka e Shqipërisë në bashkëpunim me Banca d'Italia, po vlerëson fizibilitetin e zbatimit të një zgjidhjeje kombëtare të ngjashme me TIPS të BE (Pagesat e menjëhershme të synuara) ku efektet pozitive do të materializohen në treg në përdorimin e pagesave elektronike me ngritjen dhe funksionalizimin e Sistemit të Pagesave Instante në Shqipëri. Banka e Shqipërisë ka vijuar të zhvillojë dhe zbatojë një zgjidhje pagese të menjëhershme për tregun me pakicë, për të ofruar disponueshmëri 24/7. Pagesat e menjëhershme konsiderohen të vlefshme për sa i përket uljes së kostove, rritjes së efikasitetit të pagesave, përmirësimit të tregtisë elektronike dhe rritjes së përfshirjes financiare.

Banka e Shqipërisë miratoi në fillim të Shkurtit 2024, udhëzuesin 10/2024 “Për raportimin e incidenteve të mëdha” në përputhje me kërkesat e BE, i cili përcakton kriteret për klasifikimin e incidenteve operacionale ose të sigurisë si incidente madhore, sipas ofruesve të shërbimeve të pagesave dhe formatin e raportimit dhe procedurat që kjo e fundit duhet të ndjekë për të njoftuar Bankën e Shqipërisë për këto lloje incidentesh.

Në lidhje me **të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime**, kanë filluar përpjekjet për ndryshimin e ligjit 66/2016 për shërbimet. Ky amendament synon të transpozojë plotësisht Direktivën e Shërbimeve të BE-së në kuadrin rregullator shqiptar, duke u fokusuar veçanërisht në përfshirjen e lëvizjes së lirë të acquis të shërbimeve. Vlerësimi paraprak i ndikimit rregullator përfundoi në mars 2024 dhe ka filluar vlerësimi mbi amendamentet specifike të kërkuara për transpozimin e plotë të direktivës. Ligji për Shërbimet garanton qasjen në treg dhe ushtrimin e aktiviteteve të shërbimeve si për ofruesit e shërbimeve vendase ashtu edhe për ato të huaja (personat fizikë dhe juridikë) në baza të barabarta.

Në lidhje me **pronësinë intelektuale dhe industriale**, në fushën e të drejtës së autorit, MEKI në bashkëpunim me Projektin Shqiptar Zvicëran për IP (ALSIP), në janar 2024 ka nisur

hartimin e ligjit të ri të së drejtës së autorit që do të përafrojë tre direktivat si më poshtë specifikuar:

- Direktiva (BE) 2019/789 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 prill 2019 që përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhura me të, të zbatueshme për transmetime të caktuara në internet të organizatave transmetuese dhe ritransmetimet e programeve televizive dhe radiofonike, dhe amendon Këshillin Direktiva 93/83/KEE;
- Direktiva (BE) 2019/790 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 prill 2019 për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me tregun e vetëm dixhital dhe që ndryshon Direktivat 96/9/EC dhe 2001/29/EC;
- Direktiva 2014/26/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 26 shkurt 2014 për menaxhimin kolektiv të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta dhe licencimin shumë-territorial të të drejtave në veprat muzikore për përdorim online në tregun e brendshëm.

Përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit evropian, synon veçanërisht në sigurimin e një funksionimi më të mirë të organizatave të menaxhimit kolektiv si rezultat i standardeve në mbarë BE-në, me fokus nën 5(5) të Direktivës 2014/26/BE; rregullimin e entiteteve të pavarura menaxheriale (IME); si dhe rregullimin e licencimit shumë-territorial. Hartimi i ligjit të ri për të drejtën e autorit parashikohet të finalizohet në fund të majit 2024 dhe do të bëjë ndryshime edhe në direktivat e transpozuar deri tani pjesërisht, për të ndryshuar statusin e tyre në të transpozuar plotësisht.

Për sa i përket fushës së konkurrencës, Komisioni i Ndhmës Shtetërore ka miratuar gjatë periudhës raportuese vendimet e mëposhtme për masat e ndihmës shtetërore:

Vendim Nr.116, datë 19.03.2024 “Autorizimi i ndihmës shtetërore për ‘Projekti fotovoltaik lundruar në HEC Vau i Dejës’”.

Vendim i Komisionit të Ndhmës Shtetërore Nr. 115, datë 15.02.2024 “Autorizimi i Ndhmës Shtetërore për ‘Thirrje për Grante dhe Masa Mbështetëse për Startupet dhe Lehtësuesit’”.

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese është miratuar VKM Nr. 61, datë 7.2.2024 “Për miratimin e kërkesave dhe kriterëve që duhet të plotësojnë sipërmarrësit fillestarë dhe lehtësuesit e startup-eve, procedurat dhe afatet, si dhe rregullat për përbërjen e komisionit të vlerësimit dhe ankimit, kriteret, procedura e përzgjedhjes dhe e shpërbimit të anëtarëve të tyre”.

Në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, gjatë “Javës së Konsumatorit 2024” janë zhvilluar disa aktivitete ndërgjegjësuese, nga organet qeveritare dhe shoqatat e konsumatorëve:

Më 15 Mars 2024, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Konsumatorit, u organizua një shfaqje teatrale nga MEKI, në bashkëpunim me Qendrën e Konsumatorit Shqiptar (OJQ) dhe studentët e Fakultetit Juridik (Universiteti i Tiranës). Synimi i teatrit ishte rritja e ndërgjegjësimit për kreditë konsumatore, të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve dhe matura e nevojshme nga konsumatorët për ushtrimin e plotë të këtyre të drejtave, për të shmangur rreziqet financiare që lidhen me këto kredi.

Një tryezë e rrumbullakët u organizua nga organizata e konsumatorëve ALERT Center, në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian të Parlamentit; Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI); Ministria e Bujqësisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Mjedisit; Përfaqësues të Delegacionit të BE-së në Shqipëri dhe donatorë të ndryshëm. Qëllimi i tryezës ishte diskutimi mbi sfidat dhe

mundësitë e inteligjencës artificiale, financave dixhitale, marrëveshjes së gjelbër, nga këndvështrimi i Konsumatorëve. Diskutimet u fokusuan në sfidat e konsumatorëve për të përballuar ndryshimet e reja dhe rrezikun që sjell Green Deal në terma afatgjatë; mbrojtjen e mjedisit; Siguria e ushqimit; Siguria e produkteve joushqimore; Mbikëqyrja e tregut dhe shëndeti publik. Aktiviteti u transmetua drejtpërdrejt në mediat kombëtare.

Në fushën e shëndetit publik, për harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me acquis të BE-së për gjakun, indet, qelizat dhe organet, me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 97, datë 23.02.2024 u miratua “Rregullorja për sigurimin e cilësisë”. Kjo rregullore është në përputhje të plotë me kërkesat e Direktivës së BE-së 2005/62/EC “Standardet dhe specifikimet e Komunitetit në lidhje me një sistem të cilësisë për qendrat e gjakut”.

Gjithashtu, me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr. 77, datë 13.02.2024 u miratua Plani i Veprimit 2024-2030 “Mjaftueshmëria me gjak të sigurt dhe cilësor”.

Në lidhje me zhvillimet mbi kontrollin e duhanit, në takimin e nivelit të lartë për qeverisjen dhe kontrollin e duhanit në Ballkanin Perëndimor më 22 mars 2024, Ministri Shqiptar i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka rikonfirmuar angazhimin politik për ratifikimin e Konventës Kuadër të OBSH-së për Kontrollin e Duhanit (FCTC) dhe Protokollit të Eliminimi i Tregtisë së Paligjshme të Produkteve të Duhanit, një angazhim i zyrtarizuar në “Deklaratën e Ministrave të Shëndetësisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor për mbrojtjen nga tymi i duhanit”. Për të përmbushur këtë angazhim, gjatë muajve në vijim do të zbatohen veprime të ndryshme në nivel vendi.

2.3 Grupimi i kapitujve 3 “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse”

Në përputhje me metodologjinë e re të Bashkimit Evropian për zgjerimin, grupimi 3 “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse” përfshin çështje si transformimi digjital, media (kapitulli 10), shkenca dhe kërkimi shkencor (kapitulli 25), ndërmarrjet dhe politikat industriale (kapitulli 20), punësimi dhe politikat sociale (kapitulli 19), arsimi dhe kultura (kapitulli 26). Në pjesën ekonomike, ky grupim mbulon bashkimin doganor (kapitulli 29), politikën ekonomike dhe monetare (kapitulli 17) dhe taksimin (kapitulli 16).

Procesi *screening* për Grupimin e tretë filloi zyrtarisht në tetor të vitit 2022 dhe u finalizua në qershor të vitit 2023. Të gjitha strukturat negociuese të përfshira në Grupimin e tretë kanë bërë një punë të mirë intensive për finalizimin e procesit *screening (takime bilaterale)* brenda 4 muajve (mars – qershor 2023).

Përgjatë periudhës raportuese, për çdo kapitull respektivisht kanë filluar përgatitjet për hartimin e pozicionit negociues për grupimin e tretë. Pas hartimit dhe miratimit të metodologjisë për Pozicionin Negociues, draft “*template*”, i shpërndarë nëpër institucionet lider të kapitujve në grupkapitullin 3, është diskutuar përgjatë disa takimeve me këto institucione, si fazë parapërgatitore e fillimit të procesit të hartimit të pozicionit negociues.

Gjatë periudhës Janar-Mars 2024 janë zhvilluar rreth 13 takime, në 8 GNPIE-të e Grupimit “Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse”, ku janë të angazhuar rreth 406 anëtarë.

Më specifikisht, në 13 takimet e zhvilluara të mekanizmit për Grupimin III ‘Konkurueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse’, disa nga çështjet e trajtuar, diskutuar dhe konsultuar lidhen me (i) bashkëpunim më proaktiv ndërmjet aktorëve nga bota akademike, studentëve dhe e biznesit, (ii) vendosja e urave të komunikimit ndërmjet DPPI dhe organeve të tjera si ASH, IAL; (iii) nxitja për të aplikuar në programet e distance learning, (iv) ngritja e dy qendrave të Informacionit pranë Universiteteve, konkretisht Universitetit ‘Eqrem Çabej’ në Gjirokastrë dhe Univeritetit ‘Luigj Gurakuqi’ në Elbasan, (v) koordinimi dhe inforemimi mbi zhvillimin e takimit të 15-të të Nënkomitetit BE-Shqipëri “Drejtësi, Liri dhe Siguri”, në datat 20-21 mars 2024, (vi) futja në agjendën e Zyrës Erasmus realizimi i takimeve informuese dhe zhvillimin e trajnimeve për institucione dhe individë të interesuar për aplikimin në projekte, (vii) vlerësimin e nevojave për trajnim (GNPIE) 2024 – 2025, (viii) vlerësimin e Tryezave të Diskutimit, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), (ix) bashkërendim në kuadër të projektit pilot të Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (KESE) adresuar përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve nga vendet kandidate, (x) analizë dhe identifikim të masave të parashikuara në Planet e së Ardhmes ‘Future plans’, (xi) Progres raportin dhe kontributet për vitin 2024, (xii) monitorimi i rekomandimeve të BE-së, (xiii) përditësimi i listave të përdoruesve të Platformës PIEA të Grupeve Ndërinstitucionale, (xiv) diskutimi lidhur me hartimin e Pozicionit Negociues; (xvi) monitorimin e PKIE dhe PKBAE, (xv) diskutime lidhur me gjetjet dhe rezultatet e Indeksve të raportit vjetor PSIE 2023 për Grupimin III ‘Konkurueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse’, (xvi) diskutime lidhur me planifikimin në kuadër të Planit Menaxherial (Semestral) i Integritit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE 2024) për Grupimin, etj.

Disa nga konkluzionet që mekanizmi i qeverisjes për integrimin evropian për Grupimin III “Konkurueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse” ka ndjekur gjatë kësaj periudhe raportuese lidhen me (i) ndjekjen e trajnimeve të vazhdueshme për Këshillin Fiskal, (ii) konsolidimi i paketës të ‘Planeve të së Ardhmes’/Future Plans si dhe paketës së Integritit të Përsheptuar/Accelerated Integration, (iii) konsolidimin e Pozicionit Negociues për grupimin, (iv) adresimi i rekomandimeve të raport-progresit, (v) përfaqësimin në Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social (KESE) si pjesë e projektit pilot që po ndërmerr Komisioni Evropian për vendet e Ballkanit Perëndimor, (vi) konsolidimin e nevojave për trajnim të Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian, (vii) finalizimin e pyetësorit për Tryezat e Diskutimit për Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian, (viii) ndjekje e Planit Menaxherial (Semestral) i Integritit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE 2024) për Grupimin, (ix) përdorimi dhe funksionalizimi i Platformës së Integritit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA), etj.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të strukturave të integritit, Indeksi i Kapaciteteve për periudhën Janar-Mars 2024 referuar 8 Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian të Grupimit III ‘Konkurueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse’, rezulton 71%, nga ku 280 anëtarë të strukturave respektive janë trajnuar përmes skemës së trajnimit, përmes Sekretariatit të Integritit Evropian në kuadër të procesit të integritit evropian dhe anëtarësimit, dhe 7 anëtarë janë trajnuar përmes skemave të shkëmbimit të njohurive me komisionin evropian në kuadër të procesit të integritit.

Tematikat e trajnimeve adresonin çështje të ndryshme, si (i) shkëmbim eksperience me Bankën e Ukrainës në kuadër të procesit të përafrimit; (ii) udhëzime që lidhen me detyrat përkatëse në zbatim të Strategjisë Agjenda Digjitale me qëllim përmirësimin e aftësive

profesionale mbi udhëzimet e monitorimit të Agjendes Digjitale; (iii) përmirësimin e aftësive profesionale; (iv) Agjendave Kombëtare të Reformave dhe Rritjes 2024-2027 për vendet e Ballkanit Perëndimor; (v) zbatimin efektiv të Direktivës së BE-së për reduktimin e kostove të Broadband (BRD); (vi) fuqizimin e Rrjetit European të BCO-ve; (vi) rritjen e kapaciteteve në fushën e identifikimit elektronik dhe shërbimeve të besuara, në kuadër të rritjes së sigurisë, efektivitetit, integritetit dhe besueshmërisë në ofrimin dhe përdorimin e shërbimeve të besuara; (vii) në forcimin e njohurive në fushën kibernetike; (viii) identifikimin e nevojave për trajnim në të ardhmen për çështje me natyrë të përgjithshme të lidhura me procesin e Integritetit, ashtu si edhe për çështje me natyrë specifike të lidhura ngushtësisht me politikat që mbulon çdo GNPIE; (ix) trajnime lidhur me funksionalitetet e Platformës së Partneritetit për Integritetin Evropian dhe Anëtarësimin (PIEA); (x) vlerësimi i Performancës të Platformës së Partneritetit për Integritetin Evropian (PPIE), etj.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese të Grupimit të tretë, lidhur me procesin e negociatave dhe anëtarësimin në Bashkimin Evropian paraqiten, si më poshtë vijon:

Në fushën e politikave sociale dhe punësimit:

Është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 152, datë 13.03.2024 “Strategjia Kombëtare për Mbrojtjes Sociale 2024 - 2030” shoqëruar me Planin e Veprimit;

Në fushën e transformimit digjital dhe media:

Është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave më Datë 11 janar 2024 projektligji “Për sigurinë kibernetike”. Miratimi i këtij ligji në seancë plenare të Kuvendit parashikohet të bëhet më 21 mars 2024.

Është miratuar Udhëzimi Nr. 2, datë 11.03.2024 “Deklarimi i procedurave të pararritjes/para nisjes dhe të thjeshtuara për mallrat e importuara/eksportuara me postë ekspres”. Në përputhje me këtë udhëzim, ka filluar të testohet në serverin e sistemit IT doganor, funksionaliteti i deklaratës paraprake;

Në fushën e tatimeve është miratuar ligji nr. 105/2023 “Për disa shtesa në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 8, datë 12.01.2024

Në fushën e Shkencës dhe Kërkimit Shkencor:

- Në janar 2024 Ministria e Arsimit dhe Sportit ndau fonde (afërsisht 200,000 Euro) për organizatat që bashkëpunojnë në projektet ndërkombëtare të K&ZH-së në kuadër të thirrjes për projekte EUREKA në Ballkanin Perëndimor 2024”. Paralelisht NASRI po promovon pjesëmarrjen e Biznesit Shqiptar në program.
- Në kuadrin e programit të bashkëpunimit me Akademinë dhe Industrinë, në shkurt 2024 u publikua një thirrje e re nga NASRI për “Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit”. IAL-të kanë dorëzuar 21 projekt propozime në fushën e shkencave mjekësore, TIK-ut, Bujqësisë dhe Energjisë.
- Në 26 mars 2024, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Kosovën, NASRI ka financuar 16 projekte mobiliteti për studiues të IAL-ve shqiptare.

Në fushën e Arsimit dhe Kulturës:

- Programi Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve”, është shpallur në janar 2024, dhe do të zbatohet përgjatë viteve 2024 dhe 2025.

- Në janar 2024 u finalizua thirrja e tretë për grante për infrastrukturën rinore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fituese u shpallën gjashtë bashki: Fier, Mat, Malësi e Madhe, Sarandë, Korçë dhe Librazhd, të cilat do të mbështeten deri në shumën. 10 000 000 lekë për të ndërtuar hapësira rinore, qendra rinore dhe biblioteka.

Në fushën e Shërbimeve Doganore gjatë periudhës janar - mars 2024, janë kontrolluar fizikisht 7,23% e numrit total të deklaratave doganore të import/eksportit (kanali i kuq); 66,41% e kontrollit të dokumentacionit (kanali i verdhë) dhe pjesa tjetër (26,36%) nuk kishte kontroll (kanali jeshil). Gjatë kësaj periudhe janë përmirësuar profilet e rrezikut në fushën e sigurisë. Në kuadër të projekteve SEED+, kanë marrë pjesë në aktivitetin e ndërtimit të profileve të përbashkëta të rrezikut me vendet e rajonit që janë pjesë e marrëveshjes CEFTA.

2.4 Grupimi i kapitujve 4 “Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme”

Në përputhje me metodologjinë e re të Bashkimit Evropian për zgjerimin, grupimi i kapitujve 4 “Agjenda e Gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme” mbulon katër fusha të rëndësishme: politikën e transportit (kapitulli 14), energjinë (kapitulli 15), rrjetet trans-evropiane (kapitulli 21) si dhe mjedisin dhe ndryshimet klimatike (kapitulli 27). Të katër kapitujt përmbajnë detyrimet për të përmirësuar legjislacionin në fushat përkatëse, si edhe investime infrastrukturore dhe institucionale për të mbikëqyrur përmbushjen e objektivave të vendosur nga legjislacioni evropian.

Në këtë grupim, Bashkimi Evropian është angazhuar në “Agjendën e Gjelbër” si dhe në “Planin Ekonomik të Investimeve” për vendet e Ballkanit Perëndimor për të rritur dhe përmirësuar investimet në rajon, duke mobilizuar deri në 9 miliardë € nga Instrumenti i IPA III, me qëllim nxitjen e rimëkëmbjes afatgjatë - të orientuar drejt tranzicionit të gjelbër dhe atij digjital. Plani Ekonomik i Investimeve të BE për Ballkanin Perëndimor identifikon 10 (dhjetë) iniciativa “*Flagships*” të investimeve në fushat kryesore siç janë: transporti i qëndrueshëm, energjia e rinovueshme dhe transformimi i gjelbër.

Gjithashtu Plani i ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, i lancuar si propozimi i Komisionit Evropian në datën 8 nëntor 2023, me qëllim për të sjellë në vendet kandidatë disa nga përfitimet e anëtarësimit në rajon përpara anëtarësimit, duke nxitur rritjen ekonomike dhe përshpejtimin e konvergjencës socio-ekonomike, ka identifikuar shtatë fusha prioritare fillestare, dy nga të cilat prekin çështjet e kapitujve të përfshirë në grupimin 4, dhe janë: i) integrimi i transportit rrugor, ii) integrimi i tregjeve të energjisë.

Bazuar në këtë Plan ka nisur përgatitja e Agjendës Kombëtare të Reformave bazuar në rekomandimet e KE, duke përfshirë Paketën vjetore të Zgjerimit dhe konkluzionet e Dialogut Ekonomik dhe Financiar bazuar në Programet e Reformës Ekonomike të vendeve (ERP). Zhvillimi i infrastrukturave madhore ekonomike mbetet në qendër të masave investuese në kuadër të kësaj Agjende, për të siguruar forcimin e lidhjes me BE-në, Rrjetet Evropiane dhe me rajonin.

Procesi screening për grupimin e katërt filloi zyrtarisht në mars të vitit 2023 dhe u finalizua në shtator të vitit 2023. Të gjitha strukturat negociuese të përfshira në grupimin e katërt kanë

bërë një punë të mirë dhe intensive për finalizimin e procesit screening (takime bilaterale), brenda 7 muajve (mars – shtator 2023).

Përgjatë periudhës raportuese, për çdo kapitull respektivisht kanë filluar përgatitjet dhe analiza për hartimin e pozicionit negociues për grupimin e katërt. Pas hartimit dhe miratimit të metodologjisë për Pozicionin Negociues nga Grupi Negociator, “*template*” i përdoruar për Pozicionin Negociues të grupimit 1 (finalizuar gjatë periudhës së raportimit), u është shpërndarë institucioneve për vlerësimin e mëtejshëm të plotësimit dhe përshtatjes sipas përmbajtjes së grupimit të kapitujve 4.

Ende nuk është përcjellë Raporti *Screening* nga KE për këtë grupim, ndaj gjatë periudhës raportuese institucionet e përfshira janë agazhuar në dhënien e përgjigjeve të pyetjeve plotësuese të shërbimeve të Komisionit, dhe DG-ve përkatëse, në lidhje me saktësime të mëtejshme mbi çështje specifike, duke vënë në dispozicion kështu informacionin më të azhornuar që KE do të përdorë për finalizimin e Raportit *Screening*.

Gjatë periudhës Janar-Mars 2024 janë zhvilluar rreth 10 takime, në 4 GNPIE-të e Grupimit IV ‘Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrushme’, ku janë të angazhuar rreth 264 anëtarë.

Më specifikisht, në 10 takimet e zhvilluara të mekanizmit për Grupimin IV ‘Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrushme’, disa nga çështjet e trajtuar, diskutuar dhe konsultuar lidhen me (i) konsolidimin e dokumentacioneve për aplikimin e projektit pilot për përdorimin e Inteligjencës Artificiale për përkthimin e akteve; (ii) mbyllja e drafteve të Planeve të Veprimit për nënkapitullin e Mbetjeve pas marrjes së komenteve nga institucionet përkatëse; (iii) mbyllja e drafteve të Planeve të Veprimit për nënkapitullin e Cilësisë së Ujit pas marrjes së komenteve nga institucionet përkatëse; (iv) mbyllja e drafteve të Planeve të Veprimit për nënkapitullin e Mbrojtja e Natyrës pas marrjes së komenteve nga institucionet përkatëse; (v) mbyllja e drafteve të Planeve të Veprimit për nënkapitullin e Cilësisë së Ajrit dhe IPC pas marrjes së komenteve nga institucionet përkatëse; (vi) mbyllja e drafteve të Planeve të Veprimit për nënkapitullin e Ndryshimet Klimatike pas marrjes së komenteve nga institucionet përkatëse; (vii) mbyllja e drafteve të Planeve të Veprimit për nënkapitullin e Kimikatet pas marrjes së komenteve nga institucionet përkatëse; (viii) mbyllja e drafteve të Planeve të Veprimit për nënkapitullin e Legjislacionin Horizontal dhe Zhurmave pas marrjes së komenteve nga institucionet përkatëse; (ix) vlerësimin e nevojave për trajnim (GNPIE) 2024 – 2025; (x) vlerësimin e Tryezave të Diskutimit, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE); (xi) bashkërendim në kuadër të projektit pilot të Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (KESE) adresuar përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve nga vendet kandidate; (xii) analizë dhe identifikim të masave të parashikuara në Planet e së Ardhmes ‘Future plans’, (xiii) Progres raportin dhe kontributet për vitin 2024; (xiv) monitorimi i rekomandimeve të BE-së; (xv) përditësimi i listave të përdoruesve të Platformës PIEA të Grupeve Ndërinstitucionale; (xvi) diskutimi lidhur me hartimin e Pozicionit Negociues; (xvii) monitorimin e PKIE dhe PKBAE, (xviii) diskutime lidhur me gjetjet dhe rezultatet e Indeksve të raportit vjetor PSIE 2023 për Grupimin IV ‘Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrushme’, (xix) diskutime lidhur me planifikimin në kuadër të Planit Menaxherial (Semestral) i Integrimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE 2024) për Grupimin, etj.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të strukturave të integritit, Indeksi i Kapaciteteve për periudhën Janar-Mars 2024 referuar 4 Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian të Grupimit IV 'Agjenda e Gjelbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme', rezulton 56%, nga ku 60 anëtarë të strukturave respektive janë trajnuar përmes skemës së trajnimit përmes Sekretariatit të Integritit Evropian në kuadër të procesit të integritit evropian dhe anëtarësimit, dhe 87 anëtarë janë trajnuar përmes skemave të shkëmbimit të njohurive me komisionin evropian në kuadër të procesit të integritit.

Tematikat e trajnimeve adresojnë çështje të ndryshme, si (i) shkëmbim eksperience me Agjencinë Evropiane të Kimikateve apo organizmat e tjerë ndërkombëtar; (ii) vlerësimin e pjesëmarrjeve në vite në programin ITP; (iii) vlerësimi i riskut ndaj Ndryshimeve Klimatike, 'Get ready for the transition of SPC into IUCLID'; 'Getting familiar with ECHA's biocide guidance for the risk assessment' (viii) identifikimin e nevojave për trajnim në të ardhmen për çështje me natyrë të përgjithshme të lidhura me procesin e Integritit, ashtu si edhe për çështje me natyrë specifike të lidhura ngushtësisht me politikën që mbulon çdo GNPIE; (ix) trajnime lidhur me funksionalitetet e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin (PIEA); (x) vlerësimi i Performancës të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PIIE), etj.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese për Grupimin 4, në zbatim të rekomandimeve të Komisionit paraqiten, si më poshtë vijon:

- Gjatë muajit mars 2024 Shqipëria mori presidencën e Komitetit Teknik të Transportit të Mallrave të Rrezikshme, i kryesuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Ministrin e Evropës dhe Punëve të Jashtme. Gjatë takimit të parë nën presidencën e Shqipërisë, u vendos nga pjesëmarrësit që fokusi kryesor i takimeve vijuese të jetë i orientuar drejt fuqizimit të kapaciteteve të transportit detar, rrugor, hekurudhor.
- Në lidhje me transportin ajror, sikundër planifikuar në PKIE 2024 – 2026, është miratuar Urdhëri i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 61, datë 18.3.2024 "Për miratimin e rregullores për specifikimet shtesë të vlefshmërisë ajrore për një tip të caktuar të operimeve".
- Lidhur me përmirësimin e performancës së anijeve të transportit detar me flamur shqiptar sipas Memorandumit të Parisit për kontrollin shtetëror portual, gjatë 3 muajve të parë të vitit 2024 janë inspektuar 21 anije me Flamur Shqiptar nga Kontrolli Shtetëror i Flamurit, duke u marrë masat përkatëse vetëm për 1 prej tyre. Aktualisht, nga statistikat e pasqyruara në sistemin e Memorandumit të Parisit (Paris MoU), Shqipëria renditet në listën e zeze (me rrezik mesatar) dhe me koeficient aktual të përlogaritur nga sistemi, për vitin 2023, (Excess Factor) 0.75. Më 1 korrik 2024 do të bëhen publikimet e reja dhe parashikohet që vendi ynë të renditet në listën gri.
- Është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 161, datë 20.03.2024 " Për miratimin e dokumentit të politikave prioritare 2025-2027", dhe përmban listën me të gjitha projektet prioritare në sektorin e transportit, ku janë përfshirë dhe projektet e infrastrukturës hekurudhore, si më poshtë:
 - o Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës – Rrogozhinë
 - o Rehabilitimi i linjës "Rrogozhinë – Pogradec / Përrenjas – Rrajcë – kufiri me Maqedoninë e Veriut"

- Ndërtimi i linjës hekurudhore nga Terminali i Transportit Publik të Tiranës (TTP) në një stacion të ri hekurudhor në Tiranë (Lot 1) dhe lidhje me vijën kufitare (BRL) me Unazën e Mesme të Tiranës (Lot 2)
- Elektrifikimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe lidhja me Aeroportin e Rinasit, Elektrifikimi i hekurudhës;
- Linja Vorë – Hani i Hotit, Rehabilitimi i hekurudhës Vorë-Hani Hotit,
- Ndërtimi i linjës hekurudhore Durrës – Prishtinë dhe Ndërtimi i lidhjes së re hekurudhore Pogradec – Korçë – Kufiri me Greqinë.
- Projektligji për komunikimet elektronike, i cili përaftron Direktivën e BE-së 2018/1972 të Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike, u miratua nga Këshilli i Ministrave më 6 mars 2024, dhe ka kaluar për miratim përfundimtar në Kuvend.
- Nga data 1 shkurt 2024, ankandet e Ditës në Avancë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX tashmë zhvillohen si bashkim tregjesh mes Shqipërisë dhe Kosovës. Kjo shënon inaugurimin e tregut të ditës në vazhdim në Kosovë dhe inicon bashkimit të tregut Shqipëri-Kosovë, i pari i këtij lloji në Komunitetin e Energjisë. Krijimi i një tregu të përbashkët energjetik është i favorshëm për secilin shtet pasi që siguron rrjedhje më të sigurtë të energjisë, alokim më të lehtë të kapaciteteve, tregtim më të shpejtë dhe më të lirë, si dhe siguron çmim më të përballueshëm për konsumatorët, gjithashtu garanton më shumë transparencë dhe likuiditet më të madh si për tregtarët dhe operatorët, ashtu edhe për blerësit. Ky bashkim i tregjeve energjetike Shqipëri – Kosovë parashikohet të sjellë edhe rritje të sigurisë energjetike, duke marrë në konsideratë se Shqipëria e prodhon energjinë elektrike kryesisht nga uji, ndërsa Kosova nga termocentralet, çka mundëson një treg me shumëllojshmëri produktesh.
- Sikundër planifikuar në PKIE 2024 – 2026, është miratuar në Këshillin e Ministrave më datë 27.03.2024, Projektligj “Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji”.
- Në kudër të zbatimit të Paketës e Tretë të Energjisë (gaz dhe energji elektrike) janë miratuar gjatë periudhës së raportimit:
 - VKM Nr. 08, datë 11.01.2024 “Për kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë në furnizimin me gaz natyror dhe mënyrën e trajtimit të tyre” – Ky vendim përcakton kriteret dhe procedurat për kualifikimin e klientëve në nevojë të gazit natyror dhe përcakton specifikat e furnizimit me gaz natyror për këta klientë, si dhe mbështetjen financiare dhe masa të tjera mbrojtëse përkatëse. Ky vendim do t’i shtrijë efektet në momentin e operimit të infrastrukturës së gazit natyror, i cili përmbush kriteret sipas akteve ligjore në fuqi.
 - VKM Nr. 144, datë 13.03.2024 “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për dhënien e miratimit për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror” - Qëllimi i këtyre rregullave është të përcaktojnë procedurat dhe kriteret për aplikimin, vlerësimin dhe dhënien e një miratimi për ndërtimin e përdorimin e tubacioneve dhe të infrastrukturës përkatëse për transmetimin e shpërndarjen e gazit natyror ose për lidhjen e sistemit shqiptar të gazit natyror me sistemet fqinje, të instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL-së), të depozitave nëntokësore të gazit natyror, si dhe të linjave direkte.
- Me qëllim nxitjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, nga Janari 2024 është në funksion Impianti Fotovoltaik i Karavastasë (140 MW). Gjithashtu në 15 janar 2024, MIE shpalli fillimin e procedurës

- konkurruese për përzgjedhjen e projekteve për “Projektimin, financimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e disa impianteve fotovoltaike, secili me një kapacitet të instaluar ndërmjet 10 MW dhe 100 MW (përfshirë), të cilët do të përfitojnë masa mbështetëse, me vendndodhje të zgjedhur nga ofertuesi në Republikën e Shqipërisë, për një kapacitet max prej 300 MW.”, e cila pritet të përfundojë në 10 korrik 2024.
- Liberalizimi në tregun e energjisë ka kaluar në një fazë të re. Nga 1 janari 2024, bizneset e lidhura nëtension 20 kilovolt, tashme operojnë në tregun e lirë, që do të thotë se duhet ta sigurojnë të vetëm energjinë nga furnizuesit e licencuar.
 - Sikundër planifikuar në PKIE 2024 – 2026, është miratuar Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 117, datë 6.3.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 822, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar.
 - Në fushën e mjedisit janë marrë masa konkrete për legjislacionin horizontal, është miratuar urdhëri i Kryeministrit nr.4 datë 8.01.2024 Për miratimin e strukturës dhe të organizimit të Autoritetit shtetëror për informacionin gjeohapësinor.
 - Lidhur me menaxhimin e mbetjeve, me mbështetjen e Programit Rajonal të Evropës Juglindore, u prezantua më datë 27.3.2024, udhërrëfytyesi drejt Ekonomisë Rrethore të Shqipërisë.
 - Është miratuar urdhri i Kryeministrit nr. 35, datë 19.02.2024 “Për përcaktimin e masave të detajuara dhe institucionet përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importit apo futjes në territorin e Shqipërisë të qeseve plastike të transportit si dhe të okso-degradueshme apo oxo- qese transportuese plastike të biodegradueshme”.
 - Përsa i përket nënfushës së mbrojtjes së natyrës, është finalizuar procesi i rishikimit të ligjit 81/2017 “Për zonat e mbrojtura” me miratimin e ligjit nr. 21, datë 22.02.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”.
 - Në fushën e kimikateve është miratuar urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 95, datë 22.02.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për rishikimin e ligjit nr.95/2015 “Për produktet biocide dhe përdorimin e tyre në shëndetin publik”.

2.5 Grupimi i kapitujve 5 “Burimet, bujqësia dhe kohezioni”

Në përputhje me metodologjinë e re të Bashkimit Evropian për zgjerimin, grupimi 5 “Burimet, bujqësia dhe kohezioni social” paraqet një rëndësi të veçantë për Shqipërinë. Ai mbulon fusha të rëndësishme si bujqësia dhe zhvillimi rural (kapitulli 11) dhe peshkimi (kapitulli 13 + kapitujt 22 & 33). Legjislacioni evropian në këta sektorë synon ngritjen e sistemeve të qëndrueshme të furnizimit të ushqimit, përdorimit të metodave digjitale, inovative të përdorimit të burimeve, si dhe reduktimin e pesticideve dhe fertilizuesve, në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, rregullime specifike për sigurinë ushqimore, politikat veterinarë dhe fitosanitare (kapitulli 12), politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore (kapitulli 22), parashikimet financiare dhe buxhetore (kapitulli 33).

Procesi *screening* për Grupimin e pestë filloi zyrtarisht në korrik të vitit 2023 dhe u finalizua në nëntor të vitit 2023.

Gjatë periudhës Janar-Mars 2024 janë zhvilluar rreth 18 takime, në 5 GNPIE-të e Grupimit V “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”, ku janë të angazhuar rreth 229 anëtarë.

Më specifikisht, në 18 takimet e zhvilluara të mekanizmit për Grupimin V “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”, disa nga çështjet e trajtuara, diskutuar dhe konsultuar lidhen me (i) planifikimin dhe koordinimin e punës lidhur me projektin “Institutional Support to Albania in the Agricultural and Fisheries Sectors toward EU Accession” dhe zbatimin e tij duke identifikuar një Plan Veprimi përkatës për acquis sipas PKIE dhe PKABE; (ii) ndërgjegjësim mbi hapat në vijim mbi planin e veprimit, draftit të pozicionit negociues, piketat hapëse, kapacitetet administrative, gjetja e donatorëve, në përputhje me PKIE, PKABE, PSIE etj; (iii) finalizimi kontributit lidhur me databazën e Future Plans, databazën e Opening Benchmarks dhe databazën e Accelerated Integration (identifikuar deri tani); (iv) vlerësimin e nevojave për trajnim (GNPIE) 2024 – 2025, (v) vlerësimin e Tryezave të Diskutimit, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), (vi) bashkërendim në kuadër të projektit pilot të Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (KESE) adresuar përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve nga vendet candidate, (vii) analizë dhe identifikim të masave të parashikuara në Planet e së Ardhmes ‘Future plans’, (viii) Progres raportin dhe kontributet për vitin 2024; (ix) monitorimi i rekomandimeve të BE-së, (xiii) përditësimi i listave të përdoruesve të Platformës PIEA të Grupeve Ndërinstitucionale, (x) diskutimi lidhur me hartimin e Pozicionit Negociues; (xi) monitorimin e PKIE dhe PKABE, (xii) diskutime lidhur me gjetjet dhe rezultatet e Indekseve të raportit vjetor PSIE 2023 për Grupimin V “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”, (xvii) diskutime lidhur me planifikimin në kuadër të Planit Menaxherial (Semestral) i Integrimin Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE 2024) për Grupimin, etj.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të strukturave të integrimin, Indeksi i Kapaciteteve për periudhën Janar-Mars 2024 referuar 5 Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integrimin Evropian të Grupimit V “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”, rezultojnë 97%, nga ku 172 anëtarë të strukturave respektive janë trajnuar përmes skemës së trajnimit përmes Sekretariatit të Integrimin Evropian në kuadër të procesit të integrimin evropian dhe anëtarësimin, dhe 50 anëtarë janë trajnuar përmes skemave të shkëmbimit të njohurive me komisionin evropian në kuadër të procesit të integrimin.

Tematikat e trajnimeve adresojnë çështje të ndryshme, si (i) hapat e mëtejshëm për procesin e aderimit në Bashkimin Evropian’ (ii) identifikimin e nevojave për trajnim në të ardhmen për çështje me natyrë të përgjithshme të lidhura me procesin e Integrimin, ashtu si edhe për çështje me natyrë specifike të lidhura ngushtësisht me politikën që mbulon çdo GNPIE; (iii) trajnime lidhur me funksionalitetet e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian dhe Anëtarësimin (PIEA), (iv) vlerësimi i Performancës të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), etj.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese të Grupimit të pestë, lidhur me rekomandimet e BE-së paraqiten, si më poshtë vijon:

Në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural—në përputhje me rekomandimet e Komisionit: ka vijuar puna me përditësimin e Regjistrimit Kombëtar të Fermave. Aktualisht, numri i fermave aktive në regjistër është rreth 131 mijë;

Në fushën e peshkimit - është miratuar Udhëzimi i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 02, datë 30.01.2024 "Për miratimin e programeve të kontrollit dhe inspektimit të disa formave të peshkimit", i cili ka si qëllim miratimin e programeve të kontrollit dhe inspektimit të disa formave të peshkimit duke siguruar një zbatim uniform dhe efektiv të masave të ruajtjes dhe kontrollit për rezervat dhe format kryesore të peshkimit.

Në fushën e sigurisë ushqimore, veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve - nëpërmjet sistemit të CEFTA TRACES Nt, gjatë periudhës janar – mars 2024, janë lëshuar 978 certifikata fitosanitare për eksportin e bimëve dhe produkteve bimore. Ky system mundëson gjenerimin dhe përpunimin e certifikatave fitosanitare, veterinare dhe farmaceutike në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe praktikat më të mira të shteteve anëtare të BE-së. Deri më tani, janë regjistruar dhe operojnë në system 253 operatorë eksportues ekonomik.

Bazuar në legjislacionin vendas, me qëllim kontrollin e sëmundjeve të kafshëve, gjatë periudhës janar – mars 2024, janë miratuar të gjitha programet përkatëse që kanë të bëjnë me kontrollin dhe çrrënjosjen e brucelozës tek gjedhët dhe tek ripërtpësit e vegjël, kontrolli i sëmundjes së antraksit, kontrollin afatgjatë të sëmundjes së tuberkulozit, vaksinimin e sëmundjes së tërbimit. Në zbatim të këtyre programeve, janë kryer të gjitha analizat e nevojshme me qëllim identifikimin e sëmundjeve tek kafshët si dhe marrjen e masave të menjëhershme në cdo rast të mundshëm.

2.6 Grupimi i kapitujve 6 “Marrëdhëniet me jashtë”

Në përputhje me metodologjinë e re të Bashkimit Evropian për zgjerimin, grupimi i 6-të i kapitujve të negociatave mbulon dy kapituj kryesorë: kapitulli 30 “Marrëdhëniet me jashtë” dhe kapitulli 31 “Politika e jashtme e sigurisë dhe e mbrojtjes”.

Procesi *screening* për grupimin e gjashtë filloi zyrtarisht në shtator të vitit 2023 dhe u finalizua në nëntor të vitit 2023.

Gjatë periudhës Janar-Mars 2024 është zhvilluar 1 takim, në 2 GNPIE-të e Grupimit “Marrëdhëniet me Jashtë”, ku janë të angazhuar rreth 54 anëtarë.

Më specifikisht, në takimin e zhvilluar të mekanizmit për Grupimin VI “Marrëdhëniet me Jashtë”, disa nga çështjet e trajtuar, diskutuar dhe konsultuar lidhen me (i) vlerësimin e nevojave për trajnim (GNPIE) 2024 – 2025; (ii) vlerësimin e Tryezave të Diskutimit, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PIIE); (iii) bashkërendim në kuadër të projektit pilot të Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (KESE) adresuar përfaqësuesve të shoqërisë civile, përfaqësuesit e organizatave të punëdhënësve nga vendet kandidate; (iv) analizë dhe identifikim të masave të parashikuara në Planet e së Ardhmes ‘Future plans’; (v) Progres raportin dhe kontributet për vitin 2024; (ix) monitorimi i rekomandimeve të BE-së, (vi) përditësimi i listave të përdoruesve të Platformës PIEA të Grupeve Ndërinstitucionale, (vii) diskutimi lidhur me hartimin e Pozicionit Negociues; (viii) monitorimin e PKIE dhe PKBAE; (xii) diskutime lidhur me gjetjet dhe rezultatet e Indekseve të raportit vjetor PSIE 2023 për Grupimin VI “Marrëdhëniet me Jashtë”; (xvii) diskutime lidhur me planifikimin në kuadër të

Planit Menaxherial (Semestral) i Integritimit Evropian për Forcimin e Kapaciteteve Administrative (PSIE 2024) për Grupimin, etj.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të strukturave të integritimit, Indeksi i Kapaciteteve për periudhën Janar-Mars 2024 referuar 2 Grupeve Ndërinstitucionale të Punës për Integritimin Evropian të Grupimit VI “Marrëdhëniet me Jashtë”, rezulton 74%, nga ku 20 anëtarë të strukturave respektive janë trajnuar përmes skemës së trajnimit përmes Sekretariatit të Integritimit Evropian në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe anëtarësimit, dhe 20 anëtarë janë trajnuar përmes skemave të shkëmbimit të njohurive me institucione të vendeve anëtare.

Tematikat e trajnimeve adresojnë çështje të ndryshme, si (i) identifikimin e nevojave për trajnim në të ardhmen për çështje me natyrë të përgjithshme të lidhura me procesin e Integritimit, ashtu si edhe për çështje me natyrë specifike të lidhura ngushtësisht me politikën që mbulon çdo GNPIE; (ii) trajnime lidhur me funksionalitetet e Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian dhe Anëtarësimin (PIEA); (iii) vlerësimi i Performancës të Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian (PIIE), etj.

Arritjet kryesore gjatë periudhës raportuese të Grupimit të gjashtë, lidhur me rekomandimet e BE-së paraqiten, si më poshtë vijon:

- Shqipëria vijon të ketë përputhshmëri të plotë me deklaratat e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë (HRVP) dhe vendimet e Këshillit në lidhje me masat kufizuese, duke arritur një shkallë përputhshmërie prej 100%. Nga janari deri në mars 2024, Shqipëria është përafëruar me 33 deklarata të HRVP dhe vendime të Këshillit.
- U miratua ligji Nr 4/2024 “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Kjo strategji synon të pasqyrojë në mënyrë sa më gjithëpërfshirëse sfidat dhe kërcënimet kryesore për sigurinë kombëtare të vendit tonë, si dhe të përfshijë përgjigjet institucionale ndaj tyre në harkun kohor 2023–2028.
- Në fushën e tregtisë, Shqipëria ka vijuar të zbatojë planin e veprimit për Krijimin e Tregut të Përbashkët Rajonal duke u fokusuar kryesisht në harmonizimin e orëve të punës në agjensitë kufitare, zgjerimin e korsive të gjelbra, zbatimin e vendimit të CEFTA mbi lehtësimin e tregtisë së frutave dhe perimeve etj.

PJESA III: PJESËMARRJA E GRUPEVE TË INTERESIT NË PROCESIN E NEGOCIATAVE DHE INTEGRIMIT EVROPIAN

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është një proces gjithëpërfshirës mbarëkombëtar me ndikim në të gjithë shoqërinë shqiptare. Në përputhje me vendimin nr.749 datë 19.12.2019, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse për zhvillimin e negociatave dhe përfundimin e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE) është mekanizmi kryesor për informimin, konsultimin, komunikimin dhe përfshirjen shoqërisë civile, grupeve të interesit, botës akademike dhe organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, si dhe në procesin e stabilizim-asociimit.

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 749, datë 19.12.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e strukturës shtetërore përgjegjëse, për zhvillimin e negociatave dhe lidhjen e Traktatit të Aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian" si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr.113 datë 30.08.2019 "Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian", gjatë periudhës raportuese nga Departamenti i Politikës dhe Integrit Evropian/Sekretariati i Integritit Evropian në bashkërendim me projektin "Mbështetje për Negociatat e Anëtarësimit për Kapitujt Ekonomikë të Acquis"- SANECA II, financuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, zbatuar nga GIZ është iniciuar procesi i vlerësimit të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për përmirësimin e dialogut përmes PPIE-së, dhe Tryezave të Diskutimit & Këshillimit, për çdo kapitull të aquis dhe kritere.

Në këtë drejtim, si fazë e parë e procesit u hartua korniza e vetëvlerësimit si dhe bashkërenduar për tu plotësuar nga të gjithë anëtarët e PPIE-së. Përmes këtij instrumenti vetëvlerësimi, synohet të paraqitet një vlerësim i nivelit të angazhimit të grupeve të interesit në procesin e integritit përmes tryezave të Platformës. Në këtë kuadër është kryer identifikimi i situatës dhe specifikimeve të rekomandime për përmirësimin e punës së tryezave të konsultimit, për të mundësuar planifikimin në të ardhmen masa që do të nxisin dialogun e hapur me grupet e interesit në funksion të një procesi të suksesshëm të negociatave me BE-në.

Përsa më sipër, Sekretariati i Integritit Evropian brenda tre-mujorit të parë 2024 përgatiti raportin e vlerësimit të performancës së PPIE-së në bashkëpunim me GIZ.

Ky raport vlerësimi për PPIE-në synon të vlerësojë performancën e aktorëve joshtetërorë, veçanërisht anëtarëve të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPEI) lidhur me nivelin e performancës së tryezave të konsultimit në përfshirjen e aktorëve të interesit në procesin e bisedimevetë anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

- Bazuar në një metodologji gjithëpërfshirëse raporti përfshiu përfaqësues nga komuniteti i biznesit, universitetet, organizatat e shoqërisë civile, urdhrat profesionale dhe shoqatat e punëmarrësve.

- U synua një kampion sa më përfaqësues dhe që reflekton ata që janë të përfshirë në mënyrë aktive në procesin e konsultimit përmes tryezave të informimit dhe konsultimit të PPIE. Veç kësaj kategorie, në raport u përfshinë dhe individë të tjerë që janë anëtarë potencialë në PPIE. Raporti mbledhi 115 përgjigje të vlefshme, mes të cilëve 44 anëtarë të PPIE nga 350 kontakte në total. Të dhënat e mbledhura u plotësuan dhe konsoliduan nga intervista të thelluara me aktorë interesi brenda dhe jashtë Platformës.
- Gjetjet e analizuar nxjerrin në pah një performancë përgjithësisht pozitiv midis pjesëmarrësve, si dhe vënë theksin në rëndësinë e komunikimit të qartë, proceseve transparente dhe angazhimit të vazhdueshëm të aktorëve të interesit në procesin e bisedimeve të anëtarësimit me BE-në.

Raporti u diskutua dhe u bashkërendua me Rrjetin e Integritimit Evropian, në një mbledhje të dedikuar në Mars 2024 dhe gjithashtu u prezantua në mbledhjen e Grupit Negociator No 24, datë 28 Mars 2024.

Incentivimi i anëtarëve të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian për të aplikuar në Komitetin Evropian Ekonomik dhe Social (EESC)

Komiteti EESC është një pjesë integrale e BE-së, e krijuar në 1957 nga Traktati i Romës për të këshilluar vendimmarrësit e BE-së dhe për të siguruar që organizatat dhe rrjetet e shoqërisë civile në të gjithë kontinentin të kenë një rol në zhvillimin e Evropës.

- o Komiteti është një forum unik për konsultim, dialog dhe konsensus ndërmjet përfaqësuesve nga të gjithë sektorët e shoqërisë civile. Të gjithë iniciativat e BE-së i dorëzohen Komitetit për një opinion të detyrueshëm përpara miratimit të tyre.
- o Komiteti përbëhet nga 329 anëtarë me rreth 250 organizata dhe rrjete në nivel kombëtar nga të 27 Shtetet Anëtare të BE-së. Anëtarët përfaqësojnë shoqatat e punëdhënësve, industrinë, dhomat e tregtisë, shoqatat e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), sindikatat, konsumatorët, fermerët, profesionet e lira, aktivistët e aftësisë së kufizuar, akademinë, grupet e të drejtave të grave, ambientalistët, organizatat rinore, të të drejtave të njeriut etj.

Në kuadër të Iniciativës së lançuar roli i ‘Anëtarëve Kandidatë për Zgjerim/Enlargement Candidate Members’ (ECMs) është një titull honorifik, i cili tregon mbështetje dhe konsideratën për përfaqësuesit e shoqërisë civile në vendet candidate për në BE. Roli i ECM-së në kuadër të Komitetit Evropian Ekonomik dhe Social (EESC) është i ndryshëm nga anëtarësimi në Komitet, siç përcaktohet në nenet 300 deri në 304 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFUE), më specifikisht lidhet me përfshirjen:

- o Në procesin e hartimit të opinionëve të përzgjedhura të Komitetit, duke përfshirë dhe mbledhjet e seksioneve dhe seancave plenare;
- o Në procesin e hartimit të një numri opinionesh të zgjedhura të Komitetit (opinionet legislative, eksploruese ose me iniciativë) për tema ku pjesëmarrja e tyre është veçanërisht e rëndësishme, si p.sh. opinione të rëndësishme legislative në lidhje me zgjerimin, opinione mbi çështjet pan-evropiane dhe globale;

Përsa më sipër, në kuadër të fuqizimit të rolit të anëtarëve të Platformës për Integrimin Evropian, u lançua më 4 Janar 2024 të thirrjes për shprehje interesi për organizatat e shoqërisë civile, akademinë, sindikatave, duke vlerësuar se kjo iniciativë është e veçantë,

duke u ofruar për herë të parë vendeve kandidate një mundësi specifike për përfshirje dhe pjesëmarrje dhe në këtë drejtim Sekretariati i Integritimit në bashkëpunim me sekretariatet e GNPIE bashkërenduar procesin e informimit dhe aplikimit të anëtarëve të PPIE-ve.

Nga procesi i ndjekur rezulton se në thirrjen e Komitetit u aplikuan rreth 567 aplikime, nga të cilat 131 u pranuan për grupin e ECM-ve nga të cilat 48% i zenë vendet e Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut) dhe 52% të ashtuquajtuarit vendet e Trios (Ukrainë, Moldavi, Gjerogji) + Turqia. Më specifiku:

- Nga vendet e Ballkanit Perëndimor rezultojnë në total 63 fitues, ku Shqipëria dhe Serbia me 13 anëtarë fitues, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut me 14 anëtarë fitues dhe Bosnjë Hercegovina me 9 anëtarë fitues.
- Nga vendet e Trios + Turqia rezultojnë në total 68 fitues, ku Ukraina me 22 fitues, Turqia dhe Gjeorgjia me 13 anëtarë fitues, dhe Moldova me 14 anëtarë fitues.

Nga rezultatet zyrtare të listës së fituesve për Shqipërinë (13 fitues), rezulton se 9 anëtarë të listës së fituesve si anëtarë ECM janë dhe anëtarë të Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian. Më specifiku, si më poshtë vijon:

- Katër fitues (4) - anëtarë të Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian, Treyza e Kapitullit 23 'Gjyqësori dhe të drejtat themelore' & Treyza e Kriterit 'Funksioni i Institucioneve Demokratike', Grupimi I 'Themeloret';
- Dy (2) fitues - anëtarë të Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian, Treyza e Kapitullit 3 'E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime' & Treyza e Kapitullit 28 'Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit publik', Grupimi II "Tregu i brendshëm";
- Një fitues (1) - anëtar i Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian, Treyza e Kapitullit 27 'Mjedisi', Grupimi IV 'Agjenda e Gjellbër dhe Lidhshmëria e Qëndrueshme';
- Një fitues (1) - anëtar i Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian, Treyza e Kapitullit 11 'Bujqësia dhe Zhvillimi Rural', Grupimi V 'Bujqësia, Zhvillimi Rural dhe Kohezioni';
- Një fitues (1) - anëtar i Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian, Treyza e Kapitullit 31 'Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes', Grupimi VI 'Marrëdhëniet me Jashtë';

Lidhur me funksionimin e Platformës së Partneritetit dhe Integritimit Evropian, për periudhën raportuese Janar - Mars 2024 rezulton se janë zhvilluar 33 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian, me 47 tematika prioritare diskutimi, me një pjesëmarrje në total të 492 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (177), përfaqësuesve nga shoqëria civile (80), përfaqësuesve nga akademia/universitetet (166), përfaqësuesve nga pushteti vendor (28), përfaqësuesve të organizatave punëmarrëse (2), përfaqësuesve të biznesit (28) dhe media (11).

Grupimi 1 "Themeloret"

Lidhur me funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian, për periudhën raportuese janar-mars 2024 rezulton se janë zhvilluar 16 mbledhje/tryeza të Platformës së

Partneritetit për Integrimin Evropian, ku janë trajtuar rreth 17 çështje tematikash dhe me një pjesëmarrje në total të 227 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (77), përfaqësuesve nga shoqëria civile (59) dhe përfaqësuesve nga akademia/universitetet (42), përfaqësues të pushtetit vendor(24), përfaqësues të komunitetit të biznesit (15), përfaqësues të shoqatave të punëmarrësve (2), përfaqësues të medias(8).

Në këto takime janë trajtuar, diskutuar dhe konsultuar çështje lidhur me:

- Draft Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030 dhe plani i saj i veprimit për konsultim publik;
- Masat e parashikuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024-2026;
- Rishikimi i Ligjit “Për Konkensionet dhe Partneritetin Publik Privat PPP” dhe harmonizimi i tij me direktivën e Bashkimit Evropian, saktësisht Direktiva 2014/23/BE.
- Marrjen e masave për mbledhje e kontributit të parë mbi progres raportin për BE 2024.
- Masat për etiken dhe integritetin në bashkëpunim me shoqërinë civile. Fokusi kryesor i takimit ishte mbi marrjen e masave për zbatimin e masave të parashikuara për 2024 në Udhërrëfyesin e RAP për etiken dhe integritetin.
- Fillimin e procesit të vlerësimit të SIGMA/ marrja e masave, njohje me pyetësin dhe metodologjinë.
- Vlerësim të arritjeve të administratës publike në këto vite dhe për të theksuar nevojën për një fazë të re energjizimi dhe profesionalizmi, me qëllim të rritjes së performancës së Shqipërisë në përgjithësi, duke fuqizuar mirëqeverisjen, rendin ligjor dhe luftën kundër korrupsionit.
- Rëndësia e rienergizimit të administratës, fuqizimin e burimeve njerëzore ekzistuese, si dhe mbi domosdoshmërinë e vlerësimit të vazhdueshëm të performancës së punonjësve me kryefjalë meritokracinë.
- Objektivat prioritare në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2024-2030;
- Menaxhimi i migracionit të parregullt dhe bashkëpunimi me Frontex;
- Agjendën e Reformave në kuadër të Growth Plan (Plani i Rritjes).
- Draft Udhërrëfyesi për Funkcionimin e Institucioneve Demokratike ku u diskutua për të gjitha masat e parashikuara;
- Përfshirja e OSHC-ve gjatë procesit zgjedhor, kryesisht në përmirësimin e cilësisë mediatike dhe mbikëqyrjen e financimeve të partive politike dhe institucioneve mediatike formale apo informale të shtuara në masë vitet e fundit;
- Mbrojtja e fëmijëve online nga çdo lloj forme dhune dhe abuzimi dhe reformat në kuadër të shtetit të së drejtës;

Grupimi 2 “Tregu i brendshëm

Lidhur me funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për periudhën raportuese janar-mars 2024 rezultoi se janë zhvilluar 4 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, ku janë trajtuar rreth 13 çështje tematikash me një pjesëmarrje në total të 74 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (32), përfaqësuesve nga shoqëria civile (7), përfaqësues të pushtetit vendor (2), përfaqësues të komunitetit të biznesit (6), përfaqësues të medias (2) dhe përfaqësuesve nga akademia/universitetet (25).

Në këto takime janë trajtuar, diskutuar dhe konsultuar çështje lidhur me:

- Ecurinë e procesit të negociatave dhe roli i aktorëve të interesit,

- Takimet bilaterale, angazhimet e Shqipërisë dhe rekomandimet e progres-raportit të Komisionit Evropian,
- Roli dhe rëndësia e angazhimit të dhomave në tryezat e konsultimit lidhur me pronësinë intelektuale,
- Strategjia Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2022 – 2025,
- Reforma ligjore në fushën e pronësisë industriale si dhe diskutime mbi aktet e reja/të pritshme në kuadër të reformës ligjore për pronësinë industriale,
- Prezantimi i instrumentit të vetëvlerësimit për NVM – të dhe start up – et (WIPO IP prediagnostic) si dhe diagnostikimi për Pronësinë Intelektuale përmes WIPO. Gjithashtu diskutim lidhur me fushat e pronësisë intelektuale që mbulon instrumenti dhe rëndësia e vetëdiagnostikimit për bizneset,
- Roli dhe kontributi i Institucioneve të Arsimit të Lartë në procesin e zbatimit e strategjisë Kombëtare të pronësisë Intelektuale 2022-2025,
- Hartimi i ndryshimeve në Ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" me qëllim përafrimin me direktivën Solvency II,
- Përgatitjen e udhërrëfyesit për transpozimin e direktivës 2002/87/KE e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian e datës 16 dhjetor 2002 mbi mbikëqyrjen plotësuese të institucioneve të kreditit, shoqërive të sigurimit dhe shoqërive komisionere në një konglomerat financiar, në kuadër të angazhimeve në takimin bilateral,
- Diskutime në drejtim të vendosjes së rregullave për taksonominë si dhe nxitjes dhe promovimit të financave të gjelbra si një prej kërkesave që rrjedh nga agjenda e shërbimeve financiare,
- Përfarimi i ligjit për fondet e pensioneve private, miratuar në vitin 2023 me direktivën e BE-së IORP II dhe hartimi i akteve nënligjore,
- Prezantimi i gjetjeve të analizës të kuadrit ligjor shqiptar në lidhje me projektligjin e shitblerjes e tokës bujqësore nga shtetasit e huaj,
- Prezantimi i gjetjeve të raportit të performancës lidhur me Platformën e Partneritetit dhe Integrimin Evropian.

Grupimi 3 “Konkurrueshmëria dhe rritja gjithpërfshirëse”

Lidhur me funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për periudhën raportuese janar-mars 2024 rezulton se janë zhvilluar 8 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, ku janë trajtuar rreth 7 çështje tematikash me një pjesëmarrje në total të 154 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (40), përfaqësuesve nga shoqëria civile (12), dhe përfaqësuesve nga akademia/universitetet (96).

Në këto takime janë trajtuar, diskutuar dhe konsultuar çështje lidhur me:

- Programi Digjital i BE-së me pjesëmarrjet e subjekteve kandidate për EDIH;
- Diskutimi kryesisht në rolin konkret e praktik që anëtarët e PPIE duhet të kenë për të mbështetur procesin e integrimin;
- Hartimi i Programit Kombëtar për Aderimin në Bashkimin Evropian (PKABE) 2030 dhe PKIE 2024-2026, Paketa Semestrare e Integrimin Evropian (PSIE), progres raporti 2023, Platforma e Integrimin Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA), si edhe ndjekja e rekomandimeve të Progres Raportit, KSA, Nënkomitetet dhe prioritetet e PKIE 2023-2025;
- Procesi i integrimin në fazën e hartimit të pozicionit të negociatave;
- Diskutim mbi Programin Erasmus+;

- Agjenda e Planit të Rritjes/Growth Plan, sipas tematikës Kapitali Njerëzor/Human Capital.

Grupimi 4 “Agjenda e Gjellbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme”

Lidhur me funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për periudhën raportuese janar-mars 2024 rezulton se është zhvilluar 1 mbledhje/tryezë e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, ku janë trajtuar 1 çështje tematike me një pjesëmarrje në total të 18 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (18).

Në takim u trajtua, diskutua dhe konsultua çështje lidhur me:

- Agjenda e Planit të Rritjes/Growth Plan.

Grupimi 5 “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”

Lidhur me funksionimin e Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, për periudhën raportuese janar-mars 2024 rezulton se janë zhvilluar 4 mbledhje/tryeza të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian, ku janë trajtuar 9 çështje tematike me një pjesëmarrje në total të 19 aktorëve/grupeve të interesit si ekspertë të fushës (10), përfaqësuesve nga shoqëria civile (2), përfaqësuesve nga academia/universitetet (3), përfaqësues të pushtetit vendor (2), përfaqësues të komunitetit të biznesit (1) dhe përfaqësues të medias (1).

Në këto takime janë trajtuar, diskutuar dhe konsultuar çështje lidhur me:

- Procesi i integritit/ përgatitjet e negociatave për anëtarësim;
- Arritjet dhe Rekomandimet e Progres Raportit për Shqipërinë, për vitin 2024;
- Monitorimi i Planit Kombëtar të Integritit Evropian 2024-26 për kapitullin 11;
- Planin e punës për vitin 2024 të GNPIE-së;
- Përcaktimi i përgjegjësisë sipas rolit të anëtarëve në dërgimin e kontributit gjatë periudhës Prill-Maj lidhur me kapitujt e Planit të Veprimit, përgjegjësitë sipas rolit të anëtarëve;
- Aktet pjesë përbërëse të PKIE 2024-2026;
- Angazhimet e ndërmarra në kuadër të takimit screening, Future Plans;
- Veprimtarinë e Asistencës Teknike dhe ngritja e kapaciteteve teknike për të gjithë aktorët e përfshirë në kapitullin 22.

PJESA IV: INTEGRIMI EVROPIAN NË NIVEL VENDOR

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është një proces kompleks dhe gjithëpërfshirës, i cili bëhet realitet nëpërmjet kontributit të të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjithë shoqërisë. Integrimi në Bashkimin Evropian kërkon edhe angazhimin & rolin e pushtetit vendor. Me progresin në hapat drejt aderimit, drejtuesit e qeverisjes lokale dhe administratat e tyre duhet të sigurojnë që qytetarëve të tyre t'u ofrohen të njëjtat shërbime, ashtu si edhe qytetarëve të Bashkimit Evropian dhe që demokracia lokale të zbatohet në mënyrë eficiente dhe gjithëpërfshirëse.

Për të adresuar sa më sipër, një sërë masash janë ndërmarrë gjatë periudhës raportuese për të mbështetur bashkitë dhe administratën e tyre në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe administrative lidhur me procesin e integrimit evropian.

Në kuadër të zhvillimeve të fundit, me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 557, datë 4.10.2023 u miratua fusha e përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, i cili është një hap drejt fokusit tek decentralizimi dhe forcimi i rolit të pushtetit vendor në integrimin evropian.

4.1. Ngritja e kapaciteteve institucionale mbi integrimin evropian

4.1.1. Dialogu Vendor

Procesi i Integrimit Evropian është një prej prioriteteve kryesore të Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2024. Në këtë kuadër, me iniciativë të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor, AMVV ka zhvilluar aktivitete të shumta në bashkëpunim me projektin Bashkitë për në Evropë.

Statusi i menaxhimit dhe personelit të NjIE-ve

Më poshtë është situata në lidhje me personelin e Njësive të IE:

- **NjIE pa staf:** Bashkitë e Poliçanit, Skraparit dhe Konispolit mbeten ende pa staf në NjIE. Në databazën e Njësive të Integrimit kemi pika kontakti të përkohshme për të mos humbur komunikimin dhe informacionin.
- **Zgjerimi i kapaciteteve të NjIE:** Bashkia Belsh ka zgjeruar stafin e NjIE me 2 persona shtesë.

1. Ofrimi i trajnimeve

Gjatë periudhës raportuese, veprimet për ngritjen e kapaciteteve u përqendruan në trajnimet si vijon në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për (i) rritjen e kapaciteteve të bashkive në thirrjet e reja për propozime të nisura në kuadër të Programeve të Unionit me fokus në nivelin lokal (Rrjetëzimi i Qyteteve nën CERV - Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat); (ii) trajnime të synuara për stafin e menaxhimit të nivelit të lartë të bashkive (Sekretarët e Përgjithshëm/ Nënkryetarët/ Drejtorët e Drejtorive/ Këshilltarë e stafe të NjIE etj.);(iii) organizimi i një seri trajnimesh shumë të kërkuara me ekspertë të BE-së për procedurat e PRAG dhe; (iv) Trajnime për Menaxhimin Financiar të Projekteve të BE-së.

Në total, gjatë periudhës raportuese janë realizuar trajnimet e mëposhtme.

Tabela 1: Tabela përmbledhëse e trajnimit të ofruar: Janar – Mars 2024

Nr.	Trajnimet	Vendi	Nr. Trajnimeve	Datat	Nr. bashkive	Nr. pjesëmarrësve
1	Trajnimi për PRAG - bashkitë e Rajoneve Elbasan, Korçë	Tirana	2	8-9-10-11-12 Janar	17	50
2	Trajnim i SG dhe Zv. Kryetarëve të Komunave për Politikat Rajonale dhe Fondet e Kohezionit	Tirana	2	16-17-18-19 Janar	37	47
3	Trajnimi për Menaxhimin Financiar të Projekteve të BE-së – bashkitë e rajoneve	Tirana	1	24-25-26 Janar	9	28
4	Trajnimi për PRAG	Tirana	2	29-30-31 Janar – 1 -2 Shkurt	16	47
5	Trajnimi për PRAG	Tirana	2	5-6-7-8-9 Shkurt	17	36
6	Mentoring Menaxhimi Financiar i Projekteve të BE-së	Online	2	13 Shkurt		
7	Trajnimi për Menaxhimin Financiar të Projekteve të BE-së – bashkitë e rajoneve	Tirana	1	14-15-16 Shkurt	10	23
8	Rrugëtimi drejt Shkrimit të një Projekt Propozimi të Suksesshëm sipas Ciklit të PCM	Tirana	2	19-20-21-22-23 Shkurt	27	53

Nr.	Trajnimet	Vendi	Nr. Trajnimeve	Datat	Nr. bashkive	Nr. pjesëmarrësve
9	Trajnimi për PRAG	Shkodër	2	4-5-6-7-8 Mars	11	34
10	Trajnimi për Menaxhimin Financiar të Projekteve të BE-së – bashkitë e rajoneve	Tirana	1	18-19-20 Mars	8	14

Trajnimet mbi PRAG dhe ato të Menaxhimit Financiar janë kombinuar me ditë të dedikuara mentorimi dhe trajnimi individual për Bashkitë:

Nr.	Trajnimet	Vendi	Nr. Trajnimeve	Datat	Nr.bashkive	Nr. pjesëmarrësve
1	Mentorim - Menaxhimi Financiar i Projekteve të BE-së	Online	2	13 Shkurt	2 (Roskovec, Durrës)	4
2	Mentorim dhe Trajnim individual për PRAG	Online	2	26 Mars	2 (Tiranë, Lezhë)	6
3	Mentorim dhe Trajnim individual për PRAG	Online	3	27 Mars	3 (Klos, Tepelenë, Lezhë)	4
4	Mentorim dhe Trajnim individual për PRAG	Online	1	28 Mars	1 (Mirditë)	6
5	Mentorim dhe Trajnim individual për PRAG	Online	1	29 Mars	1 (Roskovec)	7

Gjatë periudhës së raportimit, janë asistuar bashkitë në zbatimin e projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian në kuadër të Programeve Evropiane, ato të financuara nga Delegacioni i BE-së në Tiranë, në lidhje me hapjen e llogarive, transferimin e pagesave, ndryshimet në zërat buxhetorë, etj.

2.1 Trajnim i nivelit të lartë me Sekretarët e Përgjithshëm dhe Zëvendës Kryetarët e Bashkive për politikën dhe fondet e kohezionit të BE -së

Edhe gjatë periudhës raportuese vijoi trajnimi i Sekretarëve të Përgjithshëm dhe Nënkryetarëve të bashkive dhe drejtuesve të njësive të BE-së lidhur me proceset e integritetit evropian, si dhe politikën e kohezionit dhe fondet e kohezionit të BE në koordinim me ASPA-n.

Trajnimi ishte vijuesi i 2 trajnimeve të para rajonale me Sekretarët e Përgjithshëm dhe Nënkryetarët e Bashkive duke plotësuar sa më shumë hartën e mbulimit të trajnimit të trupës së nivelit të lartë drejtues.

Trajnimi ishte një kombinim i ekspertëve lokalë dhe ekspertizës ndërkombëtare (16 – 17 Janar dhe 18-19 Janar 2024). Ekspertët e Projektit Bashkitë për në Evropë prezantuan rrugëtimin e Shqipërisë dhe rolin e bashkive në procesin e integritit, ecurinë e bashkive në kuadër të procesit të integritit evropian dhe përmbushjen e detyrimeve që i dalin bashkive nga axhenda e integritit evropian. Pjesëmarrësve ju prezantua eskperienca e disa vendeve evropiane, si Slloveni, Kroaci, Poloni etj mbi përfitimet nga programet e kohezionit të BE-së, por duke u theksuar gjithashtu edhe rolin dhe funksionet e përfituesve, si dhe sfidat e kapaciteteve absorbuese.

Në trajnim mori pjesë edhe znj. Marie Auguoy, Menaxhere e Programit per Zhvillimin Lokal e Rajonal në Delegacionin e Bashkimit Evropian, e cila u dha pjesëmarrësve mesazhe të rëndësishme mbi rëndësinë e përgatitjes paraprake të njësive të qeverisjes vendore të Shqipërisë për të kuptuar më mirë politikat rajonale dhe të kohezionit të BE-së, si dhe Fondet e kohezionit të BE-së, rëndësia e forcimit të kapaciteteve të bashkive dhe të strukturave të integritit evropian, në mënyrë që të mund të përfitojnë sa më shumë nga mundësitë që do të ketë QV-re pasi të mbyllen me sukses negociatat mes BE-së dhe qeverisë së Shqipërisë për Kapitullin 22, dhe Shqipëria do të fillojë të përfitojë nga skemat e financimit të BE-së ne kuadër të programit European Regional Development Fund (ERDF) dhe programeve të tjera.

Drejtues me përvojë të Njësive të Integritit iu bashkuan trajnimeve për të ndarë përvojën e tyre duke rritur nivelin e diskutimit për çështje të zbatimit në praktik të politikave.

2.2 Trajnimet Rajonale mbi PRAG - Prokurimi sipas rregullave dhe kushteve të BE-së

Organizimi i Trajnimeve Rajonale mbi PRAG ishte rezultat kërkesave të vazhdueshme nga NjIE dhe stafi i bashkive që po punojnë në projekte të financuara nga BE.

Një ekspert ndërkombëtar i angazhuar nga projekti Bashkite për ne Evrope vijoi të angazhohet në ofrimin e trajnimeve të kryera për bashkia të organizuara sipas rajoneve të ndryshme. Qëllimi i trajnimeve ishte rritja e njohurive dhe kompetencave në prokurimin, menaxhimin e kontratave dhe zbatimin e projekteve sipas rregullave dhe kushteve të PRAG të BE-së.

Një trajnim i parë Rajonal nisi më 13-14-15 Dhjetor 2023 në Tiranë me pjesëmarrje nga bashkitë Tiranë, Vorë, Rrogozhinë, Kamëz, Kavajë, Dibër, Klos, Mat, Bulqizë.

Trajnimet rajonale vijuan edhe me **8 të tjerë** të ndarë sipas rajoneve (tabela më sipër) në periudhën **Janar – Mars 2024** duke mbuluar kështu të gjithë Shqipërinë me mbështetje dhe informacion sa i përket procedurave të prokurimit sipas PRAG.

Pjesëmarrësit ishin nga zyrat e prokurimit, ato ligjore, urbanistika, kryesisht specialiste që merren me zbatimin e projekteve dhe investimet, si dhe stafet e NjIE që punojnë në mbështetje në përgatitjen e dokumenteve të prokurimit. Trajnimeve iu bashkuan edhe përfaqësues të AMVV.

Trajnimet u fokusuan në rregullat e PRAG të BE-së, menaxhimin e kontratave dhe zbatimin e projekteve me fokus të veçantë në rregullat e PRAG për shërbime, furnizime, punë dhe grante, si dhe më shumë në të kuptuarit e temave të PRAG, sesa vetëm në çështjet administrative.

Ato u kombinuan edhe me seanca mentorimi nga ekspertë në lidhje me përgatitjen e paketave të prokurimit sipas PRAG për periudhën 25-29 Mars 2024.

2.3 Trajnimet Rajonale për Menaxhimin Financiar të Projekteve të BE-së

Organizimi i Trajnimeve Rajonale për Menaxhimin Financiar të Projekteve të BE-së u organizua më të njëjtën përjasje si ajo për PRAG, duke grupuar të **61 bashkitë në 5 Trajnime Rajonale**. Një ekspertë kroate u angazhua për të mbajtur trajnimin e koordinuar me politikat kombëtare sa i përket hapjes së llogarive, bashkë-financimit, TVSH-në, etj.

Një seancë me shume interes për pjesëmarrësit ishte dhe prezantimi i mbajtur nga Agjencia Shqiptare e Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga BE lidhur me Rolin e strukturës duke e kombinuar me shembuj praktikë mbi gjetjet me impakt financiar.

Dita e tretë e trajnimeve u koordinua me Projektin “BE-ja për Bashkitë”. Kjo ditë iu dedikua ndarjes së përvojave në kuadrin e 2 Skemave të Granteve nën Projektin EU4M: problematikat e ndeshura dhe mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të granteve. Ekspertët e projektit prezantuan përvojat më të mira, orientimet, sugjerimet duke diskutuar së bashku me pjesëmarrësit.

Temat e trajnimeve, të mbështetura me shembuj praktikë, udhëzuan pjesëmarrësit dhe informuan ata më në detaj në lidhje me çfarë duhet të kemi parasysh përpara se të fillojmë zbatimin e projekteve, elementët e kontratës, parimet e menaxhimit, pranueshmërinë e shpenzimeve, buxhetimi, pagesat, raportimi, auditimi, kontrolli financiar, rregullat e vizibilitetit, etj.

Pjesëmarrësit ishin përfaqësues nga zyrat e financës dhe projekteve, përgjegjës për zbatimin e projekteve, si dhe stafet e NjIE që janë të angazhuar me projektet. Trajnimit iu bashkuan edhe përfaqësues të AMVV.

Gjatë periudhës Janar – Mars u mbajtën 3 trajnime rajonale 24-25-26 Janar 2024, 14-15-16 Shkurt dhe 18-19-20 Mars 2024.

Trajnimet u kombinuan edhe me seanca mentorimi nga ekspertja për të diskutuar në praktikë për procedurat dhe problematikat e ndeshura në zbatimin e projekteve.

2.4 Trajnimi i stafit të ri të EIU-ve dhe ato që merren me përgatitjen e projekteve: Rrugëtimi drejt Shkrimit të Një Projekt Propozimi të Suksesshëm sipas Ciklit të PCM

Si praktikë e projektit, trajnimet në lidhje me shkrimin e projekteve organizohen të koordinuara me thirrjet e hapura në kuadër të programeve të BE-së, sidomos ato thirrje që kanë në target bashkitë. Gjatë periudhës së raportimit ishte hapur thirrja nën Programin CERV – Citizens, Equality, Rights and Values/Qytetarët, Barazia, të Drejtat dhe Vlerat – Rrjetëzimi i Qyteteve.

Në këtë kuadër u organizuan 2 trajnime rajonale me përjasjen e klinikave trajnuese mbi Rrugëtimin drejt Shkrimit të Një Projekt Propozimi të Suksesshëm sipas Ciklit të PCM në datat **19-20-21 Shkurt (grupi 1) dhe 21-22-23 Shkurt (grupi 2)**.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit u ndanë në grupe dhe ndoqën me shembuj praktikë të gjitha elementët e përgatitjes së një projekti të suksesshëm.

2.5 Workshopi “Bashkitë dhe Procesi i Integritimit në BE: Roli i Këshillave Bashkiakë”

Në datën 21 shkurt 2024, AMVV me mbështetjen e Projektit “Bashkitë për në Evropë” organizoi në Tiranë seminarin me temë “Bashkitë në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë – Roli i Këshillave Bashkiakë”. Workshop-i është zhvilluar me kryetarët e këshillave bashkiakë në 61 bashkitë e Shqipërisë, ndërkohë që të pranishëm kanë qenë Znj. Romina Kuko, Zëvendësministre e Brendshme, Z. Ermal Elezi, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Znj. Marie Augouy, Menaxhere Programi për Zhvillimin Rajonal dhe Lokal në Delegacionin e BE në Tiranë, si dhe Znj. Adelina Farrici, Drejtore e Ekzekutive e Shoqatës për Autonominë Vendore.

Aktualisht në këshillat bashkiake po punohet për ngritjen e Komisioneve të Integritimit Evropian, anëtarët e të cilëve më pas do të trajnohen nga projekti për të rritur më shumë njohuritë e tyre mbi rolin e këtyre strukturave në monitorimin dhe mbështetjen e bashkive në realizimin e detyrime që sjell përpara axhenda e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Aktivitetet e tjera të rëndësishme

Gjatë muajit mars është zhvilluar dhe takimi mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore në Shkodër, ku u ritheksua rëndësia e procesit të Integritimit Evropian si dhe benefitet që sjell ky proces për pushtetin vendor. Në këtë takim kryetarët e bashkive theksuan nevojën për mbështetje dhe asistencë të vazhdueshme për të aksesuar dhe për të zbatuar projektet me financim nga Bashkimi Evropian. Qeveria ka marrë angazhimin për ngritjen e një strukture të dedikuar, e cila do të mbështesë bashkitë gjatë aplikimit dhe zbatimit të këtyre projekteve.

Ju faleminderit,

Grupi Negociator,
Departamenti i Politikës dhe Integritimit Evropian (Sekretariati i Integritimit Evropian)

Prill, 2024